

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 08-09 SHTATOR 2004

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 08-09. SEPTEMBRA 2004. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2004



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat sendore,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për familjen,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konkurrencën,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspektionin e arsimit të Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korupcionit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetsor,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpalljen e kompleksit memorial "Adem Jashari",
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për avokatinë.
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e partive politike në Kosovë,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtaritë kërkimore – shkencore,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tubimet publike,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zejтари,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarve,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për librin amzë,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e vulave të IPVQ-ve,
20. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazetën zyrtare të Kosovës,
21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat,
22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrin,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës,
25. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са прошле седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о стварним правима,
3. Друго разматрање Нацрта закона о породици,
4. Друго разматрање Нацрта закона о конкуренцији,
5. Друго разматрање Нацрта закона о сточарској производњи,
6. Друго разматрање Нацрта закона о инспекцији за образовање на Косову,
7. Друго разматрање Нацрта закона о сузбијању корупције,
8. Друго разматрање Нацрта закона о играма на срету,
9. Друго разматрање Нацрта закона о прав. и одгов. Грађана у здравств. Заштити,
10. Друго разматрање Нацрта закона о проглашењу меморијалног комплекса „Адем Јашари“,
11. Друго разматрање Нацрта закона о адвокатури.
12. Прво разматрање Нацрта закона о финансирању полтичких странака,
13. Прво разматрање Нацрта закона о научно – истраживачком делатношћу,
14. Прво разматрање Нацрта закона о јавним окупљањима,
15. Прво разматрање Нацрта закона о занатству,
16. Прво разматрање Нацрта закона о ауторском и сродним правима,
17. Прво разматрање Нацрта закона о постицању запошљавања и заштита незапослен,
18. Прво разматрање Нацрта закона о матичним књигама,
19. Прво разматрање Нацрта закона о употреби печата ПИС – Косова,
20. Прво разматрање Нацрта закона о службеном листу Косова,
21. Прво разматрање Нацрта закона о пореској администрацији и поступцима,
22. Прво разматрање Нацрта закона о патенту,
23. Прво разматрање Нацрта закона о позоришту,
24. Прво разматрање Нацрта закона о заштити природе,
25. Прво разматрање Нацрта закона о приватној делатности у здравству.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting.
2. Second reading of the Draft Law on Real Rights of Kosovo,
3. Second reading of the Draft Law on Family,
4. Second reading of the Draft Law on Competition,
5. Second reading of the Draft Law on Livestock Production,
6. Second reading of the Draft Law on Inspection of Education in Kosova,
7. Second reading of the Draft Law on Suppression of Corruption Act,
8. Second reading of the Draft Law on Games of Chance,
9. Second reading of the Draft Law on the rights and respons of the citizens in Health Care,
10. Second reading of the Draft Law on the Announcement of Memorial complex "Adem Jashari",
11. Second reading of the Draft Law on Advocacy.
12. First reading of the Draft Law on Financing of Political Parties in Kosova,
13. First reading of the Draft Law on Scientific Research Activity,
14. First reading of the Draft Law on Public Gatherings,
15. First reading of the Draft Law on Crafts,
16. First reading of the Draft Law on related Rights Act,
17. First reading of the Draft Law on promotion of employment and on protection,
18. First reading of the Draft Law on Civil Registers,
19. First reading of the Draft Law on the usage of stamps in the PISG of Kosova,
20. First reading of the Draft Law on Official Gazzette of Kosova,
21. First reading of the Draft Law on Tax Administration and Procedures,
22. First reading of the Draft Law on Patent,
23. First reading of the Draft Law on Theatre,
24. First reading of the Draft Law on Nature Conservation,
25. First reading of the Draft Law on Private Practice in Health.

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 08-09 SHTATOR 2004

Seanca Plenare u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirëseardhje në Seancën plenare iu dëshiroj të gjithë deputetëve. Ministrat tashpërtash nuk po i shoh për t'i përshëndetur.

Deputetët që nuk e kanë kartelën me veti, i lus ta çojnë dorën, sepse është në pyetje çështja e votimit pastaj.

Sa për informim, t'ju them se në Kryesi kemi vendosur që, për shkak të numrit të madh të ligjeve në shqyrtim të dytë dhe numër të madh të amendamenteve, të kemi votim elektronik. Megjithatë do të detyrohemi të shkojmë prap me mënyrën klasike, sepse humbet e drejta e votimit të një numri të caktuar të deputetëve që nuk i kanë me veti kartelat, kështu që po e ndërroj vendimin e Kryesisë për arsye objektive.

Është edhe një lutje e ministrit të arsimit që të kemi konsideratë kur të vjen pika e rendit të ditës - nën 6 që ta bartim në fund të shqyrtimit të ligjeve në shqyrtim të dytë ose ta lëmë për nesër. Është një kërkesë e arsyeshme, por shpresoj se deri të arrijmë në atë pikë, mund të vjen edhe ministri.

Pra, pa humbur kohë, kalojmë në miratimin e Proçesverbalit nga mbledhja e kaluar. Do të përdoret e njëjta mënyrë – vërejtjet të paraqiten me shkrim nëse eventualisht ka, e po qe se deputetët kanë ndonjë kërkesë mund ta parashtrojnë. Urdhëroni. E ka fjalën deputeti Bedri Selmani, pastaj Gani Koci.

BEDRI SELMANI:

Zotri kryetar, zonja e zotrinj deputetë,
Më lejoni që të thirrrem në punën e Seancës së kaluar të Kuvendit që është bërë heqja nga rendi i ditës të pikës së 10-të të Projektligjit për nxitjen e investimeve – me qëllim se, sipas shkresës së Qeverisë, konkretisht të Ministrisë për Tregti dhe Industri, edhe ata e paskan të përgatitur të njëjtin Projektligj dhe se na është sygjëruar nga grupet parlamentare që t'i harmonizojmë propozimet. Ne këtë nuk e kemi arritur, për arsye se Ministria në fjalë nuk ka dërguar fare propozimin ose materialin e duhur në Sekretarinë e Kuvendit. Dhe për këtë, ne nuk kemi patur qasje në këtë projektpropozim të tyre ose material që do t'na ishte ofruar për t'i harmonizuar të gjitha qëndrimet, kurse ne si projektpropozues në mënyrë të rregullt e kemi proceduar në Sekretarinë e Kuvendit dhe si Projektligj është gjend në mënyrë të rregullt para deputetëve dhe është i gatshëm për shqyrtimin e parë. Mirëpo, është krejt diçka tjetër a do të miratohet apo do të refuzohet në leximin e parë nga ana e deputetëve.

Duke u bazuar në të gjitha këto argumente, besoj se inisiativa ime dhe puna që kam bërë në këtë Projektligj, e që padyshim është konform standardeve evropiane dhe si i tillë ka kaluar në procedurën plotësisht të rregullt të Kuvendit, kërkoj që të hyjë në rend të ditës në seancën e ardhës, pra me 8 të 9-tit ose ose sot apo nesër – kur është e mundshme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Dua ta informoj Seancën se kërkesa e deputetit, edhe herën e kaluar kam thënë, ka qenë në procedurë të rregullt normale të lejuar. Por, juve ju kujtohet që në Seancën e fundit ka qenë kërkesë e një grupi parlamentar, e mbështetur edhe nga grupet tjera, prandaj unë prap mbetem në atë që kërkesa e deputetit është e drejtë, por vetëm Seanca plenare mund të vendosë për këtë. Unë nuk kam të drejtë as të bëj presion. Qeveria nuk e ka dërguar, sikur që thotë deputeti, edhe kjo është e saktë. Unë kërkoj që të deklarohe mi lidhur me këtë, nën një për Grupin Parlamentar që atëherë ka kërkuar që të heqet nga rendi i ditës dhe pastaj të shohim për të tjerat. Profesor Bajrami a keni propozim? Nuk keni.

Prandaj, më mbetet t'ju pyes: kush është për ta vendosur në rend dite këtë Projektligj?

Le të numërohen votat, ju lutem.

Sikur shihet, 34 vota janë për, 72 deputetë të pranishëm - nuk radhitet në rend të ditës.

Zoti Gani Koci e ka fjalën, lidhur me këtë apo diçka tjetër? Urdhëroni.

GANI KOCI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Unë kam një vërejtje në Procesverbalin e Seancës së kaluar, pikërisht rreth propozimeve të Qeverisë për komisionin ose për rregullatorin e prokurimit publik. Qëndrimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës janë shprehur qartë në Seancën e kaluar dhe në Procesverbal thuhet se - u mor vendim dhe u votua, kurse ne kemi abstenaur si Grup Parlamentar nga votimi, do të thotë kemi dalë nga salla, dhe Kuvendi nuk ka patur kuorumin e duhur për të marrë vendime të tilla, ndërsa në Procesverbal thuhet se Kuvendi i Kosovës emëroi këtë e këtë, gjë që nuk është e vërtetë. Për hirë të opinionit, shprehim kundërshtinë e tillë, sepse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Kuvendi nuk ka patur kuorum të duhur për të votuar, prandaj është falsifikuar dhe është manipuluar me Kuvendin dhe me vendimin e Kuvendit dhe qëndrimet e Kuvendit në Seancën e kaluar. Ju nuk keni qenë prezent, sa më duket, si kryesues i Kuvendit. Prandaj, edhe një herë shprehim kundërshtinë në Procesverbal dhe me vendimet që shkruhen në Procesverbal sepse nuk janë marrë vendime të tilla në Seancën e kaluar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë e kam u dhëhequr Seancën këtë herë. Të konsultohet Transkripti për kuorum sipas gjendjes aktuale. Pas tërheqjes nga Qeveria e një kandidati të mëhershëm kur nuk kishte konsensus, është arritur në një mënyrë kuorum për punë. Le të përmirësohet ajo që ka të bëjë me diçka të pavërtetë, ju lutem. Nuk kam të drejtë të kërkoj që ndërrohet vendimi, sepse kjo punë është shtyer në dy-tri seanca, prandaj ky është mendimi juaj dhe mbetet se në disa seanca ka patur rrjedhë të rregullt. Urdhëroni, edhe një herë – për replikë!?

GANI KOCI:

Theksoj se qëndrimi i Grupit Parlamentar ka qenë ky, po e them tekstualisht: Mendimi i Qeverisë dihet se..., do të thotë rreth propozimit të Qeverisë për

Komisionin, dhe diskutimi ka qenë ky dhe dihet. Do të thotë, paraprakisht ju kemi paralajmëruar: Dihet se kemi një Qeveri të marrëveshjes dhe të gjitha ato marrëveshje janë bërë në mes të ministrave edhe në Qeveri, do të thotë në përgjithësi. Ne ose duhet të votojmë në paket të propozimit të Qeverisë, qysh kemi pasë edhe raste të tjera, ose Grupi Parlamentar i PDK-ës nuk do të marrë pjesë në procesin e votimit; dhe menjëherë pas kësaj Grupi Parlamentar ka dalë nga salla. Dhe çka është bërë, si është bërë – dihet shumë mirë. Janë inçizimet edhe filmike, ju lutem shikoni ato inçizime dhe pastaj konstatooni nëse është marrë vendim ose nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Ju falemnderit. Jo Haki nuk do të hapim debat, të lutem. Le të konsultohen të gjitha dokumentet, është e drejtë e gjithkujt, prandaj le të korrigjohet konform realitetit çka është thënë, por unë po ju them rrjedha ka qenë plotësisht procedurale normale – pas sqarimeve që janë dhënë. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën vijuese – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat sendore.

Miratimi në parim i këtij Projektligji, është bërë më 9 korrik 2004...

Urdhëroni, se nuk ju vërejta që kërkuat fjalën.

FLORA BROVINA:

Para se të fillojmë, desha ta marr fjalën dhe në emër të Grupit Parlamentar dhe si kryetare e Komisionit për personat e pagjetur e të rrëmbyer gjatë luftës, desha të kërkoj nga ju dhe Kryesia që çështjen e sjelljes së policisë ndaj nënave dhe familjarëve në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të personave të rrëmbyer e të pagjetur – të zhdukur, dhe sjelljen e tyre ta vëjmë për shqyrtim në rend dite, aq më tepër kur kjo datë shënohet si ditë ndërkombëtare kudo në botë dhe është shënuar tani e pesë vjet edhe në Kosovë dhe së treti ne në mbledhjen e parafundit debatuar për këtë çështje, domethënë për mbrojtjen institucionale të familjeve që kanë të rrëmbyer dhe për probleme të shumta të pazgjidhura ndaj tyre. Ishte e drejtë e tyre që ata të protestojnë dhe në këtë Seancë kërkoj që të vëhet në rend dite sjellja brutale ndaj këtyre familjareve – nënave, aq më tepër kur dihet se çdo ditë në Kosovë ndodhin mbyllje të rrugëve, madje ndodhi edhe pas kësaj proteste, kurse policia nuk u soll në mënyrë kaq brutale si ndaj këtyre nënave. Ky problem ka mund të eskalojë në një problem shumë të rëndë për Kosovën. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë mund të them vetëm kaq. Plotësisht përkrah përmbajtjen e kësaj që thoni. Unë mendoj se Komisioni që udhëheqni ka vepruar mirë atë ditë me deklaratë, dhe unë kam konsideruar atë në fakt në emër të Parlamentit.

Po ju informoj se në takimin tim të parë me komandantin e KFOR-it – gjeneralin Kermebo unë kam thekuar dhe në mënyrë eksplicite kam thënë se është një veprim tejet i pamatur, politikisht i dëmshëm, sepse një grup nënash nuk mund ta rrezikojnë rendin, qetësinë dhe stabilitetin. Domethënë, i bashkëngjitem asaj, por unë do të thoja që ne përkrahim atë që keni reaguar. Në qoftë se Komisioni e vlerëson se do të duhej të kemi edhe ndonjë debat apo dokument, ju lutem ia paraqitni këtë Kryesisë dhe menjëherë në fillim të javës Kryesia do ta shqyrtojë dhe do të vendosim. Por do të duhej të jemi të përgatitur sepse nuk bën ndryshe. Do të thotë, nuk ka asnjë deputet qëndrim tjetër, por të shkojmë në mënyrë të përgatitur.

Mendoj se pajtoheni me këtë? Ju falemnderit.

Urdhëroni Hatixhe.

HATIXHE HOXHA:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Të gjithë ne këtyre ditëve ishim të preokupuar me çështjen që lidhet me vendimin e autoritetit rregullativ të telekomunikacionit për shpalljen e fituesit të tenderit të operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe që ka të bëjë me rregullat e procedurës.

Të preokupuar veçmas nga shqetësimet që u ngritën nga ana e përfaqësuesve më të lartë të institucioneve tona vendore e ndërkombëtare, si dhe nga kryeministri i Kosovës, përfaqësues të zyrave të huaja, ushtruesi i detyrës së kryeadministratorit të Kosovës zoti Çarlls Brajshou, ekspertë ndërkombëtar, përfaqësues të mediave e të tjerë, si dhe pas raportit të Korporatës Helm – pas vendimit të ministrit të transportit dhe posttelekomunikacionit, pas sygjërimeve të Qeverisë së Kosovës, si dhe duke patur parasysh faktin se çështja e telefonisë mobile është çështje shumë e ndieshme dhe me interes për të ardhmen e një vendi, e në këtë rast edhe të Kosovës, duke ndjerë këtë shqetësim edhe si anëtare e Komisionit për transport, posttelekomunikacionin si dhe duke shprehur qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, k e r k o j m e nga Kuvendi që me procedurë urgjente ta fusë në rend dite këtë çështje dhe të kërkojë nga Qeveria që ta autorizojë ministrin

përkatës gjegjësisht ministrin e transportit e posttelekomunikacinit të raportojë para Kuvendit në lidhje me ART, gjegjësisht me çështjet që lidhen me operatorin e dytë të telefonisë mobile, dhe pas dëgjimit të raportit të hapet debat në Kuvend. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Sipas procedurës, kërkesa e një grupi parlamentar, vendoset menjëherë në procedurë të vendimmarrjes. Unë po ju njoftoj, deputete, që kryetarja e këtij Komisioni ka reaguar një herë. Unë e kam pa në media dhe kam menduar që është e Komisionit. Prandaj, një komision dy herë një çështje ta kërkojë..., edhe pse është e drejtë e Grupit Parlamentar, nuk e kontestova këtë.

Fjalë kanë kërkuar edhe zoti Shatri, apo qenka i lajmëruar më herët. Deputetit Kurteshi t'ia kyçni mikrofonin.

ISMAJL KURTESHI:

Ju falemnderit. Zoti kryetar, zonja Brovina dhe zonja Hoxha, në emër të Grupit Parlamentar kanë propozuar që të futen dy pika në rendin e ditës. Dhe, ju thatë që, sipas procedurave, duhet këtë çështje ta nxjerrni në votim dhe nuk kërkohet nga ju shpjegim tjetër, prandaj kisha kërkuar nga ju që kërkesat e Grupi Parlamentar nga dy deputete të nderuara t'i nxjerrni në votim para Kuvendit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ismajl, po e fillojmë apo rifillojmë atë që e kemi filluar para tri vjete. Unë do t'ju lutja, mos u mundoni t'më mësoni. Do t'ju lusja! Krejt drejtat tjera tuaja mund t'i kërkon. Unë thash – në qoftë se insistoni për këtë, sepse e kisha pëlqimin tuaj dhe ju nuk e patë, prandaj edhe nuk vendosi kokë në vete kurrë pa e pa realitetin. Mos u mundoni me më mësuar, ju lutem. Gjithmonë i dini përgjegjet dhe reagimet e mia.

Në këtë rast, unë thash, Komisioni funksional ka reaguar dhe ne kemi konsideruar si reagim të Parlamentit. Në qoftë se insiston grupi parlamentar për të marrë vendim, e këtë nuk po e shoh të arsyeshme. Qeveria ka reaguar, ka marrë vendim. Çfarë do të thotë ajo: pas vendimit të Qeverisë me thirrë ministrin...? Është e drejtë, unë nuk po e mbroj as ministrin as Qeverinë. Në qoftë se insistoni, le të mirret vendim, unë nuk jam kundër asaj që të votohet. Urdhëroni profesor...

ARSIM BAJRAMI:

Të falemnderit zoti kryetar. Unë mendoj se në bazë të Rregullorës të gjithë deputetët kanë të drejtë të shtrojnë çështje të ngutshme në Kuvend dhe me këtë rast nga Grupi Parlamentar u shtruan dy çështje që, sipas të gjitha kualifikimeve, mund të trajtohen si çështje të ngutshme, dhe qëndrimet që i japin komisionet gjatë seancave plenare nuk mund të zëvendësojnë Kuvendin e Kosovës. Unë ju lus të procedoni konform rregullores dhe këto dy kërkesa të Grupit Parlamentar t'i qitni në votim dhe Kuvendi të deklarohet për futjen e tyre në rend të ditës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, të votojmë.

Kush është për propozimin e deputetes që të thirret ministri në interpelancë, Qeveria apo si e thatë...

(Reagim – pa kyçje të mikrofonit)

Jo, jo. Të shkojmë me radhë. Është kërkesë e Grupit Parlamentar!

Kush është për kërkesën e deputetes Hatixhe që ministri i telekomunikacionit të vjen në Parlament.

Numëroni votat, ju lutem!

Të pranishëm janë 81 deputetë. Kanë votuar për 33, nuk kalon vendimi.

Propozuese, a jeni të interesuar jashtë asaj që u pajtuat, unë po them me përgjegjësi, kur u dhanë sqarimet.

Megjithatë, kush është për propozimin e deputetes Flora Brovina?

Janë 81 deputetë të pranishëm. 40 kanë votuar për, nuk kalon propozimi.

Vazhdojmë më tej. Është në radhë – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat sendore.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 9 korrik 2004.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet, me amendamentet që do të procedohen gjatë votimit.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe komizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat sendore ka bazueshmëri juridike në komizën kushtetuese – ma kanë shkruar!

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat sendore dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat sendore dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimet e Komisionit funksional dhe të deputetit Fatmir Sejdiu.

Amendamenti 1, deputeti Sejdiu me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 8, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër?

Abstenime? Nuk ka as njëra, as tjetra.

Kalon.

Amendamenti 9, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, deputeti Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, deputeti Fatmir Sejdiu, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, deputeti Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër?

Abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, deputeti Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, deputeti Sejdiu dhe Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër?

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, deputeti Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për?

A ka kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, deputeti Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, deputeti Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

(Pas ndërhyrjes së bashëkryesuesit B. Kosumi)

Të falemnderit Bajram. Të gjitha amendamentet janë të një nomenklature – të deputetit Sejdiu dhe të Komisionit funksional.

Prandaj, do të pyesja Parlamentin – a t'i aprovojmë, meqë asnjë kundër e as abstenim deri më tani nuk pati?

Kush është për aprovimin e përgjithshëm të amendamenteve të deputetit Sejdiu, me përkrahje të Komisionit funksional?

A ka ndonjë votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenim? Nuk ka.

Prandaj, konsideroj se këto amendamente u aprovuan.

Tash duhet ta votojmë në tërësi ligjin e amendamentuar.

Kush është për këtë ligj me amendamentet e propozuara? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Prandaj, konstatoj se u aprovua Ligji në fjalë.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Vecina - Majority

Kundër – Protiv – Against.....01

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Në rend dite është radhitja e amendamenteve në Projektligjin për familjen – shqyrtimi i dytë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe – e shkruar – kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për familjen ka bazueshmërinë juridike në kushtetutë të përkohshme – e pashkruar.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për familjen dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për familjen dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e deputetes Nerxhivane Dauti dhe të komisioneve kryesore.

Amendamenti 1, deputetja Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 2, deputetja Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, deputetja Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Edhe këtu është një nomenklaturë e njëjtë – me nëntë amendamente. Për këto tri të parat nuk pati asnjë kundër e as abstenim, prandaj pyes:

Kush është për amendamentet në vijim - gjashtë – për t'u aprovuar?

A ka ndonjë votë kundër? Një votë kundër.

A ka ndonjë abstenim? Nuk ka abstenim.

Prandaj, konsideroj se u aprovuan amendamentet.

Kush është për aprovimin e ligjit të amendamentuar? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Konstatohet se u aprovua ky Ligj.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Në radhë kemi – Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për konkurrencën – me amendamentet e propozuara.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për konkurrencën ka bazueshmëri juridike në kornizë kushtetuese.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për konkurrencën ka bazueshmëri juridike në kornizë kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për konkurrencën dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji për konkurrencën dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

Urdhëroni Bajrush.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju falemnderit. Ju përshëndes të gjithëve. Konsideroj se është i nevojshëm këtu një sqarim. Po shihni se ka shumë amendamente. Realisht shumica janë për një çështje që do ta potencoj. Pas shqyrtimit të parë në Kuvend – në seancë parlamentare, Komisioni për tregti, industri ka vërejtur se teksti i origjinalit në anglisht ka ndërruar – në rrugë diku, ku ta dijtash dhe s'jemi as kompetent me vlerësuar se ku, dhe kemi marrë përkthimin nga origjinali në anglisht të shqipes dhe kemi rivendosë gjendjen siç ka qenë më parë. Prandaj, shumë amendamente kanë të bëjnë me këtë çështje dhe mendoj se ndoshta s'ka nevojë fort, këtë e kemi bërë nga përkthyes kompetent, se anglishten se njohim aq mirë sa që ta bëjmë, dhe këto gjëra i hasim shumë në amendamente, dhe t'mos ndalemi shumë në to, ose nëse ndokush e sheh se është gabim – në rregull, por duhet një punë shumë e madhe. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bajrush, si kryetar dhe në emër të Komisionit, ju falemnderit. Unë e shoh se ka një përkrahje të plotë nga deputetët për fjalë që thatë. Urdhëroni, zoti Kuqi.

HAJREDIN KUQI:

T'falemnderit zoti kryetar. Unë mendoj se nuk është herë e parë që ne të votojmë për terminologjinë në gjuhën angleze, megjithë rrespektin për një pjesë që mund ta dijnë gjuhën angleze, por është një pjesë e madhe e deputetëve që nuk e dijnë dhe

është votimi disi për diçka që nuk dihet paraprakisht. Propozimi im do t'ishte kështu: ta votojmë në gjuhën shqipe, ndërsa të mbetet obligim që nga gjuha shqipe i amendamentuar dhe i plotësuar të jetë i përkthyer në gjuhën angleze. Përndryshe, këto propozime, për shumicën janë të paqarta.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Tani hyrëm në diçka për çka as unë, as Kryesia, as Seanca nuk jemi kompetent. Prandaj - profesor Kuqi, në qoftë se Komisioni funksional ka bërë një punë dhe kërkon atë, e ju e keni shqyrtuar këtë sigurisht me profesionalizëm – në qoftë se nuk ndryshon esenca e ligjit, atë që e tha Komisioni, duhet ta heqim prej rendit të ditës, sepse seanca nuk është kompetente ta vlerësojë përkthimin a është në rregull a jo. Prandaj, unë kërkoj ndihmë prej juve. Së pari profesor Kuqi për propozimin e vet, dhe nëse insiston - duhet ta heqim prej rendit të ditës.

HAJREDIN KUQI:

Të falemnderit kryetar. Mendimi im është që nuk kam dilemë apo dyshim në punën që mund ta ketë bërë Komisioni dhe unë do ta përkrahja si Komision, por kam dilemë për çka po votojmë.

Unë personalisht mendoj se relativisht mirë e di gjuhën angleze dhe kam dilemë për disa nocione që janë vënë këtu. Jam i bindur se këtu 70% mund të mos e dijnë gjuhën anglishte ose jo së paku në atë nivel sa t'i bëjnë krahasimet dhe votimi i këtij Kuvendi për gjuhën angleze - për diçka që nuk e dijmë - mendoj se nuk është korrekte. Mendimi im është: të votohet për versionin në gjuhën shqipe, pastaj të përkthehet, ose të hiqet deri sa të harmonizohet. Përndryshe, ne mund t'i ngrisim duart pa asnjë problem, por do të bëjmë diçka që paraprakisht nuk e dijmë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Profesor Hamiti, pastaj profesor Bajrami.

SABRI HAMITI:

Po mua po m' duket që shpjegimi i kryetarit të Komisionit tash e krijoi një lëvizje të diskutimit kah nuk është e dhe e senca e këtyre amendamenteve. Ju, keni kujdes! Nuk janë këto vetëm amendamente gjuhësore. Këtu ka amendamente shumë esenciale, që s'kanë të bëjnë hiq me problemet e versioneve gjuhësore. Ne kemi një propozim amendamentesh të Komisionit dhe është e udhës që Komisioni edhe një

herë të artikullohet rreth tyre, por unë mendoj se ne do të mund të kalojmë prej amendamentit në amendament dhe të vazhdojmë punën. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Urdhëroni, Bajrami.

ARSIM BAJRAMI:

Mendoj se kjo është një çështje parimore dhe Kuvendi duhet ta trajtojë si çështje parimore. Kolegu Kuqi shtroi këtë çështje si çështje parimore. Në përdorim zyrtar në Kuvend - dihet cilat gjuhë janë. Mirëpo, ky Kuvend ligjet i miraton në gjuhën shqipe. Nuk guxojmë tash ta vëmë çështjen e problemit të përkthimit. Ne i diskutojmë ligjet në gjuhën shqipe, pastaj Kuvendi ka shërbimin e përkthimit dhe është herë e parë që unë po shoh se një Komision funksional merret me terminologji në anglisht në ligjet tona. Nuk e di me çfarë drejte i ka dhënë të drejtë tash të sqarojë termat në gjuhën angleze. Këtë çështje duhet ta bëjnë shërbimet e përkthimit. Ne këtu diskutojmë dokumente vetëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhë tjera, gjuhët e minoriteteve që janë në përdorim zyrtar. Kështu që ne nuk guxojmë ta fusim këtë praktikë e të mirremi me çështjet e terminologjisë angleze në versionet në gjuhën shqipe.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Prap, Komisioni le të japë sqarim. Bajrush, urdhëro.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ne, që tri vjet gati, po amendamentojmë projektligje dhe për këtë ka ndodh një presedan. Është e vërtetë se është herë e parë që ka ndodhur do të thotë të ndërrojë tash anglishtja. Ne gjithherë e kemi pasë bazë anglishten dhe ka ndërrue përkthimi në shqip dhe gjithherë e kemi patur atë problem. Tani ka ndodhur e kundërta. Ne, si Komision, gjatë shqyrtimit kemi menduar ta kthejmë në gjendjen e mëparshme anglishten dhe kjo është bërë. Po tash – a është bërë profesionalisht, apo jo – e kanë bërë po ata që i kanë bërë deri tash në anglisht. Ne s'kemi patur edhe rrugë tjetër se kush ta bëjë këtë. Kuvendi mund të marrë qëndrim, qoftë edhe parimor – ta marrim, që të kthehet në atë gjendje, dhe ne s'do t'ishim kundër kësaj. Do të thotë të mbetet origjinal, meqë është përkthyer prej origjinalit në anglisht kjo çka është shqip dhe të rikthehet, por t'i mbetet dikujt.... sigurisht do t'i mbetet prap atyre që e kanë bërë. Ne iu kemi drejtuar atyre që e kanë bërë në fillim. Kaq kisha, tjetër nuk kam çfarë të shtoj. Do të thotë ne kemi dashur disi të procedojmë në Komision dhe t'i lëmë

ashtu, dhe dihet se vendos anglishtja në fund. Ky ishte shqetësimi ynë. Nëse e lëmë ashtu siç ka qenë dhe nuk bëjmë zë, atëherë mendoj se do t'na kishte dalë shumë më keq më vonë. Pra, le të vendosë Kuvendi për të gjitha variantat. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Hydajet Hyseni, pastaj Gani Prekopuca. Urdhëro Hydajet.

HYDAJE HYSENI:

Ju falënderoj që më dhatë fjalën, zoti kryetar, edhe pse nuk bëtë mirë që nuk ma dhatë në pikën e mëparshme.

Unë desha një propozim, që mendoj mund t'na nxjerr nga kjo situatë. Në parim, unë - siç e dini, nuk jam për shqyrtim amblllok të amendamenteve. Por nëse diku mund të shqyrtohen, mendoj se në këtë rast mund të shqyrtohet grupi i amendamenteve që janë të natyrës terminologjike. Kjo mund të bëhet, duke propozuar Komisioni ndërkohë deri sa t'i shqyrtojmë ne amendamentet tjera, dhe pajtohemi se duhet të veçohen, qoftë ato të shqyrtohen si grup amendamentesh, qoftë si një amendament i përbashkët, duke përfshirë atë që tha deputeti Kuqi, do të thotë që teksti të aprovohet në gjuhën shqipe dhe amendamentet - që mund të konsiderohen pastaj si nënamendamente - t'i përshtaten tekstit në gjuhën shqipe nga gjuha angleze. Mendoj se në këtë mënyrë ne do t'i veçonim çështjet që i shtroi - me të drejtë - deputeti Hamiti, do të thotë që amendamentet përmbajtësore t'i shqyrtojmë veç e veç, kurse këto çështjet tjera t'i shqyrtojmë si grup amendamentesh siç kemi vepruar herë me vend e herë pa vend. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe Prekopuca, i fundit.

GANI PREKOPUCA:

Falemnderit zoti kryetar.

Unë, si anëtar i Komisionit funksional, mendoj se nuk kemi nevojë të lëshohemi tash në drejtime të ndryshme, për arsye se Komisioni ka patur parasysh variantin në gjuhën shqipe dhe ne këto i kemi shqyrtuar një nga një dhe s'ka patur probleme. Në anglishte, se çfarë ka ndodhur, ia kemi lënë çështjes së anglishtes, e që ky Parlament - besoj me këtë s'ka nevojë të mirret. Në këtë kontekst, edhe janë përmirësuar në anglishte prap, ashtu që kujtoj me plotë të drejtë Komisioni e ka propozuar dhe ne si Parlament mund t'i aprovojmë, sepse në esencë, çka është kryesorja, amendamentet

në gjuhën shqipe kanë qenë origjinale dhe si të tilla i kemi shqyrtuar. Kujtoj se kjuo nuk pengon që t'i miratojmë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Gani falemnderit. Tash e kam pak më të qart. Do të thotë Komisioni ka punuar në gjuhën që e kupton. E ka fjalën Dugolli. Urdhëro Bujar.

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit. Unë mendoj se s'ka arsye për ta hequr nga procedura këtë ligj, se këtë mund ta zgjidhim. Komisioni ka marrë një detyrë që s'e ka patur për detyrë t'i bëjë edhe këto amendamente në gjuhën angleze, por si do që të jetë ne të gjitha këto amendamente ku thirren me terminologji në gjuhën angleze s'duhet t'i votojmë se duhet të përshtaten gjuhësisht ato. Amendamentet që janë në gjuhën shqipe t'i votojmë e ta miratojmë ligjin. Përkthimi është çështje tjetër. Ne leximet i kemi bërë në gjuhën shqipe dhe amendamentet Komisioni ka patur për detyrë t'i bëjë në gjuhën shqipe, dhe këto të evitohen nga gjuha angleze, të hiqen këto amendamente dhe këto amendamente në gjuhën shqipe. Mendoj se mund ta bëjmë këtë sot. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ta përfundoj. Mendoj se në parim, atë që e tha zoti Kuqi dhe e përkrahur nga Bajrami, absolutikisht qëndron. Parlamenti punon në atë gjuhë që e kupton dhe që për të është përkthimi profesional. Diskutimi i zotit Prekopuca e lehtëson punën në qoftë se dëshirojmë të punojmë, do të thotë Komisioni i ka shqyrtuar amenantet dhe ligjin në gjuhën që e kupton - në gjuhën e vet amtare.

Është lëshim i Komisionit që është marrë me përkthime, sepse Komisioni nuk është për këtë as kompetent as nuk e ka detyrë funksionale.

Prandaj, me këto thjeshtësime, në qoftë se dojmë që ligjin ta shqyrtojmë sot, duhet të vazhdojmë, duke u bazuar në gjuhën që e kanë kuptuar anëtarët e Komisionit dhe që e kupton Parlamenti. Çdo sintezë tjetër, atë që u mundua Hydajeti me udhëzuar, nganjëherë është e mirë, por nganjëherë krijon një buçkurish që nuk mund të vendoset në meny. Prandaj, vërejtjet që i pate janë..... unë nuk ju kam parë herën e kaluar, sepse po ta deshët fjalën atë mund ta merrni, jeni anëtar i Kryesisë, s'ka problem, por vërtetë s'e kam parë, dhe për atë se dikush ka kartela e dikush s'ka kartela, kur po shikoj këtu po thoni s'po na jepni fjalën - kur lajmëroheni me dorë, e

kur po i shikoj duart – nuk po jeni të lexuar, prandaj jam në dilemë. Më toleroni edhe një seancë të fundit dhe atëherë... Urdhëroni Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

S'e kisha ndërmend ta marr fjalën, po meqë hymë në buçkurish....! Dhe unë do të përpiqem megjithatë të mos e bëj buçkurish.

Kam një vërejtje, më shumë të natyrës parimore. Unë do të dëshiroja shumë që ligjet ne t'i shqyrtojmë në gjuhën, siç po thuhet, që kuptohet këtu. Do të dëshiroja natyrisht që të kuptohet se cila gjuhë. Po ne duhet të punojmë me ato dokumente që i kemi bazë për punën tonë dhe në ato dokumente, në rast të mospërputhjes së teksteve midis ligjeve – ju e dini mirë – që mbetet versioni në anglisht. Na pëlqen ose s'na pëlqen, është në rregull ose s'është në rregull kjo është çështje tjetër, por kështu është zoti kryetar dhe kështu veprohet. Ju e dini fare mirë. Prandja, mendoj Komisioni nuk ka bërë hiq gabim që është lëshuar në çështje të tilla. Nëse është çështje terminologjike që e ndërron përmbajtjen Komisioni funksional – dhe kush tjetër – është i thirrur t'i korrigjojë ato, sepse janë përmbajtësore dhe prodhojnë konsekuenca praktike – pastaj - shumëefektive. Ju i dini rastet.

Prandaj, unë mendoj se nuk duhet të ngutemi që amblllok t'ia marrim të drejtën komisioneve që t'i shqyrtojnë çështjet e tilla. Për ta thjeshtësuar çështjen, mund të procedojmë siç u propozua, ta zëmë t'i ndajmë ato amendamente dhe të bëjmë një formulim. Komisioni mund ta bëjë formulimin e mospërputhjet terminologjike në gjuhën angleze t'i përshtaten versionit të shqyrtuar në gjuhën shqipe dhe kjo mund të jetë njëfarë zgjidhje. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet, nuk je i licencuar me i dhënë licencë komisionit që t'mund të punojë në një gjuhë që nuk është profesionale. As unë nuk e kam atë licencë. Prandaj, për ta shkurtuar këtë, lus Komisionin funksional që të tërhiqet. Ne po kalojmë në një ligj tjetër dhe t'na e japin brenda mundësisë një ndihmë çka të bëjmë më tej me këtë ligj. Parcialisht nuk mundet një amendament në këtë gjuhë e një amendament në gjuhën tjetër, prandaj – thash Hydajet mos u përziej atje ku nuk ke kompetenca.

Ju lutem Komisioni funksional i këtij ligji le të tërhiqet, le të mundohen t'na e lehtësojnë punën dhe ne do të kalojmë në ligjin tjetër.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për prodhimtarinë blegtorale ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për prodhimtarinë blegtorale dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Ju lutem tash të numërohemi se a kemi kuorum.

Falemnderit. Mund të vazhdojmë sepse kemi kuorum. 68 deputetë janë të pranishëm.

(Reagim – pa kyçje të mikrofonit)

Po e lam atë, e shkruam në shqyrtimin tjetër. Hydajet, ti je shumë konsekuent në gabimet e tuaja për tri vjet. Megjithatë po kërkoj falje. Desha ta relaksoj pak pas asaj... Repliko don Hydajeti.

HYDAJET HYSENI:

Për besë, kryetar - me ndërhyerjet e tuaja të licenduara për t'na relaksuar, po më relaksoni edhe mua goxha shumë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon.

Meqë është e njëjta nomenklaturë – janë amendamente të Komisionit funksional, për katër amendamente nuk pati as kundër, as abstenim, pyes:

- Kush është për aprovimin e dhjetë amendamenteve tjera? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Konsideroj se amendamentet e Komisionit funksional u miratuan.

Tani vë në votim miratimin e ligjit, të amendamentuar.

Kush është për këtë propozim? Falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against..... 00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – Shqyrtimi i amendamenteve të paraqitura në Projektligjin për inspeksionin e arsimit...

Më falni kjo qenka pika që u morëm vesh ta lëmë për në fund, ose për ditën e nesërme. Në rregull, pasi propozoni, do ta lëmë për nesër.

Kalojmë në - Shqyrtimin e amendamenteve në Projektligjin kundër korrupsionit.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji kundër korrupsionit ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit kundër korrupsionit me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji kundër korrupsionit dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit për buxhet dhe Komisionit për financa e ekonomi.

Amendamenti 1, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6 Amendamenti 5, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Ne kaluam shumë më tepër se kuorumin e amendamenteve, kurse për tjerët në vijim është e njëjta nomenklaturë.

Prandaj pyes: kush është për aprovimin e amendamenteve të mbetura – 8 a 9 sa janë? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? 1 kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Konsideroj se amendamentet e propozuara u miratuan.

Dhe tani vë në votim ligjin në tërësi.

Kush është për miratimin e ligjit? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? 1 abstenim.

 Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Veçina - Majority

Kundër – Protiv – Against.....00

 Abstenim – Uzdržano – Abstained.....01

Kalojmë në shqyrtimin e Projektligjit për lojërat me fat.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për lojërat me fat ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për lojërat me fat dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për lojërat me fat dhe amendamente e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Deputete Sala, a je për a kundër? E ke harruar dorën, a? Falemnderit. Nuk e kam këtë për ju, por për shkak të monitorimit.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Dhe Amendamenti 6, Komisioni funksional.

Urdhëro Gani.

GANI KOCI:

Për amendamentin 6 po paraqitem. E marr fjalën e dhe si anëtar i Komisionit për buxhet, por edhe si anëtar i Grupit Parlamentar të partisë Demokratike të Kosovës. Ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që të mos votojnë për amendamentin 6 dhe të mbetet sipas zgjidhjes ose propozimit që është bërë në Projektligjin rreth nenit 57. Këtë e kam shprehur edhe në Komisionin për buxhet gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji – kur është çështja e dhënies dhe destinimit të kontributeve nga lojërat e e fatit. Duke u nisur nga praktikat që janë gjithkund në botë, me ligj kontributet që vijnë nga lojërat e fatit janë të destinaura dhe të përcaktuara për kategori të caktuara sociale dhe nuk dua t'i përmend këtu tash cilat janë ato, por Projektligji në mënyrë të qartë saktëson se për cilat kategori shkojnë kontributet që vijnë nga lojërat e fatit. Kurse, amendamenti i propozuar nuk përcakton kategoritë, gjë që bie në kundërshtim edhe me standardet evropiane, edhe me ligje të tjera që praktikëjnë vendet tjera.

Unë dua të përmend vetëm këtë se sipas propozimit të Projektligjit, kontributet shkojnë për këto kategori sociale: për invalid të luftës dhe të punës, duke mos përcaktuar sepse invalid të punës kemi invalid të luftës – të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe invalid civil të luftës; për invalid të punës; për kujdesin për familje për fëmijë të dëshmorëve, pastaj ndihmë për të drejtat e njeriut; ndihmë për zhvillimin e kulturës; zhvillimin e sportit; ndihmë për mbrojtjen e shëndetit dhe për çështje të

tjera. Shumica e Komisionit, nuk po them të gjithë, në tërësi ndryshon në këtë nen të këtij Projektligji. Prandaj thërras që të votohet kundër amendamentit 6 të propozuar nga Komisioni funksional dhe të mbetet neni siç është në Projektligj i përcaktuar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë lus Komisionin funksional për ndihmë, dhe për më shumë tolerancë.

HAKI SHATRI:

Falemnderit zoti kryetar. Është e vërtetë se është diskutuar kjo çështje në Komision. Ka pasë mendime për dhe kundër. Parimisht kanë punuar Komisioni funksional – së bashku dy komisionet – Komisionin për ekonomi e financa dhe Komisionin për buxhet dhe arsyeja pse jemi përcaktuar për këtë formë të amendamentit është se gjithmonë Komisioni për buxhet rrespekton parimin që të mos parapërcaktojmë destinimet buxhetore në një ligj tjetër por të mbetet të përcaktohen me ligjin vjetor të buxhetit për cilat destinime do të shpërndahen. Kjo është arsyeja pse. Nuk ka patur kundër që ato mjete të mund të orientohen edhe për destinime të cilat janë përmend në tekstin e Projektligjit dhe nuk thuhet se jemi kundër tyre e as që kundërshtohet ajo. Mbetet mundësia që mjetet e ndara nga lotaria të shkojnë edhe për ato destinime, por nuk mund të parapërcaktohen me ligjet tjera. Ne kemi kundërshtuar edhe me raste tjera kur është parapërcaktuar ndarja e mjeteve buxhetore. T'ju përkujtoj rastin e Ligjit mbi kinematografinë kur është kërkuar që të ndahet një përqindje për kinematografinë dhe ky Kuvend për arsye parimore është përcaktuar kundër. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë do të ju lusja për mirëkuptim. Do të thotë profesionalisht Komisioni ka punuar mirë, politikisht dhe njerëzisht në rrethana që jemi. Mendoj se deputeti që e shtroi dhe antëari i Komisionit do të duhej të ketë mirëkuptim. Proceduralisht më duhet të veprojmë sipas rregullave. E di se një mendim është i shkruar, por do të doja që Komisioni për ekonomi e financa të thotë diçka lidhur me këtë. Urdhëroni...

SAHIT KRASNIQI:

Falemnderit zoti kryetar. Unë si anëtar i Komisionit për ekonomi e financa pajtohem me atë se kemi harxhuar shumë kohë në Komision rreth këtij amendamenti dhe kemi ardhur në përfundim se nuk duhet të qëndrojmë ajo çka thotë deputeti Koci, për shumë arsye. Për arsye se, në Ligjin për menaxhimin e financave publike duhet të jetë shumë qartë e shkruar se të gjitha të hyrat detyrimisht duhet të derdhen në buxhetin e

konsoliduar të Kosovës. Dhe, në këtë rast, nëse me ligj krijojmë fonde të veçanta, unë mendoj se po nxjerrim jashtë buxhetit të konsoliduar dhe në një mënyrë këtë sasi të mjeteve financiare ose të parave e nxjerrim jashtë qarkullimit, që është rregull se paraja duhet të jetë në qarkullim. Prandaj, kemi ardhur në përfundim se këtë që e kemi shkruar mendojmë është e drejtë dhe duhet të jetë që Qeveria me akte tjera ose me rregullore, apo me udhëzime – s’e dijmë ne si do t’i quan – Qeveria e përcakton ndarjen e asaj përqindje që kërkohet. Në asnjë mënyrë nuk mund të pajtohemi që tash në ligj të përcaktohet përqindja në mënyrë decitive – 5, 10 a 20% s’është me rëndësi që duhet të shkojë në këtë fond, e në këtë fond, për arsye se rregullat mendoj s’e lejojnë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë theksova profesionalisht mirë keni punuar. E ka fjalën deputetja Nekibe Kelmendi dhe besoj se do t’na ndihmojë.

NEKIBE KELMENDI:

Unë e shoh këtë ndryshim jo në pikëpamje të destinimit të dispersionit të atyre kontributeve, por vetëm në përcaktimin e shkallës, dhe është shumë normale që shkalla e kontributeve të caktohet nga ana e Ministrisë për Ekonomi e Financa. Pra, duhet të kalojë ky amendament, sepse nuk bëhet fjalë për ndryshimin e destinimeve që është paraparë me nenin 57 paragrafi 1, pra është paraparë që të ketë vetëm konkretizim se kush e përcakton shkallën e kontributeve.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Përsëri e ka fjalën deputeti Koci.

GANI KOCI:

Prap do të nisem prej kësaj të fundit që e tha deputetja Nekibe Kelmendi. Nuk është fjala për përcaktimin e shkallës ose përqindjes së ndarjes së kontributeve, por për kategoritë që shkojnë kontributet dhe nuk është fjala vetëm për pjesën e parë. Por, ju lutem – lexone mirë nenin 57 paragrafi 1 dhe lexone amendamentin 6 që thotë “të riformulohet si vijon” – neni 57 pika 1. Do të thotë, këtu bëhet ndryshimi edhe i atij që e quan ti dispersion – ndarje në kategori sociale. Nuk flitet për shkallë e përqindje, por për kategori sociale. Prandaj, le të dalë ndokush nga anëtarët e Kuvendit dhe le t’më japë një shembull nga vendet tjera në ligjet për lojërat e fatit se a i kanë të përcaktuara kontributet, se ku shkojnë dhe ku shpërndahen këto kontribute, apo i lënë që qeveria ose ministria përkatëse t’i përcaktojë.

Kur është fjala për paragrafin 2, që dikush e tha se shkojnë jashtë buxhetit të konsoliduar, - Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, me udhëzime të veçanta, përcakton mënyrën se ku shkojnë ato. Këtu është fjala se dikujt i vret veshin ajo që thuhet për invalidët e luftës, për fëmijët e dëshmorëve, për invalidët e punës, për çështjet e sportit e të kulturës. Dhe, nëse është kështu, atëherë - ju lutem - votone pra amendamentin 6. Por le t'ma jep dikush një shembull të një ligji të një vendi tjetër se është kështu si ne që votojmë sot ose siç është propozuar sot këtu.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Urdhëro profesor, nëse mundesh me na ndihmue.

SABRI HAMITI:

Këtu, siç ngjet zakonisht kur njerëzit dojnë me bë interpretime, s'donë me qenë të saktë. Leximi i keq është leximi më i poshtër n'botë për çdo gjë e le më i ligjeve.

Unë mendoj se në këtë rast duhet të jemi shumë konkret dhe se këtu po bisedojmë për dy gjëra, a. Dikush flet për një problem, dikush për problemin tjetër.

Amendamenti 6, që i referohet nenit 57 – unë e lus Kocin, meqë po do me i lexue tekstet le ta nxjerr përpara dhe ta lexojë tekstin ç'ka thënë. Lexo zoti Koci! “Sipas propozimit të bordit, drejtues të llogarisë së Kosovës, NEF-i i jep lartësinë”... Po ku ka bord i llogarisë që kallxon sa i ka paret e ti me ia marrë. Lexo mirë tekstin - pse ndodhë kjo. Domethënë në kuptimin e pjesës së parë, formulimi i Komisionit është shumë i mirë dhe kjo i adresohet kësaj pjese. Ke kujdes, domethënë lexoje mirë, kujt i referohet ky formulim.

Është punë tjetër numërimi prej a) e tutje i kategorive dhe unë mendoj që ai është punë – sa për hesap timin – që mun të mbetet, mirëpo keni kujdes: mos interpretoni keq tekste dhe mos paragjykoni disponime se ai është gabimi më i madh që mund ta bëjë një njeri – një përfaqësues – një intelektual dhe një njeri në Kuvend, ju lutem shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Urdhëro Gani.

GANI KOCI:

Të lexohet mirë por të mos lexohet në mënyrë të participuar, por të lexohet i tërë ligji. Këtë bord e zgjedh ky Kuvend dhe i përgjigjet këtij Kuvendi dhe nuk është një bord që zgjidhet rrugëve dhe zgjidhet kafeve por i përgjigjet këtij Kuvendi. Dhe, mbi këtë bord është ky Kuvend dhe është edhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Prandaj, propozimi është që të ndryshohet neni 57 pika 1 – komplet siç është dhe jo pjesë e nenit 57 pika 1. Ky është problemi. Prandaj, lexone krejt ligjin dhe mos u përqëndroni vetëm në nenin 57. Cilat janë kompetencat e bordit, kush e emëron atë, kujt i përgjigjet ai dhe cilat janë autorizimet dhe përgjegjësitë që i ka ky si bord.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Edhe Dugolli, si shef i Grupit Parlamentar. Unë kërkoj falje se e kam thye procedurën dhe mund t'më denoni, sepse në shqyrtimin e dytë nuk ka debat. Urdhëro Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Ne mendojmë se Komisioni nuk e ka bërë këtë në mënyrë profesionale. Këtu qëndrojnë shumë ato që u thanë më herët. Në rast se thuhet që 57 pika 1 të riformulohet si vijon, një pjesë e kësaj vlenë, por nuk vlenë nën a) e teposhtë kur dihet se ku destinohen këto çështje. Dhe, në rast se thuhet që riformulon, atëherë po lë të kuptohet që ky 57 pika 1 ndërrohet krejt dhe hiqen ato që po i kërkon zoti Koci. Unë mendoj se Komisioni këtu ka gabuar që ka thënë... Është dashur të precizohet sakt – shkallën mund ta caktojë ministria dhe destinimi të jetë ashtu si është dhe figuron në ligj dhe jo të lëhet mundësi që buxheti i konsoliduar t'i dërgojë ku të dojë ato..., por të ketë destinimin e caktuar ashtu siç është nën a) dhe tutje që vazhdon ky nen, prandaj kjo fjala "të riformulohet si vijon" ngelet vetëm për këtë pjesën e parë, jo për pjesët tjera nën a) – nën b) ku vazhdon atje, si po e kërkon zoti Koci. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Edhe zoti Sejdiu, si anëtar i Kryesisë.

FATMIR SEJDIU:

Falemnderit zoti kryetar. Këtë të fundit që e tha Dugolli bjen në kundërshtim me atë më herët. Me këtë e përmirësoi faktikisht, në fazën finale. Edhe nenin do ta lexoj.

Amendamenti 6 e ka: “Në nenin 6, pika 1 të riformulohet” dhe është ai lexim konkret që interpretoi edhe zoti Hamiti. Këtu ka të bëjë me një kompetencë drejtpërdrejt të shkallës së përcaktimit nga ana e Qeverisë përkatësisht Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Pikat tjera, për të cilat aludon zoti Koci më herët, asnjëra nuk ndërron. Problemi mbetet që dëdikimi të bëhet në këtë kuadër, do të thotë Qeveria megjithatë të ketë një kontroll të fuqishëm në këtë fushë kaq të ndieshme dhe të akumulimit kaq të madh. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Tani mendoj se duhet t’i nënshtrohemi vendimmarrjes.

Para se të procedojmë me votim... Shpeshherë nëse një amendament nuk votohet, ligji nuk priset sepse është aprovuar në leximin e parë.

Megjithatë, kush është për propozimin e Komisionit funksional?

Urdhëroni, mund ta merrni fjalën.

SABRI HAMITI:

Para se ta votojmë, edhe një moment. Unë i përcolla diskutimet dhe propozimet. Kujtoj se nuk ka dallime në të menduar, por ka dallim në segmente të interpretimeve, prandaj unë propozoj që të thuhet: “Në nenin 57 pika 1 të riformulohet paragrafi i parë kështu” dhe kurgjo tjetër dhe është ajo që po lypim të gjithë. Paragrafi i parë të riformulohet kështu, bëhet teksti dhe është ajo që po kërkohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, po shoh Aleanca jep përkrahje. Me këtë sqarim... Urdhëro Gani.

GANI KOCI:

Paragrafi i parë përmban edhe pikën a), b), c), d), e), f)... se ç) nuk është futur sepse është i përkthyer. Ju lutem paragrafi i parë është deri te paragrafi i dytë, bashkë me këto pika. Nëse përfshihen këto pika në këtë riformulim kjo mund të jetë e pranueshme, nëse fshihen këto pika – a), b), c) deri te f) atëherë s’është i pranueshëm.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, kryetar je i Grupit më të madh Parlamentar, mirë e nise e qetë, vetëm thueje ta kuptojnë deputetët dhe të votojmë.

(Reagim – S. Hamiti, pa kycje të mikrofonit)

Në qoftë se e kam mirëkuptuar profesor Hamitin, mbetet vetëm fjalia e parë deri te a).

Kush është për amendamentin në këtë mënyrë të formuluar? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? 3 vota kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti, i riformuluar.

Dhe tash ju pyes: Kush është për aprovimin e ligjit me amendamentet e aprovuara?

Ju falemnderit.

A ka votë kundër? 1 votë kundër.

A ka abstenime? 2 abstenime.

Konsideroj se është i aprovuar edhe ky Ligj.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For Shumica – Veçina - Majority

Kundër – Protiv – Against..... 01

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 02

E tash, i kthehemi shqyrtimit të ligjit për konkurrencën. Lus referuesin apo kryetarin e Komisionit të paraqesë arsyetimin lidhur me këtë.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju falemnderit zoti kryetar, kolegë të nderuar,

Komisioni edhe një herë e thotë fjalën e vet se nuk ka guxuar të heshtë defektin e madh për çështjen e anglishtes, tekstit anglisht, sepse teksti në versionin anglisht vendos e jo as ai në shqip e as ai në serbisht. Po të ishte aprovuar në atë formë, përfaqësuesi special do ta nënshkruante tekstin anglisht dhe në zbatim do të mirrej ai e jo tekstet tjera.

Çështja e përkthimit. Do ta befasoj shumëken, por shërbim të përkthimit nuk ka në Kuvend. Ne iu kemi drejtuar zyrës që na mbështet neve si Komision – zyrës së USAID-it që ta bëjë këtë harmonizim në tekst, për çka e falënderojmë. Ne si Komision s'e kemi bërë, e thash edhe në fillim, iu kemi drejtuar atyre që gjithherë iu

kemi drejtuar, prandaj Komisioni vendos që amendamentet e propozuara t'i ndajë në dy grupe.

Grupi i parë – amendamentet përmbajtësore në gjuhën shqipe dhe serbe, si vijon: Amendamenti 3, 8, 9, 11, 13, 15, 16, 20, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41. Këto janë amendamente të përmbajtësore.

Ndërsa grupi i dytë përbëhet prej amendamenteve që kanë të bëjnë me standardizimin gjuhësor dhe teknik dhe që mund të procedohen me vetëm një amendament, duke i përfshirë këto amendamente të Komisionit: 1, 2, 4, 5, 6, 7, 10, 12, 14, 17, 18, 19, 21, 22, 26 dhe 31.

Pra, përkthimin e kanë bërë njerëzit kompetent dhe ne nuk dijmë kujt t'i drejtohem. Nëse dikush mendon se duhet dikujt tjetër t'i drejtohem le të tregoj kujt. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bajrush, të falemnderit. Kemi një propozim të këtillë, ju lutem – me vëmendje. Amendamentet përmbajtësore, sipas zyrës profesionale të autorizuar, janë amendamentet 3, 8, 9, 11, 13, 15, 16, 20, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41. Propozimi ynë është që Seanca të marrë vendim, sipas propozimit të Komisionit profesional. Amendamentet tjera shkojnë në korrigjim gjuhësor – vetëm në korrigjim gjuhësor. Do të thotë, me këtë sqarim ju lutem të propozojmë. Është e njëjta nomenklaturë për këto amendamente, prandaj propozoj, në qoftë se jemi njëzërit si në vendimmarrjet tjera – në pako t'i aprovojme. Urdhëro, e ka fjalen shefi i Grupit Parlamentar të AAK.

BUJAR DUGOLLI:

Po ne pajtohemi t'i votojmë ashtu, përveç 41-shit që kërkoj sqarim. Thotë “Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2005”. A mos po bëjnë pak një gabim, në krahasim me ligjet tjera, si është dispozita përfundimtare dhe kërkoj sqarim nga Komisioni për këtë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bajrush Xhemajlit mikrofonit t'i kyçet për diskutim.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Nuk është herë e parë, me fillimin e vitit kalendarik kemi thënë – hyn në fuqi ndonjë ligj. Ky nuk bën ndonjë presedan, ndonjë përjashtim. Shumë çështje kanë një

tremujor, një gjashtëmujor, nëntëmujor e tjera por në këtë rast për këtë ligj ne kemi përcaktuar që duhet të jetë me fillimin e vitit. Kuvendi le të vendosë për këtë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj se Dugolli ka të drejtë. Urdhëro. Profesor Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI:

Edhe unë mendoj se në rastet kur duhet të prolongohet hyrja në fuqi e ligjit duhet me qenë një arsytim shumë i fortë pse kërkohet. Por unë po i kthehem propozimit tuaj, që propozuat të votohen amendamentet përmbajtësore, ndërkaq këto terminologjike të lëhen.

Mendoj se nuk guxojmë aq lehtë të hyjmë në këtë praktikë. Është dëshira e krejtve që ligji të kalojë, por mos ta bëjmë ligjin mish-mash. Në qoftë se janë çështjet terminologjike, ai s'është amendament. Ajo është çështje e përkthimit dhe s'e ka karakterin e amendamentit. Prandaj, në qoftë se votojmë ne po votojmë për këto amendamentet përmbajtësore. S'ka amendamente tjera. Çështjet gjuhësore të rregullohen në procedurën e përkthimit. Nuk mund përsëri ky ligj me ardhë në Kuvend dhe me u prezentue amendamentet terminologjike.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Është një moskuptim. Unë nuk mendova se do të vijmë. Lëhet si çështje teknike dhe të standardizohet dhe 41-shi nuk votohet me këtë rast.

Kush është për Komisionin funksional, për ato që ishin marrëveshjet e grupeve parlamentare. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? 1 votë kundër.

A ka abstenim? Nuk ka abstenim.

Konsideroj se janë të aprovuara amendamentet e sqaruara më parë.

Tani e vë në votim ligjin e amendamentuar, në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.

A ka abstenime? 1 abstenim. Ju falemnderit.

82 deputetë janë të pranishëm. Ju lutem deri në orën 12, e bëjmë një kafepauzë dhe vazhdojmë punimet.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Veçina - Majority

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....01

(Vijoi pauza)(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Deputet të nderuar, po vazhdojmë punën.

Tani kemi në radhë pikën e rendit të ditës – shqyrtimi i amendamenteve në Projektligjin për inspeksionin e arsimit në Kosovë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për inspeksionin e arsimit në Kosovë nuk përmban implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni do t'i shqyrtojë amendamentet e Komisionit funksional dhe të njëjtat i përkrahë me kusht që para se të votohet nga Kuvendi të mbahet një mbledhje e përbashkët me Komisionin funksional dhe me përfaësuesit e sponsorizuesit të Projektligjit – Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji për shqyrtimin e nenit 3. Unë besoj se këto parakushte do të jenë plotësuar, prandaj kalojmë në shqyrtimin e amendamenteve.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Ju lutem, amendamentet në vazhdim janë të njëjtës nomenklaturë. Përmbi 50 përqind, asnjë deputet nuk kishte kundër dhe nuk ka abstenuar.

Prandaj pyes: kush është që për 6 amendamentet tjera të aprovohen në pako.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Konsideroj se janë të aprovuara edhe gjashtë amendamentet tjera.

Kush është për aprovimin e ligjit në tërësi, me amendamente të aprovuara?

Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenim? Nuk ka.

Konstatohet se njëzërit u aprovua Ligji.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor ka bazueshmëri juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe amendamente të propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Me propozimin e kryetarit të Komisionit për gjyqësi, legjislacion mund të shkojmë në pako për t'i aprovuar, sepse për 50 përqind të amendamenteve - të votuara nuk pati as kundër as abstenime.

Kush është për pesë amendamentet tjera. Falemnderit.
A ka votë kundër? 1 votë kundër.
A ka abstenime? Nuk ka. Falemnderit shumë.

Tani shkojmë për votim të ligjit në tërësi, me amendamentet e aprovuara.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka.
A ka abstenime? 1 abstenim.
Konstatohet se Ligji është i aprovuar.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For	Shumica – Veçina - Majority
Kundër – Protiv – Against.....	00
Abstenim – Uzdržano – Abstained.....	01

Në vijim është radhitja e amendamenteve në Projektligjin për shpalljen e kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për shpalljen e kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz ka bazueshmërinë juridike.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për shpalljen e kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shpalljen e kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe propozojnë një amendament.

Kush është për amendamentin e propozuar? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Falemnderit.

Urdhëroni profesor.

ARSIM BAJRAMI:

Falemnderit zoti kryesues – zoti kryetar, zoti kreytar i Kuvendit të Kosovës!
Duke shpreh kënaqësinë për miratimin e këtij ligji, si autor dhe në emër të Komisionit që ka sponsoruar, lus kryeministrin e Kosovës, minsitrin e financave dhe tërë Qeverinë e Kosovës që, konform nenit 6 të këtij Projektligji, të ndajnë mjete buxhetore për vitin 2005 për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kompleksit, meqenëse neni 6 i këtij Projektligji parasheh që Qeveria e Kosovës do të ndajë mjete buxhetore për ndërtimi ne këtij kompleksi.

Me këtë rast, krejt në fund, më lejoni që të falënderoj për bashkëpunim rreth këtij ligji familjen Jashari, pastaj Asamblenë Komunale në Skenderaj dhe të gjitha grupet parlamentare të cilat në mënyrë konsensuale po e mbështesin këtë ligj, padyshim një ndër ligjet më të rëndësishme që po miraton Kuvendi gjatë kësaj legjislature.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit.

Kush është për aprovimin e ligjit në tërësi? Falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Konstatoj se njëzërit aprovohet Ligji.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstaned.....00

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për avokatinë në Kosovë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për avokatinë ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për avokatinë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për avokatinë dhe amendamente e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për? Falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për? Falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për? Falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Për 50 përqind të amendamenteve nuk pati kundër as abstenime dhe i kemi miratuar. Dy amendamentet tjera kanë të njëjtën nomenklaturë dhe për të njëjtat pyes:

- Kush është për? Falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Ju falemnderit.

Tani vë në votim për miratimin e ligjit me amendamentet e aprovuara. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Të pranishëm në sallë, janë 77 deputetë.

Konstatohet se Ligji në shqyrtim është i aprovuar nga Parlamenti.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Vecina - Majority

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....01

Kalojmë në pikën vijuese – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e partive politike në Kosovë.

Lus sponsoruesin e ligjit që të marrë fjalën dhe paraqes arsyetimin e ligjit.

Mendoj se duhet të shtyhet shqyrtimi për nesër, sepse nuk është sponsorizuesi i ligjit i pranishëm – me arsye.

Tash kemi – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tubimet publike, me të njëjtin sponsor dhe ai mungon.

Në vijim kemi – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zejtari.

E ka fjalën sponsorizuesi i ligjit, ministri Ali Jakupi. Urdhëroni ministër, fjala është e juaja.

ALI JAKUPI:

Ju falemnderit zoti kryetar. I nderuari zoti kryetar i Kuvendit, e nderuara Kryesi, të nderuar deputetë, të nderuar minsitra,

Me rrespekt prezentoj para jush Projektligjin për zejtari. Është ky një Projektligj i rëndësishëm për të rregulluar veprimtarinë zejtare vitale të cilat gjenden në Kosovë dhe kanë mundësi të zhvillohen.

Zejtaria jështë degë shtytëse e zhvillimit të bizneseve të vogla, prandaj si e tillë meriton të mbrohet me ligj.

Projektligji për zejtarinë është hartuar nga ekspertë të shquar vendor dhe ndërkombëtar, dhe paraqet një dokument të rëndësishëm me të cilin rregullohen

ksuhtet për ushtrimin e veprimtarisë zejtare, si bie fjala regjistrimi i veprimtarive biznesore, ushtrimi i përbashkët, aftësimi, edukimi, kultivimi i zejeve të vjetra – që janë të dobishme dhe fitimprurëse, mbikëqyrja e veprimtarisë zejtare.

Projektligji është hartuar me 58 nene, përkatësisht me 6 kapituj.

Janë të definuara normat dhe fushëveprimtaria e zejtarisë. Sipas tij, drafti i llojeve të zejtarisë, siç është zejtaria e lirë, zejtaria e ndërlidhur me njëra-tjetrën, zejtaria ekskluzive e cila mund të ushtrohet vetëm në bazë të autorizimit të lëshuar nga ministria përkatëse, zejtaria prodhuese, zejtaria shërbyese si dhe artizanatet tjera, që përfshihen në kapitullin e parë.

Në kapitullin e dytë, saktësohen mundësitë e ushtrimit të kësaj veprimtarie për personat fizik vendës dhe ata ndërkombëtar. Për ta ushtruar këtë biznes, duhet të bëhet regjistrimi pranë MTI, ndërsa lejen për ushtrimin e veprimtarive e japin organet kompetente lokale.

Nga veprimtaritë zejtare formohen firmat, ndërkaq institucioni statistikor i Kosovës e përpilon nomenklaturën e veprimtarive zejtare.

Sipas këtij Projektligji, zejtari mund të ushtrojë atë veprimtari zejtare për të cilën i është lëshuar çertifikata e regjistrimit. Të gjitha rregullat tjera dhe ndryshimet e mundshme janë të sanksionuara në këtë draft juridik.

Në veçanti dallohen obligimet e kryepunëtorëve, përgjegjësia për listën e çmimeve të produkteve që juve duhet t'u jenë të prezentuara për cilësinë, kushtet e punës e tjera.

Është rregulluar mundësia për ushtrim të përbashkët të veprimtarisë së zejtarit – dy e më tepër persona fizik. Veprimtaria zejtare mund të ndërpritet vullnetarisht ose me forcën e ligjit.

Projektligji përmban normativa të avancuara për të mbështetur një zejtari moderne dhe bashkëkohore.

Në kapitullin tre, përfshihet domosdoshmëria e arsimimit dhe për ushtrimin e veprimtarisë zejtare kërkohet përgatitja e duhur profesionale, që arrihen në institucionet shkollore të mesme e të larta dhe superiore. Po ashtu, jipen provimet profesionale para komisioneve të autorizuar. Në këtë fushë bashkëpunojnë ministritë përkatëse, Shoqata e Zejtarëve të Kosovës, si dhe administrata lokale.

Në kapitullin katër, rregullohen mundësitë e themelimit dhe të organizimit të shoqatave zejtare në aspektin territorial apo aspektin e llojit të veprimtarisë. Shoqatat mund të jenë rajonale dhe lokale. Shoqatat i kanë organet e veta drejtuese. Organet drejtuese të shoqatës janë kuvendi, kryetari, këshilli drejtues dhe këshilli mbikëqyrës. Anëtarësimi në shoqata bëhet në bazë të interesave dhe të levërdive. Veprimtaria e tyre rregullohet me statut.

Kapitulli i pestë, përmban dispozitat mbikëqyrëse dhe të masave ndëshkuese. Mbikëqyrjen e bën ministria kompetente dhe inspeksioni i autorizuar. Kushtet për gjobë si dhe vlera e gjobës janë të rregulluara me këtë draft.

Kapitulli i gjashtë dhe përmbyllës i këtij Projektligji, përfshin dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Të nderuar deputetë, Projektligji që gjendet në shqyrtim, është i nevojshëm dhe i dobishëm për zhvillimin e një pjese të ekonomisë, për punësim të një numri të dukshëm të meshkujve dhe femrave. Ky draftligj nuk bie ndesh me dispozitat e UNMIK-ut apo me ndonjë ligj tjetër.

Duke marrë për bazë rëndësinë e këtij Projektligji, kam nderin dhe shpresoj se ju do ta shqyrtoni dhe do ta miratoni sipas procedurave adekuate. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit Ministër. Unë vetëm po ju informoj se Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 23 korrik, prandaj janë plotësuar të gjitha kushtet që ta kemi në shqyrtim të parë. Lus grupet parlamentare, apo komisionet se mund të paraqiten për fjalë lidhur me këtë Projektligj. E ka fjalën Gani Prekopuca.

GANI PREKOPUCA:

Paraqitem në emër të Grupit Parlamentar të LDK dhe ne e përkrahim Projektligjin, i cili mendojmë do të vëjë rregulla në veprimtarinë e kësaj lëmie shumë të domosdoshme në ekonominë e tregut, e në veçanti në ekonominë kosovare. Në vazhdim, në komisione ne do të japim kontributin tonë që ta begatojmë edhe më tepër. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit juve të LDK. Bajrush Xhemajli, në emër të Grupit Parlamentar të PDK.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju falemnderit. Duke patur parasysh se zejtaria në Kosovë zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e saj, dhe se në këtë Projektligj nuk ka ndonjë vërejtje serioze, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e aprovon në parim, që pastaj të shkojë në komisione, të shqyrtohet dhe ato vërejtje eventuale që mund të jenë dhe që janë të riparueshme – të shqyrtohen dhe shkohet më tutje. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Sebahatja, në emër të Aleancës. Urdhëroni.

SEBAHATE KRASNIQI-GRAJÇEVCI:

Meqë kemi sot në shqyrtim një Projektligj të hartuar majft mirë, i cili është i qartë dhe trajton e rregullon çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë zejtare, siç është regjistrimi, afarizmi, kooperimi, ndërprerja e veprimtarisë zejtare, edukimi, aftësimi dhe organizimi zejtar, po ashtu edhe ndëshkimet me rastin e parregullsisve, unë dhe Gurpi Parlamentar i Aleancës, e përkrahim në parim miratimin e këtij Projekti.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju Falemnderit shumë. Shpresoj se nuk ka më të paraqitur.

Pyes – kush është për aprovimin në parim të këtij Projektligji? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit shumë.

 Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi – All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Para se të kalojmë në pikën e ardhshme, do të doja vëmendjen tuaj ta përqëndroni për diçka që është shumëdomethënëse për Parlamentin e Kosovës, për institucionet tjera dhe për qytetarët e Kosovës.

Unë mendoj se ndaj mendimin e të gjithëve që presidentit Klinton – si Parlament në Seancën plenare – t'ia dërgojmë një telegram – me të cilin i shprehim mirënjohet

tona për punën që ka bërë dhe i dëshirojmë shërim të shpejtë dhe punë në të ardhmen – të suksesshme.

(Duartroktje)

Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës...

(Ndërprerje)

Mirë që s'paska qenë mikrofon i kyçur për transkript, domethënë s'paska bërë gabim.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve me 28 korrik 2004, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftohet ministri për kulturë, rini dhe sport Behxhet Brajshori, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të prezentojë Projektligjin. Ministër fjala është e juaja.

Na falë Behxhet. Urdhëroni...

LIRAK ÇELAJ:

Është fjala se ligji nuk na është shpërndarë komplet, do të thotë është vetëm një e treta e ligjit, prandaj ne nuk kemi mund ta shqyrtojmë dhe ky është një gabim teknik, e nuk e dij prej nga është bërë. Është vetëm deri te neni 75, që na ka ardhë materiali, kështu që ne s'kemi mund me punue. E konsultova pak më parë edhe administratën dhe e konfirmuan se është një gabim teknik.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Fatmir urdhëroni...

FATMIR SEJDIU:

Unë desha për një kërkesë, zoti kryetar, para se të shkojmë më tej. Ta shohim arsyen e mungesës së përfaqësuesve të Qeverisë si sponsor kryesor të këtyre projekteve. Disa nga projektet janë aq të domosdoshme, që në ditën e nesërme, nëse Qeveria nuk është – ta zëmë kryeministri që ka për ta prezentuar Projektligjin për financimin e partive politike – të autorizohet dikush, do të thotë – e para – që të vijë ai. Nëse jo, atëherë personi tjetër – ministri i Qeverisë në mënyrë që të mos presim dhe të mos ndodh të prolongohen. Kjo vlenë edhe për projektet tjera. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Gjithësesi kjo është e domosdoshme. Kjo që e tha deputeti Çelaj, e pamundëson shqyrtimin. Unë nuk mund ta arsyetoj e as që i kam edhe informatat pse ka ngjarë kështu. Prandaj, duhet ta heqim deri nesër, por më parë po i pyes këta të shërbimit. Meqë në ndërkohë qenka shpërndarë, dhe lus komisionin funksional të punojë, ju lutem, në mënyrë që ta kemi nesër në shqyrtim. A pajtoheni me këtë? Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarve.

Edhe për këtë nuk është sponsori i ligjit do të thotë mbetet për nesër.

Vazhdojmë me – Shqyrtimin e parë të Projektligjit për librin amzë.

Sponsori nuk është – shtyhet për nesër.

Ju lutem për pak durim.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e vulave të IPVQ. Edhe për këtë mungon sponsori, dhe nuk dua emrat t'i përmend, po më sygjerohet nga administrata për s'dua t'i përmend.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazetën zyrtare të Kosovës. Mungon sponsori dhe mbetet për nesër.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat. Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 29 korrik dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ministri është këtu. Ftohet ministri për ekonomi dhe financa, zoti Ali Sadriu që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezentojë Projektligjin. Ministër, foltorja është e juaja.

ALI SADRIU:

Falemnderit zoti kryetar. E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë, Kam kënaqësi që t'ju prezentoj Projektligjin për administratën tatimore dhe procedurat, i cili Projektligj plotëson Rregulloren e UNMIK-ut 2000/20 mbi administratën tatimore dhe procedurat tatimore.

Nxjerrja e një ligji të tillë është paraparë edhe në Programin ekonomik të Qeverisë me qëllim që sistemi tatimor i Kosovës të avancohet dhe të jetë më afër standardeve të Bashkimit Evropian. Ky Projektligj është oparaparë edhe në sferën e përmbushjeve të standardeve për Kosovën. Prandaj, rëndësia dhe aprovimi i një ligji të tillë janë të mëdha dhe në interes të shumëfishtë.

Ligji mbi administratën tatimore dhe procedurat, vendos rregullat dhe procedurat gjithpërfshirëse për administratën tatimore dhe kontributeve tashmë të vendosura në legjislacion efektiv të Kosovës, e që janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Ky ligj rregullon, zëvendëson – thash – rregulloren 2002/20 mbi administratën tatimore dhe aktet e ndërlidhura, siç janë: direktiva administrative nr. 2000/6, direktiva administrative 2000/7 dhe udhëzimin administrativ tatimor 2000/1 mbi organizimin e procedurave të administratës tatimore.

Duke u nisur nga fakti se dispozitat e mësipërme kanë hyrë në fuqi përpara se të hyjë në fuqi edhe Rregullorja e UNMIK-ut për tatimet e veçanta, siç është ajo e tatimit të parashikuar me Rregulloren 2000/29, me rregulloren që rregullon TVSH 2001/11, të kontributeve pensionale 2000/35, të tatimit në fitim 2002/3 dhe të tatimit të të ardhurave personale 2002/4, rezulton se është mëse e nevojshme të miratohet dhe aprovohet i një ligji të tillë.

Ky Projektligj është i dizajnuar që të marrë në konsideratë përvojat e deritanishme të administratës tatimore, por edhe njëherit të korrigojë dhe avancojë disa fusha me qëllim që t'i japë Kosovës mundësi juridike për ngritjen e administratës tatimore në nivel më të lartë dhe të realizojë strukturat e saj sipas formave të avancuara evropiane.

Projektligji ndahet në 14 pjesë me gjithsej 67 nene.

Pjesa e parë, themelon me ligj administratën tatimore të Kosovës, si një agjencion të veçantë brenda Ministrisë për ekonomi e financa, duke ndjekur kështu transferimin e këtyre funksioneve nga UNMIK-u në institucione vetëqeverisëse të Kosovës, transfer ky që ka ndodhur në shkurt të vitit 2003.

Gjithashtu, ky Projektligj specifikon pozitën brenda administratës tatimore dhe përcakton kriteret juridike për emërimin dhe shkarkimin nga detyrat e përcaktuara me këtë ligj.

Pjesa e dytë, me Projektligj saktësohen interpretimet, qofshin ato publike a private, të cilat administrata tatimore në të ardhmen i lëshon për tatimpaguesit, me legjislacionin tatimor të Kosovës interpretimet janë të specifikuara dhe si të tilla të detyrueshme për administratën tatimore, duke rritur kështu stabilitetin dhe sigurinë e tatimpaguesve në aplikimin e ligjeve tatimore.

Pjesa e tretë, rregullon lëminë e numrave identifikues tatimor, sipas të cilëve obligohen tatimpaguesit që të jenë të pajisur me numrin identifikues. Njëherit, sipas këtij Projektligji, administrata tatimore njeh të gjithë numrat identifikues që aktualisht janë shpërndarë nga agjencitë e ndryshme, numra këta që janë lëshuar nga institucionet përkatëse.

Pjesa e katërtë, e pestë dhe gjashtë, rregullojnë regjistrimet tatimore, deklaratat tatimore dhe pagesat tatimore. Përkatësisht, këto pjesë obligojnë tatimpaguesit që të mbajnë regjistrimet në lidhje me detyrimet e tyre tatimore, të drejtën e administratës tatimore për të pasur qasje në libra të tilla të regjistrimit, përfshirë këtu edhe fuqinë për të parë kopjen, konfiskuar apo mbajtur këto libra në përputhje me ligjin. Ko pjesë saktëson edhe standardet në lidhje me plotësimin e formave të deklaratave vetëvlerësuese nga ana e tatimpaguesve, si dhe të drejtën për plotësimin e vlerësimeve nga administrata tatimor, kur deklaratat e tatimpaguesve nuk janë plotësuar ose janë plotësuar në mënyrë jokorrekte. Gjithashtu kjo pjesë rregullon në mënyrë të detajuar pagesën e tatimit, afatet kohore si dhe vendi ne pagesës.

Pjesa e shtatë, përcakton autoritetin e administratës tatimore në mbledhje të detyrueshme të tatimit nga tatimpaguesit delikuent. Shumica e këtyre fuqive janë vijim i fuqive ekzistuese që administrata tatimore tani i ka në fuqi, ku pos tjerash përfshihen kompetencat për të paditur në gjyq, vendosjen e ngarkesave tatimore, lëshimi i urdhëresës, vjeljes ndaj palës së tretë në lidhje me pasurimi ne tatimpaguesit, kompetencat për të konfiskuar dhe më tej për të shitur pasurinë e konfiskaur, si dhe kompetencat për të lëshuar urdhëresën për tatimin në rrezik në

rast se administrata tatimore gjykon se tatimi është i rrezikuar nga veprimet e ardhshme të tatimpaguesit.

Pjesa e tetë, përcakton veprimet që duhet të mirren ndaj shmangies tatimore përkatësisht përcakton rastet kur tatimpaguesit rregullojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të atillë që ligjrisht t'i shmangen pagesës së tatimit. Ata tatipagues të cilët e bëjnë këtë nëpërmjet mjeteve joligjore dhe vazionit fiskal janë subjekt i ndjekjes penale.

Pjesa e nëntë, sqaron dhe përcakton ndëshkimet që aplikohen ndaj tatimpaguesve, të cilët nuk zbatojnë kërkesat e sistemit tatimor në Kosovë. Ai ruan në vazhdimsi të drejtën e ndëshkimit ndaj tatimpaguesve të cilët dëshirojnë të plotësojnë deklaratat e tyre tatimore ose dështojnë të paguajnë tatimin e tyre në kohë sipas përkufizimeve ligjore.

Pjesa e dhjetë, përcakton llojet e veprave penale, siç janë evazioni tatimor, shfrytëzimi abuziv i pozitës zyrtare nga ana e zyrtarëve të administratës tatimore si dhe dëshmitë në krijimin dhe ruajtjen e librave dhe regjistrimeve tatimore.

Pjesa e njëmbëdhjetë, rregullon të drejtën e tatimpaguesit gjatë procesit të ankesave. Tatimpaguesi ka të drejtë të bëjë ankesë ndaj vendimeve të administratës tatimore. Realizimi i ankesave në shkallën e parë do të realizohet në departamentin e ankesave pranë administratës tatimore. Shkalla e dytë e ankesës do të realizohet në bordin për shqyrtim të pavarur, ndërkaq shkalla e tretë e ankesës do të realizohet në gjyq.

Pjesa e trembëdhjetë, flet për konfidencialitetin. Kjo pjesë saktëson se administrata tatimore duhet të konsiderojë dhe ta ruajë si konfidencialitet informacionin personal të marrë nga tatimpaguesit, me përjashtim të rasteve kur tatimpaguesi autorizon lëshimin e të dhënave të tij. Kjo masë është e rëndësishme për integritetin e administratës tatimore dhe të sistemit tatimor. Përjashtimet e ndryshme nga kjo rregullore përcaktohen me pjesë të veçantë të këtij ligji.

Të nderuar deputetë, aprovimi i këtij Projektligji do të mundësojë që pos segmenteve që u përmendën, të avancojë edhe këto procese: përcjell me efektshmëri të afarizmit të biznesit; realizimin e kontrollit të efektshëm të punës të të punësuarve në administratën tatimore. Ky Projektligj krjon hapësirë të mjaftueshme juridike në zvogëlimin e evacionit fiskal, favorizon bizneset nga aspekti i penaleve dhe interesit; zvogëlon evacionin fiskal në kontekst të dokumentacionit të origjinës së mallit, duke krijuar hapësirë për konkurrencë lojale; përcakton dhe stimulon mbajtjen e librave dhe regjistrimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Duke patur të gjitha këto parasysh, të nderuar deputetë, më lejoni që në fund t'ju lus për mirëkuptim dhe ky ligj të miratohet sa më parë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Hapim debatin në parim. Për fjalë është paraqitur – sipas kësaj në ekran – Berat Luzha, besoj në emër të Grupit Parlamentar të PDK.

BERAT LUZHA:

Grupi Kuvendor i Partisë Demokratike miraton në parim këtë ligj dhe shpreson se do të procedohet shpejt në komision dhe të miratohet. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Gani Prekopuca – LDK.

GANI PREKOPUCA:

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim përkrah këtë Projektligj me të cilin besoj në komisione do të hasim në begatim të tij. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Sebahate Krasniqi, në emër të Aleancës.

SEBAHATE KRASNIQI-GRAJÇEVCI:

Po ashtu, në emër të Grupit Palamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrahim miratimin në parim të Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat dhe njëherit shprehim gatishmërinë që gjatë punës në komisione ta japim kontributin tonë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra të pranishëm.

Duke shpreh përkrahjen time parimore të miratimit në parim të propozimligjit për administratën tatimore dhe procedurat, më lejoni t'i shpreh disa sygjerime, të cilat për Komisionin funksional – vlerësoj – do t'ishin të dobishme lidhur me begatimin e tij.

Në kuptimin përmbajtësor të shtetit, në konceptin e rëndësishëm me rëndësi është administrimi tatimor dhe i kontributit të përcaktuara me ligj. Pa arritjen e efekteve të inkasimit dhe të administrimit të tatimeve nuk mund të bisedohet për funksionimin e mirë të shtetit, ngase tatimi i paragjykuar, tatimi në fitim, tatimi në të ardhura personale, TVSH – kërkojnë një administrim të mirë dhe bashkëkohor. Dhe, e tërë kjo varet nga funksionalizimi dhe funksionalizimi i administratës tatimore rajonale, administratës tatimore të Kosovës dhe Ministrisë për Ekonomi e Financa. Në veçanti për t'i arritur efektet pozitive në strategjinë tatimore duhet forcuar masat ndaj smangësve tatimor, ndëshkimet dhe kontrollimet profesionale ndaj tatimbledhësve duke patur çdoherë parasysh tatimin real.

Mendoj se administrata tatimore duhet të jetë sa më reale, e saktë në vlerësimet e detyrimeve të tatimpaguesit dhe jo rrallë ndodhë që vlerësimet të jenë jo të drejta.

Bazuar në gjendjen e tanishme, mund të konkludohet se administrata tatimore ka nevojë të ketë një organizim më të mirë funksional, me më shumë të drejta dhe përgjegjësi në sferën e tatimit.

Vlerësoj se emërimi, kushtet dhe përgjegjësitë e drejtorit të administratës tatimore nuk janë të harmonizuara me dispozita tjera të ligjeve të zbatueshme të nxjerra nga Kuvend dhe rregulloret që rregullojnë këtë çështje, siç është Ligji për shërbimet civile të Kosovës. Kjo vlenë edhe për zëvendësdrejtorin, menaxherin rajonal që nga momenti i emërimit dhe procedurat e shkarkimit, obligimeve dhe përgjegjësisë.

Mendoj se me këtë propozimligj nuk është rregulluar si duhet dhe sa duhet çështja e tatimpaguesve për organizatat joqeveritare që veprojnë në Kosovë, e disa nga to janë tipike profitore, andaj edhe duhet tatimuar.

Vlerësoj se ligji nuk mund të thirret në rregulloret. Përkundrazi, në këtë propozimligj kemi disa raste të tilla tipike si për shembull në nenin 12 pika 3. Pa arsye pothuaj në çdo dispozitë të nenit të këtij propozimligji përsëritet – sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë, në vend të - sipas ligjeve në fuqi.

Në propozimligj nuk janë përcaktuar procedurat për ndryshimin e vlerësimeve në tatim.

Vlerësoj se në kohën e vlerësimit të tatimit të të gjitha llojeve tatimore brenda afatit të gjashtë viteve, është afat shumë i gjatë.

Propozimligji duhet të përcaktojë masat më të rënda ndëshkimore për çdo punëdhënës i cili nuk përmbush kontributet për pensione dhe sigurime të të punësuarve, duke ua përcaktuar edhe shkallën e interesit në pajtueshmëri me obligimet dhe ligjin.

Propozimligji nuk ka përcaktuar procedurat e tatimaguesve që kanë paguar më tepër ose për të drejtat e të vlerësuarit brenda bordit të pavarur si rishqyrtim i kthimit të pagimtatimit. Administrata tatimore nuk mund ta shesë çdo pasuri të tatimpaguesit përmes ankandit publik sepse këto janë përcaktuar edhe me ligje tjera. Disa dispozita dhe masa ndëshkimore përsëriten në këtë propozimligj dhe do t'ishte mirë të mos bëhet kjo.

Thënë në tërësi, përcaktimi i së drejtës së ankesës dhe i shqyrtimit të saj, në afatin prej 60 ditëve është shumë i gjatë dhe mendoj se duhet këtu të kemi kujdes që në përgjegje të ankesave të jetë afati më i shkurtër.

Përkarshi të këtyre të gjitha sygjërimeve që e kam të vetmin qëllim ta begatoj këtë, unë përkrahi miratimin e këtij propozimligji në këtë fazë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Kush është për aprovim të këtij Projektligji në parim?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Prandaj, ligji shkon në procedurë të mëtejshme.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Në rend dite është – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentime. Mungon sponsori, nesër shqyrtohet.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrin.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 29 korrik dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftohet ministri për kulturë, rini dhe sport, zoti Behxhet Brajshori që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezentojë Projektligjin. Ministër fjala është e juaja.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari zoti kryetar, Kryesi e nderuar, të nderuar deputetë,
Kam kënaqësinë që para jush të paraqet Projektligjin për teatrin dhe më lejoni që me rastin e paraqitjes së ekspozesë së shkurtër në lidhje me këtë Projektligj të tërheq vëmendjen tuaj në rrethanat që është shtruar nevoja për hartimin e tij, si dhe në efektet që priten të arrihen me zbatimin e këtij ligji.

Hartimi i Projektligjit për teatrin është rezultat i punës së Ministrisë së Kulturës, punës ekipore të ekspertëve vendës, i konsultimit të dokumenteve ndërkombëtare të fushës së teatrit dhe i legjislacionit të një numri të vendeve të Evropës si dhe të ekspertëve të Këshillit të Evropës, andaj është ky rast i mirë falënderimi për të gjithë ata që ndihmuan në hartimin e këtij Projektligji.

Projektligji për teatrin përcakton bazat dhe parimet e organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të teatrit si formë e të shprehurit artistik dhe të zhvillimit të sistemit teatror në Kosovë.

Me këtë Projektligj krijohen kushtet për një zhvillim artistikisht më të avancuar dhe më të qëndrueshëm të artit skenik në Kosovë. Me këtë rast shpresojmë se infrastruktura juridike që tani po krijohet do të jetë një faktor shumë i rëndësishëm për një zhvillim më dinamik dhe më cilësor të veprimtarisë teatrore në Kosovë.

Me këtë Projektligj janë përcaktuar normat dhe kriteret e formimit të një institucioni teatror me dispozita të hollësishme për organizim të brendshëm, programimin e punës dhe repertoarit teatror, mënyrën e sigurimit të mjeteve për punë dhe veçoritë tjera të organizimit të teatrit si institucion publik.

Me këtë Projektligj është përcaktuar mënyra e menaxhimit të teatrit, punët dhe përgjegjësitë e drejtorit të teatrit dhe të bordit artistik dhe është përcaktuar qart fushëveprimi dhe përgjegjësia e secilit.

Me kapitull të veçantë është përcaktuar statusi i Teagrit Kombëtar, si institucion i nivelit qendror i artit teatror të Kosovës, që kultivon vlera të dramaturgjisë kombëtare dhe asaj botërore.

Po ashtu, me këtë Projektligj, Teatri Kombëtar i Kosovës dhe Teatri i Gjakovës dhe ai i Gjilanit bëhen teatro me ansambël rezident dhe realizojnë repertoar të verifikuar e të qëndrueshëm artistik dhe obligohen që shfaqjet e tyre t'i distribuojnë edhe nëpër teatro tjera të Kosovës. Pastaj rregullohet mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës në teatër dhe mënyra e stimulimit material të ansamblit artistik. Kjo iu garanton artistëve cilësor dhe atyre që angazhohen në numër më të madh shfaqjesh për një status më të mirë material.

Dispozitat ligjore për qeverisjen e Teatrit Kombëtar, aplikohen po ashtu në mënyrë përkatëse edhe në organizimin dhe funksionalizimin e teatrove tjera publike, ndërsa për teatrot private dhe trupave teatror është lënë hapësirë më fleksibile si në procedurën e formimit të tyre ashtu edhe për ushtrimin e veprimtarisë së tyre teatrore.

Me këtë Projektligj, parashihen edhe format e financimit të veprimtarive teatrore në Kosovë.

Projektligji po ashtu rregullon edhe statusi në shtëpive të kulturës, të cilat shndërrohen në qendra të kulturës dhe të artit. Ato trajtohen si institucione publike, me kapacitete dhe infrastrukturë fizike administrative të domosdoshme për shërbimet e prodhimit, të edukimit, të përhapjes, të promovimit dhe të shfaqjes së veprave teatrore dhe të veprave të tjera artistike e kulturore.

Deputetë të nderuar,

Në procesin e hartimit të Projektligjit është marrë parasysh një numër i sygjërimeve nga ekspertët e Këshillit të Evropës dhe të propozimeve të artistëve nga debati publik. Në këtë mënyrë, Projektligji i është përshtatur parimeve të standardeve ndërkombëtare për veprimtarinë skenike, por njëkohësisht i është adaptuar edhe nevojave dhe realitetit kosovar në këtë fushë.

Ministria e Kulturës është e ndërgjegjshme se Projektligji i propozuar ka edhe zbarstësira të veta juridike. Por, në përgjithësi, ky Projektligj promovon një koncept bashkëkohor dhe funksional për teatrin, i cili me një angazhim të shtuar, qoftë të organeve përgjegjëse për teatrin, qoftë të bartësve të veprimtarive teatrore – do të mund të jetësohej dhe kështu do të mundësonte një ndryshim kuantitativ dhe kualitativ të veprimtarisë teatrore në Kosovë, duke konsideruar këtë veprimtari si një nga nivelet më madhore të kulturës së një populli.

Me shpresë se jam përpjekur të qartësoj parimet themelore si dhe qëllimet e qëllimet e proozimligjit për teatrin, ju ftoj ta mbështetni të njëjtin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Për fjalë është paraqitur Mevlyde Saraçi. Fjala është e juaja Mevlyde.

MEVLYDE SARAÇI:

I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, do t'i them disa fjalë rreth Projektligjit për teatrin.

Ky ligj aq i domosdoshëm për veprimtarinë teatrore e skenike në Kosovë vjen në Kuvend si ligj relativisht i mirë, i cili deridiku plotëson kërkesat e kësaj veprimtarie si pjesë e vlerave të kulturës dhe të artit të qytetarëve të Kosovës.

Objekti i këtij ligji do të përcaktojë funksionimin dhe zhvillimin e sistemit teatror në shkallë kombëtare.

Me këtë ligj caktohet statusi i teatrove në Kosovë, duke filluar nga Teatri Kombëtar i Kosovës deri te teatrot e qyteteve dhe shtëpive të kulturës.

Po ashtu me këtë ligj sanksionohet edhe financimi i teatrove.

Edhe pse ky ligj duhet të plotësohet me amendamente nga Komisioni funksional dhe deputetët, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës thërret deputetët që ta aprovojnë këtë ligj në lexim të parë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mevlyde, ju falemnderit. Zoti Lirak Çelaj e ka fjalën. Urdhëroni Lirak.

LIRAK ÇELAJ:

Të nderuar zonja dhe zotrinj,

Para se të hyj në analizën e ligjit, vetëm do të flas lidhur me memorandumun shpjegues për Projektligjin për teatrin, ku përmbajtja e këtij memorandum shpjegues s'ka lidhje me përmbajtjen e ligjit. Ka aq shumë gjëra inkompatibile me ligjin, përmenden gjëra që aspak nuk përmenden në ligj.

Për shembull, përmenden teatrot regjionale, që në Projektligj nuk janë askund. Pastaj thuhet se në nenin 25 deri 28 trajtohet çështja e këshillit artistik. Këtë çështje e përmendi edhe ministri, kurse në ligj askund nuk kemi të përmendun as këshill apo bord artistik. Pastaj përmenden kushtet me të cilat duhet një qytet ta themelojë një teatër ku duhet t'i ketë mbi 100 mijë banor, edhe kjo nuk përmendet askund në Projektligj. Ka edhe shumë gjëra tjera, e mos të hyj më gjerësisht, që janë kontradiktore do të thotë në memorandumun shpjegues.

Projektligji për teatrin shihet qart se më së shumti është mbështetur në Ligjin kroat për teatrin. Unë gjithnjë mendoj se ndoshta do të ishte më mirë ta marrim përvojën e ndonjë shteti më me përvojë në demokraci, gjegjësisht me këtë rast të ketë më të zhvilluar veprimtarinë teatrore. Nuk mendoj se është Kroacia shembulli më i mirë në këtë aspekt.

Përkthimi i ligjit ka sjellur edhe emërtime të pakuptimta, si teatrot e nivelit kombëtar të qytetit. Unë mendoj se kjo kategori duhet të hiqet plotësisht, kurse teatrot të klasifikohen në teatro kombëtare ku institucioni më i veçuar do të ishte ai i Teatrit Kombëtar të Prishtinës dhe teatrot tjerë, të cilët do të klasifikoheshin si publik dhe privat.

Gjithashtu mendoj se teatrot kombëtare duhet të themelohen me ligj.

Ky Projektligj ka gjithashtu shumë nene e fraza të cilat nuk i takojnë natyrës së ligjeve. Për shembull –“repertorë të verifikuar artistik dhe të qëndrueshëm”, ose –“teatri ndihmon nivelin e vetëbesimit dhe mirëkuptimit shoqëror”, e shumë e shumë gjëra të tilla që janë të panevojshme që nuk e kanë vendin në ligj por në ndonjë politikë të ministrisë apo strategjinë e ministrisë që e bën.

Problem tjetër – shumë i madh i këtij Projektligji – është se futen nene në ligj të cilët do të duhej të ishin pjesë e statuti dhe rregullores së teatrove. Për shembull neni 28, ku flet për numrin e aktorëve që duhet ta ketë trupa artistike, pastaj neni 29 për numrin e premirerave dhe reprizave; shumën e pagesave të aktorëve dhe shumë procedura që do të duheshin të mbesin në politikat dhe mënyrën e menaxhimit dhe do të rregulloheshin mes tatut dhe rregullore të vetë institucionit.

Ligji ka edhe disa mangësi tjera të vogla të cilat nuk vlejnë të përmenden në leximin e parë, por shpresoj se me amendamentet e posaçme do të rregullohen.

Pjesa më e mirë e këtij ligji, është neni 8 ku teatrove iu jipet status i benificuar publik.

Duke shpresuar se këto mangësi do të evitohen gjatë punës së mëtutjeshme të Kuvendit, Grupi Parlamentar i PDK përkrah në parim Projektligjin.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falënderit. Sabit Rrustemi është paraqitur. Urdhëroni Sabit.

SABIT RRUSTEMI:

Falënderit zoti kryetar. E nderuar Kryesi e punës, deputetë, Ky është Projektligji i pestë nga Ministria për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Jorezidente që na vjen në Kuvendin e Kosovës. Natyrisht e mbështes mendimin e parafolësve se është ndër projektligjet e mira, nuk po them është nga më të përkryerit, por vjen si një domosdo e rregullimit të fushës së teatrit në Kosovë, një fushë që është shumë specifike dhe në interes të vetë Kosovës dhe kulturës sonë në përgjithësi.

Besoj se e gjithë ajo që është paraparë në Projektligj, por edhe që do të plotësohet më pas përmes Komisionit për kulturë, rini dhe sport do ta begatojë edhe më tutje këtë Projektligj dhe çështja e teatrove e sidomos e teatrove kombëtare në nivel të Kosovës tash e tutje - mendoj nga fillimi i zbatimit të këtij ligji - nuk do të jetë më diskutabile por do të jetë e qëndrueshme.

Këtu u përmend dhe parashihet edhe në ligj çështja e financimit të teatrove dhe e sigurimit të hapësirave për punë të teatrove në Kosovë. Megjithatë, mbetet për t'u dëshiruar edhe më shumë nga kjo sferë, sepse për aq sa parashihet dhe mundësohet me ligj nuk mjafton për një teatër kombëtar apo për teatro që këtu po thuhet do të jenë regjionale, mendohet në Teatrin e Gjakovës dhe të Gjilanit. Edhe një kohë do të duhej që teatrot në Kosovë veçanërisht tri teatro – me përvojën më të gjatë të punës – ta kenë edhe më tutje një privilegjë në financimin dhe realizimin e projekteve të tyre artistike.

Çështja tjetër, dhe si rast i mirë është sidomos te teatrot nëpër komuna të bëhet më shumë edhe përmes këtij Projektligji me hapësirat e tyre për punë. Ne jemi dëshmitar se shumë teatro që veprojnë nëpër qytete të Kosovës veprojnë në kushte të këqia të punës, mase përmes këtij Projektligji duhet të adresohet një përgjegjësi më e madhe nëpër komuna në mënyrë që ata të kenë kushte për punë.

Mbështes në parim këtë ligj dhe përmes Komisionit besoj do t'ia dalim ta rrumbullaksojmë punën që na është besuar. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Bujar Dugolli, pastaj Gani Sadik le të bëhet gati.

BUJAR DUGOLLI:

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duke mbështetur vërejtjet parimore dhe vërejtjet profesionale të deputetit Çelaj, ne mendojmë se gjatë shqyrtimit të dytë dhe me punën që do të bëhet në komisionet përkatëse do të përmirësohet Projektligji dhe për këtë lexim ne i japim mbështetje parimore dhe do ta votojmë. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Tani e ka fjalën zoti Gani Sadik.

GANI SADIK:

Falemnderit zoti kryetar. Unë në emër të Grupit të Tjerëve, Projektligjin e mbështes. Me të vërtetë një punë të mirë e kanë bërë. Natyrisht se unë personalisht e kam pritur më parë këtë ligj ta kemi sepse konsideroj që teatri është një pasqyrë e një populli. Pra, do ta japim votën dhe e mbështesim Projektligjin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Tani ju ftoj që të deklarohe mi për mbështetjen në parim.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Për dy projektligjet tjera që janë në rend dite, mungon sponsori. Do të vazhdojmë nesër në orën 10. Mirëupafshim.

(Me kaq, Seanca plenare e datës 08.09.2004 përmbylli punën)

(Seanca vazhdoi punën me datën 09.09.2004, në orën 10,00.)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes. Mirëseardhje në Seancën e rregullt të vazhdimit të Seancës së djeshme. Mirëseardhje kryeministrit të Kosovës doktor Bajram Rexhepit dhe ministrave.

Vazhdojmë me pikën e radhës që e kemi në shqyrtim:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e partive politike në Kosovë.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 29 korri, prandaj edhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj kryeministrin, doktor Rexhepi që ta mbajë fjalën hyrëse. Foltorja është e juaja, kryeministër.

BAJRAM REXHEPI:

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë të Kuvendit,

Në këtë Seancë të Kuvendit po paraqesim për shqyrtim Projektligjin për financimin e partive politike në Kosovë. Këtë Projektligj e ka përgatitur dhe hartuar Zyra ligjore e Kryeministrit, kurse finalizimi i tij është bërë në Grupin e ekspertëve. Ndër të tjera, në këtë Grup kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e partive politike më të mëdha dhe vërejtjet e sygjyerimet e tyre janë marrë parasysh. Po ashtu kanë qenë të ftuar edhe përfaqësuesit e partive politike më të vogla dhe të komuniteteve minoritare.

Vetë Projektligji përfshin gjithsej 20 nene që në mënyrë komplekse rregullohet tërë problematika e financimit të partive politike, duke filluar nga dispozitat themelore ku parashihen:

- rregullat dhe parimet e përgjithshme të financimit të partive politike;
- rregullohet aspekti i burimeve financiare.

Në këtë pjesë përcaktohen format dhe llojet e burimeve financiare, pastaj mënyra dhe kriteret e ndarjes së mjeteve financiare;

- ndihmat financiare për fushatat zgjedhore;
- lejimi dhe ndalimi i ndihmave financiare;
- përgjegjësia financiare gjatë fushatave zgjedhore;
- donacionet dhe rregullat që përcaktojnë në mënyrë precize shumat e tyre, mënyrat dhe format e mbledhjes së mjeteve financiare;
- përgjegjësia për shfrytëzimin e këtyre mjeteve financiare;
- publikimi i shfrytëzimit të mjeteve financiare;
- obligimet e kandidatëve për deputetë dhe këshilltarë;
- obligimet e mbajtjes së dosjeve dhe kontrolli i jashtëm financiar;
- regjimi ligjor i të ardhurave të partive politike;
- kontrolli i brendshëm;
- dispozitat ndëshkimore;
- dhe si pjesë e fundit e këtij ligji – dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në këtë pjesë përfundimtare, Projektligji rregullon të hyrat nga taksat dhe gjobat dhe vetë hyrjen në fuqi të Projektligjit.

Të nderuar deputetë,

Me këtë Projektligj rregullohet një fushë e cila deri më tani ka qenë sipërfaqësisht e rregulluar por jo në tërësi e precizuar me rregulla moderne dhe dispozita të cilat në tërësi e mbulojnë fushën në fjalë. Zbrastësia juridike, e cila ka mbretëruar për shkak të mungesës së ligjit si ky, me aprovimin dhe miratimin e këtij Projektligji sot do të plotësohej.

Duke patur parasysh se në hartimin e këtij Projektligji kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të partive politike, ju ftoj në vazhdim që të shqyrtoni Projektligjin në

fjalë, duke i pranuar sygjerimet tuaja në formë të amendamenteve, ashtu që ky Kuvend të marrë edhe vendimin për miratim. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryeministër, ju falemnderit. Njoftoj Seancën që 76 deputetë janë të pranishëm, dhe mund të marrim vendime të plotëfuqishme.

Hap debatin në parim.

Për fjalë është paraqitur zoti Fatmir Rexhepi, besoj në emër të LDK. Urdhëro Fatmir.

FATMIR REXHEPI:

I nderuari kryetar i Parlamentit, zoti kryeministër, të nderuar deputetë, Në emër të Grupit Parlamentar të LDK, do të paraqes vlerësimin dhe përkrahjen në parim të këtij Projektligji për financimin e partive politike, duke ditur se është një ndër ligjet që kërkohet në paketën e standardeve për Kosovën me prioritet.

Këtë që dëgjuam nga ekspozea e kryeministrit lidhur me rëndësinë e këtij ligji, kujtoj se për veprimtarinë, organizimin dhe aktivitetin e partive politike ka rëndësi të madhe ky ligj, meqenëse këto parti politike marrin pjesë në ndërtimin e institucioneve të vendit tonë.

Dy fusha kryesore të financimit në Projektligj janë financimi i aktiviteteve të rregullta të partisë dhe financimi apo lejimi i mjeteve të veçanta për fushatën zgjedhore.

Projektligji është i shkurtër, me vetëm 20 nene, por në masë të mirë e mbulon këtë sferë të veçantë të partive politike dhe financimin e tyre, duke vendosur pra bazën ligjore në përputhje me standardet. Prandaj, ligji përcakton burimet financiare të partive politike, siç është anëtarësia, donacionet, veprimtaritë ekonomike dhe mjetet nga buxheti i Kosovës; Saktëson qëllimet e shfrytëzimit të këtyre mjeteve, si dhe kriteret dhe ndarjet drejt të mjeteve financiare publike, e cila është në pajtim të plotë me kapacitetin e përfaqësimit dhe të organizimit të partive politike në Kosovë, gjerësa në kuotën proporcionale ai stimulon partitë e vogla.

Në Projektligj janë përcaktuar format e grumbullimit të mjeteve financiare dhe donacionet dhe rregullat për shfrytëzimin e tyre.

Vend i posaçëm i është dhënë transparencës dhe publikimit të shpenzimeve, si dhe raporteve financiare, periodike e vjetore nga institucionet përkatëse të partisë.

Janë saktësuar pra detyrimet dhe detyrimet e përgjegjësitë e partive politike, por në parim vërejtja - që mund të plotësohet gjatë procedimit nga ana e komisioneve – do të ishte se ligji s'duhet të bazohet në rregullore të caktuara të cilat i ka kaluar koha dhe të mos kemi dualizma, të thjeshtësohet çështja e donacioneve dhe sqarohet më mirë se sa është në ligj.

Sa i përket nenit 17 pikë 6, në parim nuk pajtohem me kompetencat që janë futur brenda këtij ligji lidhur me imunitetin e deputetit dhe kujtoj se ajo duhet të rreugullohet me ligj tjetër, jo brenda këtij ligji.

Dhe, një hapësirë duhet, brenda ligjit, të parashihet mundësia që nga buxhetet komunale apo vetanake të komunave të ndajnë po ashtu sipas mundësisë së tyre edhe kuvendet komunale për participimin për financimin e partive, ndoshta deri në një mijë euro për këshilltar, që do ta vlerësonte secila komunë në buxhetin e tyre paraprak dhe mundësinë e lejimit të këtyre mjeteve.

Me këto vërejtje parimore, ne mbështesim këtë Projektligj. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Gani Koci, besoj në emër të Partisë Demokratike. Fjala është e juaja Gani.

GANI KOCI:

Falemnderit zoti kryetar. I nderuari zoti kryeministër dhe ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Megjithëse i vonuar por shumë i domosdoshëm ky ligj ka mbështetjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për faktin se partitë politike janë aktore kryesore të zhvillimeve demokratike, janë aktore kryesore në formimin e ndërgjegjes dhe në shprehjen e vullnetit politik të qytetarëve, si dhe në krijimin e institucioneve shtetërore. Në këtë aspekt, është legjitime që nga buxheti shtetëror të ndahen mjete për financimin dhe funksionimin e tyre, po aq sa është legjitime që opinioni publik të ketë informim të garantuar për financimin e partive politike.

Miratimin e këtij Projektligji, Grupi Parlamentar i PDK e sheh si objektiv të krijimit dhe rritjes së një transparence të financave të partive politike, burimet e këtyre financave, menaxhimin dhe kontrollin e tyre. Kosovës i ka munguar, siç e thash edhe në fillim, një ligj i tillë dhe në mungesë të tij askush nuk mund të dijë se për pesë

vjet nga janë financuar partitë politike, edhe pse formalisht pranë OSBE kanë dorëzuar ndonjë raport financiar.

Qëllimet e këtij Projektligji, konsideroj se janë këto, dhe janë të arritura: krijimi i kuadrit ligjor për këtë çështje; vendosja e standardeve për një minimum të domosdoshëm të financimit të partive politike nga financat publike; burimet e lejueshme të financimit; rregullimi dhe kufizimi i kategorive të dhuruesve dhe dhuratave apo donaciveve, siç jemi mësuar të themi; forcimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes financiare; rritja e mëtejme e transparencës nëpërmjet deklaramit dhe publikimit të burimeve financiare dhe shpenzimeve të tyre dhe forcimi i sanksioneve për shkelësit e normave që rregullojnë këtë çështje.

Natyrisht se hartuesi i këtij Projektligji është dashur të ketë parasysh edhe tri rregullore, që akoma janë në fuqi – rregullorja e UNMIK-ut 2004/2, ajo 2004/12 dhe rregullorja 2004/11 që rregullojnë çështje të caktuara, por secila rregullore të njëjtën çështje e rregullon në mënyrë të ndryshme, prandaj këtu krijohet një labirinth – ta quaj kështu – juridik, gjë që do t'ishte mirë që kjo të harmonizohet përderisa ato rregullore janë në fuqi.

Pa dashur që të hyj edhe në vërejtjet që i tha edhe parafolësi im, konsideroj se ky Projektligj duhet të kalojë në miratimin në parim dhe në miratimin e tij përfundimtar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Për fjalë është paraqitur zoti Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë – në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë dhe ministra,

Projektligji për financimin e partive politike në Kosovë ofron zgjidhje për një prej problemeve më të ndieshme të partive politike. Jo vetëm që krijon lehtësi në financimin e partive politike, jo vetëm që krijon transparencën në mënyrën se si financohen partitë politike, por ndoshta – besoj dhe shpresoj – do ta mbyll, ta quaj kushtimisht, atë pikën e zezë të deritashme të financimit të partive politike.

Deputetët e Grupit Parlamentar të Aleancës e përkrahin në parim këtë Projektligj dhe do të angazhohen që në shtyrë të detyrës së tyre të vënë në vëmendje dhe përmirësojnë përmes amendamenteve. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. E ka fjalën Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar të të Tjerëve. Urdhëro Gani.

GANI SADIK:

Ju falemnderit zoti kryetar. Zoti kryeministër, ministra, minishtreshë e jonë, të nderuar deputetë,
Në emër të partive të vogla – të tjerët, desha ta falënderoj Qeverinë dhe partitë të mëdha politike të Kosovës për mirëkuptim dhe ndihmë.

Jemi për këtë Projektligj dhe do ta votojmë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Ju falemnderit shumë. Meqë nuk kam kërkesë për pjesëmarrje në debat, ju ftoj që të deklarohe mi për mbështetje në parim të këtij Projektligji.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For	Të gjithë – Svi - All
Kundër – Protiv – Against.....	00
Abstenim – Uzdržano – Abstained.....	00

(Ndërprerje)

Vetë fakti që u vonova derisa e gjeta faqen tregon se kam një lutje për hirë të kohës që është e rezervuar dhe ta shqyrtojmë Projektligjin për shërbimin privat, e pastaj kalojmë në atë të shkencës. Dhe pa humbur kohë vazhdojmë. Ligji iu është shpërndarë të gjithë deputetëve me kohë dhe janë plotësuar të gjitha kushtet për ta shqyrtuar. Ministre, fjala është e juaja.

(Reagim – pa kycje të mikrofonit?)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë, në parim, plotësisht e mbështes dhe për atë i thash edhe kryeministrit që jemi të kënaqur që Qeveria gati në përbërje të plotë është sot, por ky është rast vërtetë që ishte dashur të kemi mirëkuptim gjatë shqyrtimit të këtillë të rendit të ditës dhe të bëjmë përjashtim. Në parim do të thotë ju mbështes juve, por ministreshë fjala është e juaja. Urdhëroni.

RESMIJE MUMXHI:

E nderuara Kryesi, i nderuar zotri kryetar, të nderuar deputetë,
Së pari më lejoni që ta përshëndes fillimin e procedurës parlamentare për miratimin e ligjit për veprimtari private në shëndetësi, i cili do të plotësonte legjislacionin e nevojshëm në lëmin e shëndetësisë dhe njëherit do të ndihmonte qoftë edhe në masë të vogël qëllimin e përmbushjes së standardeve për statusin e Kosovës.

Me këtë rast, edhe njëherë desha t'ju përgëzoj për punën tuaj në begatimin e ligjit për shëndetësi të Kosovës dhe miratimin e tij nga ky Kuvend, ligj që këto ditë edhe është nënshkruar nga përfaqësuesi special i sekretarit gjeneral.

Këto ligje – ai për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve, si dhe një numër i udhëzimeve administrative të nxjerra nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, synojnë të vendosin një rregull dhe kontroll më gjithpërfshirës në të dy sektorët e shëndetësisë – atë publik e privat, që do të mundësojë një përkujdesje më të mirë shëndetësor për qytetarët e Kosovës.

Draftprojektligji – për veprimtarinë private në shëndetësi, krijon bazën e domosdoshme ligjore që do të mbështesë zbatimin e Ligjit për shëndetësi të Kosovës, zhvillimin e sektorit në shëndetësi, si dhe reformat e filluara në sektorin e shëndetësisë.

Zonja dhe zotrinj,

Përpilimi i legjislacionit në lëmin e veprimtarisë private përkon me synimin e Qeverisë së Kosovës për të siguruar bazën ligjore drejt privatizimit në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Legjislacioni ekzistues, nuk ka siguruar kornizë të qëndrueshme ligjore për ta realizuar këtë qëllim. Rezultat i kësaj ka qenë hapja e pakontrolluar e institucioneve private shëndetësore ndaj të cilave nuk ka ekzistuar asnjë mbikëqyrje profesionale. Njëkohësisht, të drejtat e qytetarëve në procesin e shfrytëzimit të shërbimeve

shëndetësore nuk kanë qenë të mbrojtura. Kjo ka sjell deri te një pabarazi në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore.

Të nderuar deputetë,

Sikur mund të vëreni nga teksti, një veçori e këtij Projektligji është se ai ka qenë qëllim që përmes normave themelore të rregullojë veprimtarinë private në shëndetësi, në shumë fusha të barazojë sistemin privat shëndetësor me atë publik, duke patur gjithmonë parasysh interesin për tërë popullatën e Kosovës, kushtin e përgjithshëm për institucionet dhe punëtorët shëndetësor, kualitetin e shërbimeve dhe mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore, si dhe përkufizimet e tepërt me qëllim që të krijojnë mundësitë për zhvillimin e mëtutjeshëm përmes akteve nënligjore.

Gjithësesi se do të paraqiten sfida në licencimin e institucioneve profesionale dhe obligimeve të institucioneve e profesionistëve, por Ministria e Shëndetësisë, përmes administrative dhe në bashkëpunim me ministrat tjerë, beson fuqimisht se do ta kalojë atë, të mbështetur nga vetë profesionistët dhe qytetarët e Kosovës.

Projektligji u siguron hapësirë ligjore për përfshirje të gjerë shoqërisë civile në procesin e sigurimit të të drejtave dhe përgjegjësi si dhe institucioneve private shëndetësore edhe ofruesve privat dhe të qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Me këtë bëhet një hap i rëndësishëm kualitativ për përmbushjen e standardeve më demokratike të një shoqërie të përparuar.

Është shumë e qart se arritja e standardeve më të larta ndërkombëtare në këtë lëmi imponon nevojën e përparimit të mëtutjeshëm sistematik të gjendjes së përgjithshme në sektorin e shëndetësisë.

Të nderuar deputetë, nisma për përpilimin e këtij ligji ka hasë në mirëkuptim të madh nga vetë profesioni shëndetësor dhe gjatë diskutimit publik ka marrë përkrahje të nevojshme si nga profesionistë vendor, po ashtu edhe nga ata ndërkombëtar.

Ky Projektligj përmban nëntë kapituj të organizuar në 30 nene. Kapituj përbërës të këtij Projektligji janë:

Kapitulli i parë – Përkufizimi. Ky kapitull jipet për përkufizimet bazike që dalin nga Ligji për shëndetësi të Kosovës.

Kapitulli i dytë – Profesionit shëndetësor në sektorin privat. Në këtë kapitull përcaktohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi dhe të drejtat e obligimet e punëtorëve privat shëndetësor.

Kapitulli i tretë – Themelimi i institucionit. Në kapitullin e tretë përcaktohen nocionet e përgjithshme për themelimin, aftësimin dhe obligimet e institucioneve private shëndetësore.

Kapitulli i katërtë – Standardet e domosdoshme të kujdesit shëndetësor në sektorin privat. Në këtë kapitull përcaktohen standardet e domosdoshme të cilat duhet përmbajtur institucionet dhe punëtorët shëndetësor.

Kapitulli i pestë – Roli i Ministrisë së Shëndetësisë. Këtu përcaktohet roli i Ministrisë në raport me zhvillimin e politikës së sektorit privat, përpilimit të normave dhe standardeve për institucionet shëndetësore dhe rolin mbikëqyrës të saj.

Kapitulli i gjashtë – Bordi. Ky kapitull përcakton themelimin, rolin, funksionin dhe detyrat, përbërjen, udhëheqjen dhe financimin e bordit për licencimin e institucioneve shëndetësore private.

Kapitulli i shtatë – Komisioni për vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencimin e institucioneve private. Me këtë kapitull përcatohen detyrat dhe përbërja e komisioneve për vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencimin e institucioneve dhe procedurat për licencimin e tyre.

Kapitulli i tetë – Mbikëqyrja e institucioneve private shëndetësore. Ky kapitull përcakton llojet, objektivat e mbikëqyrjes si dhe dispozitat disipullore dhe ndëshkimore.

Kapitulli i nëntë – Dispozitat kalimtare. Me këtë kapitull përcaktohen obligimet e Ministrisë për të nxjerrë akte përkatëse ligjore dhe nënligjore të institucioneve dhe personave të tjerë juridik dhe fizik, të cilët në pajtim me këtë ligj ushtrojnë veprimtari private shëndetësore – për të harmonizuar organizimin, punën dhe aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij ligji.

Dhe, së fundi – të nderuar zonja dhe zotrinj,

Jam e bindur, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Projektligji, përmes diskutimeve, propozimeve dhe debatit konstruktiv ju do të ndihmoni në plotësimin e tij, duke përmbushur edhe një detyrë të madhe që shtrohet para jush. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit ministreshë. Unë shpresoj se pas një hyrjeje kaq detaje, pjesëmarrësit në debat do t'ju mbështesin, dhe sot kemi një diskriminim pozitiv – i kemi të gjithë të paraqitur vetëm femra, prandaj i jipet fjala Nafije Gash, kryesuese apo kryetare e Komisionit. Urdhëroni Nafije.

NAFIJE GAŞ:

Sayin başkan, değerli milletvekilleri,
Kolegë deputetë, si gjithmonë – shumë të nderuar dhe shumë të rrespektuar,

Projektligji për shërbimin privat në shëndetësi, të cilin sot e kemi në shqyrtim të pare, është i një rëndësie të veçantë sepse rregullon një lëmi shumë të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor në sektorin privat në Kosovë.

Megjithë vërejtjen e përgjithshme se ky Projektligj mirret më shumë me çështje teknike e procedurale se sa me ato thelbësore që rregullojnë këtë lëmi dhe parashihet të bëhet më vonë me akte nënligjore që nxirren më vonë nga Ministria e Shëndetësisë, e që ngapak po na bëhet një dobësi në përcjelljen e shumicës së ligjeve, unë si kryetare e Komisionit për shëndetësi të Kuvendit të Kosovës jam që ky Projektligj të miratohet në parim sot dhe me procedurë të përshpejtuar të kalojë në leximn e dytë dhe miratimin e tij si ligj.

Në ndërkohë, për këto dy javë që na kanë mbetur, ky Projektligj do të përmirësohet me amendamente që do të propozohen dhe kështu do të konkretizohet dhe qartësohet me qëllim të përcaktimit se cili lloj i shërbimeve përkatësisht cili lloj i kujdesit dhe i mjekimit mund të bëhet në sektorin privat dhe cilat do të jenë standardet e garantuara dhe me çfarë çmimi. Përcaktimi i kriterëve dhe i konkretizimit do të rriste përgjegjësinë, cilësinë dhe kontrollin e gjithkësaj veprimtarie dhe do të krijonte siguri më të madhe për qytetarin që do të dinte çka i ofrohet ose përcaktohet për shërbimin privat shëndetësor.

Të nderuar kolegë deputetë,
Shkurt po tërheq vëmendjen tuaj për disa çështje në këtë Projektligj.

Në nenin 5, paragrafi 2, thuhet se “Veprimtaria private shëndetësore nuk lejohet në fushat e përcaktuara me Ligjin për shëndetësi” – mbaron teksti. E sigurisht propozuesi ka menduar se veprimtaria private shëndetësore nuk mund të ushtrohet në ato lëmi që nuk janë të përcaktuara përkatësisht nuk janë të lejuara me Ligjin për shëndetësi. Bie fjala, ndonjë shërbim i veçantë siç është transplatimi i organeve të

njeriut, dhënia e gjakut apo diçka e ngjashme, ku shërbimi mund të keqpërdoret apo nuk mund të ushtrohet kontroll i mjaftueshëm nga organi i mbikëqyerjes apo nga Ministria.

Po ashtu, mendoj se kreu i pestë i formuluar si “Roli i Ministrisë”, sigurisht mendohet në Ministrinë e Shëndetësisë, e dhe pse në tekst nuk shkruhet, duhet të hiqet krejtësisht, sepse Ministria e Shëndetësisë edhe në kuadër të Qeverisë së Kosovës, edhe me Ligjin themelor për shëndetësinë, e ka të përcaktuar rolin e vet dhe nuk ka nevojë të përshkruhet në secilin ligj që ka të bëjë me lëminë e shëndetësisë, apo edhe më keq që ky rol të përcaktohet ndryshe nga që e ka Ministria e Shëndetësisë me aktet që përmenda.

Në nenin 15, ku përcaktohet përfundimi i mandatit trevjeçar anëtarit të bordit të licencimit – mendoj se duhet të hiqet krejt pika c) ku thotë se “mandati përfundon kur anëtari largohet nga detyra me vendim të Gjykatës Supreme” dhe mbaron citati. Prandaj, konsideroj, nuk duhet të involvohet në vendimet për emërimet dhe shkarkimet. Këtë, në raste tjera konkretisht të përcaktuara, mund ta bënte gjykata kushtetuese, por jo nivelet tjera, ndërsa kjo pikë të zëvendësohet me formulimin në kuptimin që anëtari i bordit shkarkohet nëse denohet nga gjykata me vendim të plotëfuqishëm me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj për çfarëdo veprë, që është një parim themelor, ndërsa para kësaj propozoj që në këtë nen të përcaktohet masa e shkarkimit të anëtarit të bordit, që nuk është paraparë fare, e tek - më pastaj, në nenin 16 të përshkruhet procedura e shkarkimit.

Në nenin 17, konsideroj se nga paragrafi 1, ku parashihet që bordi financohet nga të ardhurat e veta, të fshihet e të mbetet vetëm paragrafi 2, që thotë se “kompensimi material i anëtarëve të bordit bëhet sipas akteve përkatëse nënligjore të nxjerra nga Ministria”. Këtë e kërkoj nga dëshira për parandalim të keqpërdorimeve të mundshme, sepse konsideroj bordi nuk duhet të merr përqindje të pagesave nga dhënia e licencave, ose se ky do t’ishte një konflikt interesi në marrjen e vendimit për ose kundër.

Në nenin 21, paragrafi 3, që thotë se “kundër vendimit të Ministrisë, institucioni mund të ngrehë padi në gjykatën kompetente në pajtim me ligjet përkatëse”. Konsideroj se duhet të hiqet, sepse nëse dikujt nuk i jipet licenca, ky duhet të konsiderohet vendim profesional e nuk ka gjykatë kompetente shëndetësore që do të rishqyrtonte, ndërsa nëse ka keqpërdorime e shkelje të procedurave gjatë licencimit, siç janë familjarizmi apo marrja e parave, e tjera – kjo është e denueshme dhe paraparë me kode dhe nënkupton ndjekje penale apo kundërvajtje dhe nëse kjo ndodh atëherë pala e dëmtuar rikthehet në procedurë të licencimit dhe gëzon të drejtë në kompensimit material apo tjetër për zhdëmtim.

Dhe, në fund, në nenin 29, ku thuhet se “institucionet, personat e tjerë juridik dhe fizik, të cilët në pajtim me këtë ligj ushtrojnë veprimtari private shëndetësore duhet të harmonizojnë organizimin, punën dhe aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij ligji brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi”, propozoj që kjo pjesë e fundit e afatit prej 6 muajsh duhet të hiqet, sepse me licencimin e institucionit privat shëndetësor duhet t’i përmbushë të gjitha kushtet e parapara, pra edhe këto që përmenden, ndërsa nëse propozuesi i ligjit ka menduar në institucionet private shëndetësore – që tashmë janë duke punuar, atëherë unë konsideroj që pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ato duhet t’u nënshtrohen procedurës së licencimit dhe atëherë koha për të paraqitur një kërkesë të tillë duhet të jetë 1 deri 3 muaj, kurse këtë duhet ta përcaktojmë përmes amendamentimit të këtij Projektligji varësisht nga rreziku që parashohim se paraqet për qytetarët në shëndetin e tyre ushtrimi i punës së këtyre institucioneve pa licencë.

Pra, të nderuar kolegë deputetë, ju propozoj që Projektligjin për shërbimin privat në shëndetësi, ta miratojmë në leximi ne parë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën doktoreshë Fetije Këpuska, në emër të Lidhjes Demokratike. Urdhëroni.

FETIJE KËPUSKA:

Falemnderit zoti kryetar. Të nderuar ministra, Diskutimin tim do ta filloj me një vërejtje, sigurisht e rezultuar nga shkaqet teknike. Në letrën përcjellëse, bashkë me këtë Projektligj, thuhet se për procedim dërgohet Projektligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë, në vend që të thuhet Projektligji për shërbimin privat në shëndetësi. Fjala është, syponoj, për një gabim teknik.

Ndonëse të vonuar, e konsideroj me interes të veçantë dhe jetik miratimin e këtij ligji. Miratimi i këtij ligji, padyshim, do të jetë një ndër parakushtet kryesore për rregullimin legjislativ të kësaj lëmie, shumë të rëndësishme për popullatën. Po kështu, me miratimin e këtij ligji do të mbulohen cilësisht zbrastësi ligjore të cilat deri tash kanë rezultuar pasojë për shëndetin e popullatës. Ligji pretendon dhe duhet të rregullojë organizimin dhe funksionimin e institucioneve private shëndetësore me qëllim të vetëm që të përmirësojë shëndetin, të parandalojë sëmundjet, të avancojë mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin shëndetësor. Ligji propozon dhënie të rregullt për funksionimin normal edhe shërbime e sjellje profesionale në pajtim me etikën e këtij profesioni të shenjt dhe me standarde ndërkombëtare. Pra, ligji presyponon të krijojë parakushte që nga resurset njerëzore, ato hapsinore me pajisje adekuate

teknike, si dhe të instalojë rregullsi e ligjsi që të sigurojë shërbime profesionale shëndetësore.

Në vrojtimin e propozuar janë nënvizuar dhe adresuar hallka të aspektit, procedurat, institucionet dhe nivelet që përbëjnë këtë lëmi. Gjithashtu janë thënë qartë obligimet e përbushjes së kushteve formale për punë në këtë lëmi, sigurim të personelit, licencimi, pajisja, hapësira për punë, evidencat, rregulloret, rreth orëve, tarifave të pagesave, dokumentacioni e tjera. Megjithatë, sikur nuk janë paraparë mekanizma as obligime për kontrollimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, se sa janë ato adekuate, cilat shërbime, sa janë të kushtueshme, a janë dhe sa janë pacientët të kënaqur. Në këtë Projekt-propozimligji sikur nuk ka masa ndëshkimi që nga ato materiale e deri te ato të sanksioneve, e tjera, sidomos në rastet e rrezikimit, evidentimit të shëndetit, për shkak të shërbimit jociësor, të trajtimit joadekuat, nga mosdija, mungesa e profesionalizmit, neglizhimi, zhagjitja – pra për shkak të mbajtjes së pacientit nga arsye materiale materiale pa e dërguar në adresa tjera adekuate për shërim.

E them e dhe një propozim, në doshta edhe si dilemë, për përbërjen e bordit. Është paraparë të jetë prej pesë anëtarësh – përfaqësues të institucioneve dhe të sektorëve. E shtroj si pyetje: kush e përfaqëson shtresën më të madhe në këtë relacion, pra kush është përfaqësues i pacientëve – shtresë shumë e interesuar për mirëvajtjen e këtyre shërbimeve sepse fjala është për shëndetin e tyre, për jetën e tyre në instancën e fundit.

Me këto sygjerime, unë shpreh përkrahjen për këtë Projektligj dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, propozoj që ta miratojmë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën doktoreshë Teutë Hadri, në emër të Partisë Demokratike. Urdhëroni...

TEUTË HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuar zoti kryetar, e nderuar zonja ministre, Miratimi i këtij ligji, edhe në fund të këtij mandati të Kuvendit, për qytetarët e Kosovës ka një rëndësi të veçantë sepse miratimi i tij krijon bazë ligjore për funksionimin dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve private shëndetësore, mundëson, në bazë ligjore, organizimin si dhe licencimin e këtyre institucioneve private shëndetësore të cilat deri më sot kanë punuar pa leje të organit më kompetent, siç është Ministria e Shëndetësisë. Prandaj, ky ligj, zvogëlon mundësinë

e çrregullimit të shërbimeve shëndetësore dhe keqpërdorimit të qytetarëve të Kosovës nga ana e këtyre institucioneve. Njëherit, baza e këtij ligji, që ka munguar dhe është vonuar deri më sot, mundëson aplikimin e të gjitha standardeve ndërkombëtare për funksionim në pajtueshmëri me kushtet dhe mentalitetin kosovar. Efekti i politikave shëndetësore private dot ë realizohet në pajtueshmëri me politikat shëndetësore të organizuara dhe programuara nga Ministria e shëndetësisë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK, në pari e përkrah këtë Projektligj mjaft të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm për shëndetin e qytetarëve tanë, që edhe në Programin e Partisë Demokratike ky shërbim ka patur një prioritet të veçantë.

Vërejtjet që kemi ndaj këtij Projektligji, sidomos ato teknike, mendoj se do t'i plotësojmë me amendamentimet nga Komisioni që do të punojë, kurse ne do t'i cekim ato të cilat i kemi hasur.

Në nenin 2, nën a) – që është cekur këtu – se profesionisti i kujdesit shëndetësor mund të ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në sektorin privat të Kosovës nëse është, nën a) – profesionist i licencuar i shëndetësisë. Këtu mendoj, ky profesionist, e që më poshtë është edhe “punonjës” duhet të bëhet dallimi i “profesionistit” dhe “punonjësit” dhe duhet cekur se “është profesionist i licencuar i shëndetësisë nga lëmia përkatëse e profesionit”.

Vërejtja e dytë, është te detyrimet e institucionit, neni 5 nën 2, ku veprimtaria private shëndetësore nuk lejohet për fusha të caktuara me ligjin e shëndetësisë, e këtu duhet cekur, që e tha edhe zonja Nafije, por duhet të thuhet që të mos kontrollohet tash nga ky ligj dhe të kalohet në ligj të shëndetësisë – por të thuhet në bazë të të cilit nen të ligjit të shëndetësisë, për të mos i lënë hapësirë siç është ckatuar me ligjin e shëndetësisë nga pika a) deri në g), prandaj do të duhej të jetë “veprimtari private shëndetësore nuk lejohet në fushat përkatëse me ligj të shëndetësisë sipas nenit 45 nga pika a) deri në pikën g), kështu dhe mundësohet kjo të jetë më e kuptueshme.

Dhe, pika tjetër – te kreu 6, te titulli “Bordi”... Këtu nuk është cekur bordi dhe s’dihet cili është, a është bordi i Ministrisë së Shëndetësisë apo çfarë bordi dhe duhet të titullohet dhe të ketë titull të veçantë “Bordi për licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor”. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën – edhe profesoreshë, edhe doktoreshë Zylfije Hundozi, në emër të Aleancës.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Falemnderit. Zotri kryetar dhe kryeministër, ministra të pranishëm, kolegë të nderuar,

Projektligji për shërbimin privat në shëndetësi, është një Projektligj i përpiluar qartë, nga i cili kuptohet se me të po rregullohet baza ligjore efektive për rregullimin e çështjeve në këtë lëmi, e cila gjer më tani ka funksionuar pa kurrfarë kontrolli ligjor.

Duke marrë parasysh domosdoshmërinë për këtë ligj dhe kualitetin mjaft të mirë të Projektligjit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrah miratimin në parim dhe do ta jap kontributin e tij gjatë punës në komisione për begatimin e tij. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Edhe në fund doktoreshë Nurishahe Hulaj. Urdhëroni...

NURISHAHE HULAJ:

Të falemnderit kryetar i Kuvendit. Të nderuar deputetë, të nderuar ministra, Paraqitja e këtij Projektligji për shërbimin e praksës private plotëson infrastrukturën ligjore dhe inkorporohet me Ligjin e përgjithshëm të shëndetësisë, i cili më në fund edhe është i nënshkruar.

Meqenëse parafolësit theksuan shumë gjëra, unë do t'u përqëndrojsha vetëm në një element, të cilin e kam vërejtur gjatë leximit, që e lexova me vëmendje, është fjala për Kreun e katërtë – standardet në praksën private të shëndetësisë.

Meqenëse popullata ka shumë nevojë për të drejtat e tyre edhe në praksën private, që gjer tani nuk i kanë plotësuar të gjitha nevojat e kërkuara, me këtë ligj plotësohen të gjitha nevojat e qytetarëve të Kosovës. Kreu i katërtë, ku shkruhet – standardet e nevojshme, vetëm janë paraqitur në mënyrë të përgjithshme, pa kritere të caktuara, të cilat kritere janë shumë të domosdoshme e dhe për përfaqësuesin e shërbimeve shëndetësore private, sepse çdo përfaqësues i shërbimeve private, i cili edhe udhëheq institucionin privat, duhet ta dijë minimumin e kritereve të standardeve me të cilat ai punon, si për resurset humane, si për hapësirat të cilat ai duhet t'i plotësojë ashtu edhe për pajisjet tekniko-teknologjike.

Mendoj se me amendamentimin e vazhdueshëm, këto kritere dhe standarde duhet të ceken për arsye se qytetari gjegjësisht përfaqësuesi i shërbimit shëndetësor kur e

lexon ligjin duhet të dijë kriteret minimale të stanardizimit, por në ligj kjo është lënë të bëhet me aktin e veçantë nënligjor.

Ne në parim përkrahim këtë ligj dhe ju përshtesim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Ju ftoj që në parim ta mbështesim këtë Projektligj.

Kush është për? Falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Kalojmë në pikën e radhës – shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 29 korrik, prandaj janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtim.

Ftoj ministrin për shkencë e teknologji, zotin Osmani, që ta marrë fjalën. Urdhëroni ministër...

REXHEP OSMANI:

I nderuari zoti kryetar Daci, të nderuar deputetë, zoti kryeministër, kolegë tjerë, Kam kënaqësinë që sot para Parlamentit të Kosovës të jap fjalën sqaruese lidhur me Projektligjin për kërkime shkencore, të cilin – e kuptoj pas diskutimeve që do të bëhen edhe me grupet punuese – ta miratojë Parlamenti.

Buxheti i pakt për shkencën, vetëizolimi i institucioneve kërkimore si pasojë e mungesës së njerëzve të aft për t'u përballuar me realitete të reja kërkimore-shkencore, shkoputja e kërkimeve shkencore nga nevojat e shoqërisë kanë ndikuar anë nivelin e pakandshëm të veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë.

Realiteti i ri kërkon një qasje të re. Kjo qasje e re duhet të jetë transformuese dhe zhvilluese. Për të ngritur një sistem të ri të kërkimeve shkencore në Kosovë propozohet të konceptohet një politikë e re, të konceptohet me institucione të reja shkencore, me frymën e ligjit të cilin do ta diskutoni, me mbështetje të veprimtarisë kërkimore-shkencore, me ngritje të kapaciteteve institucionale dhe intelektuale, me përcaktimin e standardeve dhe kërkimeve shkencore, me gjenjen e fondeve të nevojshme dhe me kryerjen e stimulimeve përkatëse. Vetëm kështu mund të pritët, në të ardhmen, që kërkimi shkencor të luaj rolin e forcës motorike të shoqërisë kosovare.

Besohet se masat që vijojnë pas nxjerrjes së ligjit, do ta përmirësojnë këtë situatë.

Kosova ka patur nevojë për nxjerrjen e ligjit të veprimtarisë shkencore-kërkimore edhe më parë, ka qenë një nevojë e kahershme, por tani është mëse e domosdoshme sepse në këtë fazë gjendemi në procese të periudhës transitore dhe për shoqërinë kosovare janë rrethana krejtësisht të reja.

Në përgatitjen e këtij Projektligji është punuar gjatë, por ka patur vonesë të konsiderueshme të harmonizimit midis zyrës së kryeministrit dhe grupit punues – sponsorit, përkatësisht Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Por, më në fund, janë arritur harmonizime të nevojshme.

Në hartimin e këtij Projektligji kanë marrë pjesë edhe një numër i njerëzve që kanë dije në këtë fushë dhe i është kushtuar rëndësi e veçantë konsultimit të ligjeve të avancuara në rajon dhe më gjerë në këtë fushë.

Projektligji është në harmoni me praktikën e standardeve vendore dhe atyre ndërkombëtare në përgjithësi.

Projektligji përmban shumë risi krahasuar me legjislacionin e mëparshëm.

Veprimtaria kërkimore-shkencore paraqet punën krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të arritjes së njohurive të reja dhe shfrytëzimit të tyre në praktikë, në pajtim me zhvillimet e proceseve ndërkombëtare.

Projektligji ka një koncept të ri që është në harmoni me strategjinë edhe të arsimit të lartë, i cili dokument është para miratimit dhe që premtion dhe garanton mekanizma dhe premisa për integrim të hapësirës kosovare në hapësirën evropiane për veprimtari kërkimore-shkencore.

Projektligji inkurajon dhe parashikon në mënyrë të re punën e veprimtarisë kërkimore, duke bërë dallime në mes të organeve që zgjedhen dhe atyre që i zgjedhin, si dhe organeve që drejtojnë dhe atyre që menaxhojnë.

Projektligjin e përshkon një koherencë në paraqitjen e mendimit, që shprehet në çdo nen dhe lidhmërinë e tyre me njëri-tjetrin, koherencë që përshkohet nga neni i parë e deri te ai i fundit.

Nxjerrja e ligjit për kërkime shkencore është bërë në bazë të modelimit të standardeve ndërkombëtare dhe përcakton dhe rregullon këtë aktivitet përmes parashikimit të procedurave, për disiplinim të punës kërkimore shkencore, stimulim, koordinim dhe planifikim, duke patur parasysh kushtet ekonomike, politike dhe shoqërore të Kosovës dhe rrethinës së saj.

Pastaj ekzistojnë mundësitë që pas miratimit të ligjit, institucionet shkencore të miratojnë aktet e brendshme dhe të kenë në disponim dhe shfrytëzim fonde të krijuara nga kërkimet shkencore dhe aktivitetet tjera të ngjashme. Institucionet shkencore, po ashtu, mund të hartojnë rregullativën e tyre për veprimtarinë e komisioneve dhe të avancimit shkencor. Po ashtu, ky ligj pastaj hap rrugën edhe për propozim të një ligji tjetër, një ligj i cili do të flet për pronësinë intelektuale, patentat, licencat dhe përparimet teknike, dhe po ashtu edhe të drejtën e autorit.

Me këtë ligj formohet këshilli kombëtar për kërkime shkencore, një bord këshilldhënës i cili shqyrton dhe propozon përparësitë e zhvillimit të shkencës dhe hulumtimet kërkimore-shkencore në Kosovë.

Të gjitha institucionet shkencore mund të krijojnë njësi të kërkimit shkencor, të cilat i përgjigjen përgatitjes së propozimeve dhe projekteve dhe përcjelljen e zbatimit të tyre.

Po ashtu, krijohet një mundësi e re e bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë që, së bashku me institucionet shkencore, mund të formojnë qendrën kërkimore-shkencore me karakter referal shkencor për të gjitha institucionet e shkollimit të lartë dhe të institucioneve shkencore, të cilat mund të jenë në lidhje të bashkëpunimit me qendrën kërkimore të përbashkëta me një organizatë ndërkombëtare.

Nuk do ta zgjasja më shumë lidhur me këtë, por do të ftoj që në grupet punuese të komisionit parlamentar me amendamente të veçanta të pasurohet ky ligj dhe të miratohet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Profesor Sabri Hamiti e ka fjalën. Urdhëroni profesor.

SABRI HAMITI:

Më në fund kemi përpara një ligj që, unë kujtoj, është dashur të jetë më herët, por edhe tash është mirë, dhe më mirë tash se më vonë.

Ne, një kategori njerëzish që jemi këtu dhe në Kuvend, por edhe atje ku punojmë, e që jemi ndeshur me probleme reale të gjendjes së dijes te ne viteve të fundit, e dijmë më mirë se të tjerët pse po them unë kështu. Ne kemi tri vite faktikisht që funksionon edhe Ministria dhe e ka emrin Ministri e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë por në kuptimin e veprimit konkret, për mungesë – unë do të thosha fillimisht të ligjit, por ndoshta edhe të vullneteve të veçanta – këto dy pjesët tjera të Ministrisë faktikisht s'kanë punu – është shkenca e teknologjia. Arsimi po.

Duhet të them se nevoja është e shpejtë që të miratohet ligji dhe të futet në veprim. Po e them konkretisht këtë, sepse ne po ndërtojmë një diskurs të vetëlavdërimeve rreth çdo ligji, por problemi është sa po vëhen në veprim. Ky ligj, nëse s'vëhet në veprim menjëherë – kurgjo s'kemi bë. Pra, për ne është esenciale, po e theksoj këtë rast, për të patur parasysh edhe rastet tjera sa zbatohen këto ligje. Në shkencë është koha e fundit që ligji të miratohet dhe të funksionojë. Ne s'kemi kurrfarë të ardhurash në shkencën tonë, në anën tjetër – ajo dije që është ndërtuar edhe si sistem edhe si nivel, te ne, për arsye shumë të njohura, gati është shkapërdërdhur viteve të fundit, në anën tjetër ne s'kemi krijuar kurrfarë statusi për shkencëtarët. E ky vend, nëse do të nxirret diqysh, do të nxirret nga dija. Ndryshe s'ka shansë.

Prandaj, unë e konsideroj ligjin në përgjithësi të ndërtuar mirë, që prekë që nga nevoja e hartimit të tij pjesën që do të mund të quhej organizim i dijes dhe pjesën tjetër që do të mund të quhej dija në aplikim, ose dija në veprim. Domethënë, ajo që krijohet këtu të materializohet në zhvillimin e Kosovës. Dhe, këtu unë e pëlqej këtë mënyrë të ndarjes në kërkimet fundamentale, aplikative dhe ato zhvillimore, se kapin pakashumë atë që quhet edhe dije edhe aplikim i saj.

Ajo që më duket që është mirë – përfundimisht, është që kemi dy pika themelore të konstruksionit të ligjit dhe të legalizimit të organizimit të dijes në Kosovë që kap një – që quhet programi nacional kërkimor-shkencor, një që do të duhej të kuptohej si strategji do të thosha e zhvillimeve të Kosovës dhe e shkencës në Kosovë dhe një që quhet – tash po e quaj unë – organ të fortë, a – rregullativ – këshilli kombëtar i shkencës. Ky i dyti, që do të duhej ta mbledhte normalisht një elitë vërtetë

shkencore, do të duhej që të sygjeronite, të kontrollonte dhe të verifikonte kërkimet – nevojat.

Më vjen mirë që ky këshill kombëtar i shkencës, dhe duhet të zgjedhet në Kuvend sipas propozimit të ligjit dhe që ky program nacional kërkimor-shkencor duhet të verifikohet në Kuvend dhe unë e shoh një pikë shumë të mirë të këtij ligji, sepse jep gjerësinë totale dhe përgjegjësinë më të madhe të mundshme të tyre.

Kur jemi këtu, ndoshta unë propozoj që ky këshill kombëtar i shkencës të emnohet pak më ndryshe. Kur kam lexuar, funksionet që i jipen, mua më duket që shumë më drejt është t'i thuhet qendra kërkimore e shkencës e Kosovës edhe për një arsye tjetër. Për arsye se kemi në një rang pak më të ulët këshilla për lëmi të veçantë të shkencës. Po them, ndoshta është mirë që ky i pari, më i madhi, që është kombëtar, të quhet qendra kërkimore.

Unë në pika themelore veç mund të them se është mirë që të precizohet neni 69, ku thuhet që të gjitha institucionet që janë regjistruar më 78 ose 98 punojnë, është e paqartë, por ne në diskutim të mëvonshëm do ta shohim këtë problem. Dhe në anën tjetër, atje ku propozohet që mund të jetë drejtor institucioni shkencor njeriu me titull bashkëpunëtor shkencor, unë them jo. Më së pakti bashkëpunëtor i lartë shkencor! Ju falemnderit, sepse sinjali po më jipet...

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit profesor. E ka fjalën profesoreshë Drita Statovci, në emër të Partisë Demokratike. Urdhëroni...

DRITA STATOVCI:

I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra dhe të nderuar të gjithë të pranishëm,

Projektligji për veprimtaritë kërkimore-shkencore ofron zgjidhje të mira dhe të pranueshme për zhvillimin e një veprimtarie të rëndësishme sa humane aq edhe shkencore. Projektligji ndërtohet mbi parimet dhe vlerat kompatible të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e dijes dhe të hulumtimeve shkencore. Me një strukturë të mirë ligjore, ky Projektligj pretendon funksionimin dhe zhvillimin e vlerave të nivelit shkencor dhe të kriterëve adekuate shkencore.

Megjithë rrespektin për tërësinë e elementeve të avancuara, që do ta ndihmojnë zhvillimin e shkencës dhe të shoqërisë, këtij Projektligji mund t'i bëhet edhe ndonjë sygjërim.

Një. Projektligji shpjegon dhe përcakton titujt shkencor dhe barazvlerën e tyre në institute ose në universitete. Një realitet i tillë do të pëlqejë të sanksionohet edhe me rastin e kalimit të kuadrit shkencor nga institutet në universitete dhe të tjera të ngjashme.

Dy. Disa çështje shfaqen në dukje teknike ose gjuhësore, por në realitet janë shumë të thella dhe ndryshojnë zërbërthimin e drejtë të dispozitave ligjore. Një i vetmi zë, një e pa zë – për shembull - e munguar ose e tepërt ngatërron ministrinë si individ dhe ministrinë si institucion. Ose teksti i një alineje ka ndonjë fjali që nuk përfshihet njësoi në të tri gjuhët. Ose, përdorimi apo përkthimi i paqart i institucioneve, nocioneve pra – qeveri dhe ministri dhe të tjera ngatërime në thojza të palejueshme. Këtu lypset qartësuar dhe rregulluar drejt.

Si tërësi, Projektligji është i mirë dhe i punuar me kujdes, prandaj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe në emrin tim, shpreh mbështetjen e këtij Projektligji në parim dhe i dëshiroj procedim dhe ndërtim të mbarë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Dugolli, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Urdhëroni...

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit zoti kryetar. Nuk ka dyshim se edhe në Kosovën e paraluftës, po edhe të pasluftës kësaj veprimtarie nuk i është kushtuar rëndësi e duhur nga shteti, sepse nuk ka patur shtet, dhe shpesh jemi vënë para dilemave se a ka shkencë të mirëfilltë dhe a ka inteligjencë të mirëfilltë Kosova. Kjo ka ndodh për shkak se nuk kishte bazë juridike, një përkrahje shtetërore për të gjithë ata talentë, gjithë ata intelektual dhe shkencëtar që i ka Kosova.

Unë mendoj se tani, me miratimin në parim, që do të pasojë edhe miratimi i plotë i këtij ligji, ne do ta krijojmë një bazë të mirëfilltë, e cila është e mbështetur edhe në parimet bashkëkohore ndërkombëtare në lëmin e hulumtimeve shkencore dhe kështu do të krijojmë një perspektivë për shkencën dhe inteligjencën kosovare.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e mbështet në parim dhe do të angazhohet që në punën e mëtejshme ta japë kontributin e vet. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se t'ua jap fjalën diskutuesve tjerë, do të doja që për herë të parë dy-tri fjalë t'i them si deputet.

Ajo që është brengosëse – është fakti se në shkencë humbja e viteve nuk t'mundëson të kyçesh atje ku je ndalur, por ka një kthesë enorme të madhe prapa. Dhe, fjalët e profesor Sabriut dhe të të gjithë tjerëve kishin domethënie për këtë. Është brengosëse që sponsori i ligjit – institucioni ka filluar shumë herët përgatitjet për këtë ligj, dhe janë dashur më tepër se 6 muaj të arrijë në Parlament, pa e fajësuar individualisht askend. Kjo tregon sa jemi të kthyer prapa si Kosovë dhe në qoftë se nuk veprohet në implementimin e ligjeve, që është bërë praktikë në Kosovë, ligjet tona shumëpak aplikohen, dhe në këtë mënyrë ne do t'i kontribuojmë kthimit apo ecjes prapa të Kosovës dhe është e pafalshme se në këtë përbërje, edhe të Qeverisë, edhe të Parlamentit ka shumë njerëz që e dinë shumë mirë këtë çështje.

Prandaj, shpresoj se Komisioni funksional, në radhë të parë, dhe grupet parlamentare do të bëjnë tentim që në amendamente të fusin edhe përqindje të GJDP të Kosovës sa duhet të ndahet. Çdo shtet në botë e ka këtë. Ne nuk guxojmë ndryshe. Unë me vëmendje jam munduar ta përcjell këtë ligj, dhe kjo i mungon. Prandaj, do të lutja Komisionin funksional dhe deputetët të kenë kujdes.

Një shtet – një popull të cilit nuk i prinë shkenca – nuk ka ardhmëri të ndritshme.

Për fjalë është paraqitur minsitri Brajshori. Urdhëroni ministër.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar kolegë ministra, Sot paraqitem në cilësinë e deputetit për të diskutuar lidhur me këtë Projektligj, i cili konsideroj se është njëri nga ligjet më të rëndësishme dhe që mbulojnë njërin nga fushat më të rëndësishme sikur që është veprimtaria kërkimore shkencore dhe do të thoja se vërtetë kemi një vonesë në këtë drejtim.

Ajo që dua të them, lidhet me nenin 21 të Projektligjit dhe kriteret për themelimin apo ushtrimin në veprimtari kërkimore shkencore që një institut duhet t'i përmbushë dhe konkretisht me pikën b). Mendoj se edhe Komisioni funksional dhe komisionet tjera duhet ta analizojnë më shumë këtë çështje. Në bazë të kësaj

parashihet që një institut mund të ushtrojë veprimtarinë nëse ka së paku 10 punëtorë shkencor dhe hulumtues në marrëdhënie të përhershme pune, dhe kjo është për kohë të pacaktuar do të thotë, prej të cilëve së paku 3 doktor shkencash. Mendoj se kjo duhet të analizohet pak më shumë nga konteksti i gjendjes ekonomike në Kosovë dhe tjera.

Dhe e dyta, që e tha edhe kryetari i Kuvendit, nëse nuk sigurojmë një bazë materiale për një zhvillim të veprimtarive shkencore në Kosovë kam frikën se ligjet e tilla nuk do të mund të aplikohen. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Profesoresë Exhlale Salihu e ka fjalën, le të përgatitet Fetije Këpuska.

EXHLALE SALIHU:

E nderuara Kryesi, të nderuar zotri ministra dhe kolegë deputetë, Në cilësinë e anëtares së Komisionit për shkencë, arsim e teknologji, më lejoni t'i them nja dy-tri fjalë për mos t'ua marr kohën e çmuar.

Ky ligj, sa është i vonuar, aq më shumë është i mirëseardhur. Natyrisht, duke lexuar këtë Projektligj, jam ndalë te nja dy-tri gjëra që m'kanë ra në sy, dhe të njëjtat po i përmendi.

Së pari, do të ndalësha shkurt te titulli, apo te nocioni i ligjit – Projektligji për hulumtime shkencore. Mendoj do t'ishte më me vend: projektligji për veprimtari kërkimore-shkencore, apo kërkimoro-shkencore dhe për veprimtaritë kërkimore-shkencore. Besoj se duhet vënë një nocion i caktuar dhe më i drejtë dhe kjo – mendoj është punë punë gjuhëtari, prap: për veprimtari kërkimore-shkencore.

Tjetra, jam ndal te drejtori. Drejtori i institutit, do të thotë – zgjedhet personi që përmbush kushtet për t'u zgjedhur; së paku bashkëpunëtor shkencor, mund të jetë edhe bashkëpunëtor i lartë, aty nuk do të hyj, mirëpo duhet të jetë – dhe i profilit të institutit në fjalë. Do të thotë, me profesion duhet t'i përgjigjet atij instituti.

Tjetra. Jam ndalë te zgjedhjet në tituj shkencor dhe hulumtues, më tepër te titujt shkencor. Në përcaktimin e kushteve për zgjedhjen e titujve shkencor, mendoj se duhet bërë korrigjime esenciale.

Duke mos e mohuar rëndësinë e çdo vepre shkencore, jam e mendimit se për zgjedhjen e titujve shkencor të punëtorëve shkencor duhet bërë vlerësimi i

tërësishtëm i veprimtarisë kërkimore-shkencore të personit në fjalë me poena nga ana e profesionalistëve vendor dhe të huaj, e mos të shkohet me shabllone të caktuara të kufizuara, por së pari: vepra – një, dy, tri e me radhë, meqë kalojmë në formalitet dhe mund të zhvillojmë një libromani, e në shkencë lypset kualiteti. Në këtë veprimtari shkencore, së pari mendoj se do të hynin para se gjithash: pjesëmarrja në projektet ndërkombëtare; në tubimet shkencore ndërkombëtare jashtë vendit, në të cilat prezentohen rezultatet e punës kërkimore-shkencore dhe ku me fakte janë dëshmuar të dhënat për një problematikë të caktuar shkencore; si dhe publikimi i punimeve në gjuhë të huaja në revistat shkencore po ashtu jashtë vendit. Por, edhe nëse është fjala për vepër shkencore, do të vlerësohet prap me poena. Meqë ka vepra që ka të bëjë me një projekt të gjerë, realizimi i së cilës ka zgjatur me vite, kështu që edhe vepra është e karakterit të tillë.

Dhe, në fund do të shtoja se, megjithë rrespektimin ndaj studiuesve vendor, njëri recensent gjithësesi do të duhej të jetë një studiues i huaj.

Në fund, megjithatë gabime gjuhësore që unë s'i kuptoj sepse janë bërë të zakonshme këtu, dhe nuk kuptoj se si një njeri që shkruan në gjuhën amtare, e për shqipen është karakteristike "ë"-ja e a jo humbet fare. Kjo me të vërtetë është e pakuptimt, sikur që e tha edhe zonja Statovci, sepse ishte puna e ministrisë dhe e ministrit dhe unë s'mundja shpeshherë ta kuptoj a është fjala për ministri apo për ministër, por le të shkojë si të tjerat.

Dhe, së fundi, unë e përshëndes këtë ligj dhe e miratoj në parim, e pastaj edhe me amendamente prap nga komisionet do të bëhet korrigjimi i këtyre vërejtjeve. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Do të lusja diskutuesit tjerë për rrespektim të kohës. Fetije Këpuska, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi. Urdhëroni Fetije.

FETIJE KËPUSKA:

Falemnderit zoti kryetar. Zoti ministër, ministra të nderuar, Mendoj se puna kërkimore-shkencore, si një veprimtari me kujdes të veçantë shoqëror duhet të përcillet e të rregullohet me legjislacion adekuat.

Zhvillimi i kësaj lëmie është i domosdoshëm për secilin vend, secilën shoqëri sepse është një kondicio sine kuanon që në përkthim do të thotë: kusht pa të cilin nuk bën.

Veprimtaria kërkimore-shkencore ka një rëndësi të shumëfishtë për Kosovën dhe sidomos për zhvillimin e saj në të ardhmen si përgjegje ndaj sfidave dhe vështirësive me të cilat përballlet çdo shoqëri.

Qëllimi i ligjit, siç është konceptuar, është avancimi cilësor i kësaj lëmie, që punën kërkimore-shkencore do ta bënte më të avancuar, më cilësore, më konkurrenente në skenën ndërkombëtare dhe natyrisht edhe më të dobishme në zhvillimin e Kosovës.

Mendoj se Projektligji në mënyrë gjithpërfshirëse dhe adekuate ka paraparë rregullimin e çështjeve relacionet mes subjekteve dhe mes institucioneve që përbëjnë këtë veprimtari komplekse, duke caktuar kompetencat, përgjegjësitë dhe obligimet për punë normale e cilësore të kësaj veprimtarie.

Gjithashtu, janë përcaktuar mirë parimet që kanë të bëjnë me themelimin dhe veprimtarinë, me organizimin, me infrastrukturën, me menaxhimin dhe me financimin e kësaj lëmie, e cila – po e përsëris – është me interes shumë të madh për Kosovën, si një vend me një shkallë të zhvillimit jo aq të lakmueshme.

Në Projektligj janë marrë parasysh dhe instaluar përvojat dhe modelet e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga vendet tjera me shkallë më të lartë të zhvillimit. Si i tillë, Projektligji do të hapë shtigje, mundësi e gjasa për zhvillimin edhe më të vrullshëm të punës kërkimore-shkencore.

Në një kapitull të Projektligjit janë caktuar personat juridik, publik, kërkimor-shkencor, kushtet e themelimit dhe karakteristikat e tyre si dhe institucionet private të cilat kanë leje për këtë veprimtari; janë caktuar dhe emërtuar edhe organet udhëheqëse, siç janë këshilli drejtues, këshilli shkencor dhe drejtori. Në këtë kapitull, të këtij konteksti, sygjeroj të bëhet një përcaktim më i sakt i kompetencave të secilit veç e veç, pra një katalog më i mirë i kompetencave dhe i përgjegjësive, që eventalisht të mos ketë ndeshje mes tyre apo dualizëm veprimi. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dhe Ramadan Kelmendi. Urdhëroni Ramadan.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë,
Duke u pajtuar me diskutuesit e mëparshëm, më lejoni edhe unë ta përkrah parimisht miratimin e propozimligjit për veprimtari shkencore, por duke vlerësuar se ka qenë shumë e nevojshme që Kosova edhe fushën hulumtuese-shkencore ta rregullojë me

ligj, nga se kjo është edhe një kërkesë e integriteteve evropiane, duke mundësuar edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e veprimtarisë kërkimore-shkencore të Kosovës.

Ajo që veçoj, është fakti pozitiv se Kosova ka patur dhe ka inteligjencë dhe shkencë mbi të cilën ngrit themelimin e institucinit qendror kërkimor-shkencor dhe programin kombëtar të hulumtimeve shkencore, por duhet shikuar që këto institucione të domosdoshme të jenë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin mbi shkollimin e lartë në Kosovë apo me ligjin mbi Akademinë e Shkencave të Kosovës dhe ligjet e veçanta. Propozimligji njeh mirë kriteret e veprimtarisë shkencore-kërkimore, por si duhet lë paksa anësh aftësimin e kuadrove të reja në fushën kërkimore-shkencore duke obliguar që institucionet, fakultetet dhe individët shkencor në to të përgatisin kuadra të reja hulumtuese-shkencore jo vetëm në fushën e magjistraturës dhe doktoranturës por edhe në ngritjen e institucioneve me karakter tipik hulumtues shkencor në të gjitha lëmitë në Kosovë.

Me propozimligj duhet të përcaktohet struktura e këshillit kombëtar shkencor, gjegjësisht të këshillit qendror shkencor në kuadër të të cilit do të përcaktohen edhe kriteret dhe mënyra e udhëheqjes, e anëtarësimit dhe format tjera të punës.

E drejta e institucioneve private hulumtuese shkencore nuk duhet kontestuar, por para se gjithash duhet përcaktuar regjistrimi dhe kushtet e plotësimit për të arritur këtë, kuadrin dhe format tjera që janë të obliguara për çdo institucion e të mos jetë imitues kërkimor-shkencor. Institucioni kërkimor-shkencor duhet dalluar shprehimisht me ligj dhënien e gradave dhe titujve shkencor të karakterit shkencor.

Vlerësoj se vetë fakti që kemi të bëjmë me institucionet kërkimore-shkencore drejtori i institutit dhe punëkërkuesit shkencor nuk duhet caktuar në pajtueshmëri me Ligjin mbi shërbimet civile por me Ligjin mbi arsimin e lartë apo një ligj të veçantë. Më duket paksa e paarsyeshme që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të mbajë regjistrat e punëtorëve shkencor-hulumtues në vend se ato t'i mbajnë institucionet apo fakultetet që i dhënë dhe themelohen.

Edhe mënyra e lidhjes dhe shprehjes së shpesht të punës kërkimore shkencore hulumtuese duhet të saktësohet me statut, ligjin themelor për punën, kontratat dhe karakterin kolektiv të tyre, sepse ashtu siç është paraparë, propozimligji lë hapësirë dhe interpretime joadekuate.

Mendoj – këshilli kombëtar, pajtohem plotësisht me profesor Hamitin – të quhet këshilli qendror kombëtar shkencor, përveçse duhet të përcaktohen dhe të jipen vlerësime a ka për obligim që të japë edhe vlerësime shkencore-hulumtuese mbi

proceset politike aktuale orientuese në Kosovë, në momente të caktuara në veçanti të shkakimit të krizave qofshin ato të brendshme apo jashtme që mund të shkaktohen, duke paraqitur edhe strategjinë ekonomike, ndërkombëtare, politiko-juridike të zhvillimit orientues të vendit.

Mendoj se punëtorët shkencor nuk duhet të lidhen me moshën 60 vjeçare, lexo nenin 75 pika 2, sepse edhe në pension nuk shkohet në këtë moshë e jo më të mirret me punë hulumtuese-shkencore.

Në tërësi pajtohem që ky ligj të aprovohet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Ju ftoj që ta përkrahim në parim Projektligjin.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Prandaj, autorizohen komisionet që të vazhdojnë punën e mëtejshme.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Vazhdojmë me shqyrtimin e parë të Projektligjit për patentime.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 29 korrik, prandaj nuk ka pengesa në përmbushjen e kushteve për shqyrtim. Ftoj ministrin Ali Jakupi ta paraqesë fjalën hyrëse. Urdhëroni ministër.

ALI JAKUPI:

Ju falemnderit zoti kryetar. I nderuari kryetar i Kuvendit, e nderuara Kryesi, të nderuar deputetë e ministra,

Me kënaqësi të veçantë para jush prezentoj ligjin për patentet. Kosovës i mungojnë dispozitat ligjore për rregullimin e çështjeve të patentimit. Në këtë drejtim, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim ekonomik si dhe për zhvillim në

përgjithësi nevojiten krijime të mundësive për shpikjen e inovacioneve, me të cilat stimulohen teknologjitë dhe të arriturat tekniko-shkencore.

Ligji është i hartuar nga ekspertë të mirëfillt vendor dhe ndërkombëtar. Grupet punuese të ekspertëve kanë shqyrtuar dispozitat nga vendet e ndryshme të kësaj lëmie për ta hartuar një draft që pas miratimit në formë të ligjit do të mundësojë kthesa të rëndësishme në lëmin e patenteve.

Ligji është i hartuar në 17 kapituj, me gjithsej 81 nene.

Në këtë Projektligj janë dhënë definicione për shpikje të patentueshme, për inovacione, shkallën e risive dhe zbatueshmërinë e tyre industriale. Janë precizuar lëndët që mbrohen me patent dhe ato janë shpikjet që kanë të bëjnë me produktet që përbëhen nga materiali biologjik ose që përmban material biologjik, procesin në të cilin prodhohet, përpunohet ose përdoret ai material biologjik si dhe materiali biologjik i izoluar nga mjedisi i tij natyror, ose që prodhohet në procese teknike madje edhe kur më herët ka ndodhur në natyrë.

Po ashtu, sipas dispozitave të këtij Projektligji janë të sanksionuara përjashtimet nga mbrojtja me patent.

Në draft vërehen në spikamë shpikësi dhe e drejta e njohjes, e drejta e patentës që i përket shpikësit ose trashigimtarit të ligjshëm, aplikuesit për patent.

Rregullohet procedura e zbatimit për dhënien e patentit, punë këtë që e bën zyra e pronësisë industriale që duhet të veprojë në kuadër të Ministrisë, Tregtisë dhe Industrisë; regjistrat e patentave që mbahen pranë zyrës për regjistrimin e patentave; përdorimi i rezultateve të procedurave për dhënien e patentës. Për kryerjen e këtyre punëve definohej dokumentet që duhet aplikuesi t'i dorëzojë në zyrën përkatëse, përcaktohen taksat dhe pagesat për shpenzimet procedurale.

Çështjet lidhur me të drejtat e përparësisë, si dhe kushtet për njohjen e së drejtës së përparësisë rregullohen me këtë Projektligj. Në mënyrë taksatative rregullohet përmbajtja e aplikimit për patent duke përfshirë përshkrimin e shpikjes, kërkesat e patentimit e tjera. Rregullohet procedura deri në publikimin e aplikimit për patent, duke filluar nga shqyrtimi i aplikimit për patent pas aplikimit nga zyra, regjistrimi i aplikimit për patent në regjistrin e aplikimit për patent, çertifikata e së drejtës së përparësisë që ia lëshon zyra aplikuesit, ndarja e aplikimit për patent dhe parakushtet e publikimit të aplikimit për patent. Dhënia e patentës precizohet me dispozita përkatëse, me çka nënkuptohet se aplikuese në afatin prej 6 muaj nga data e aplikimit për patent në buletin zyrtar mund t'ia dorëzojë zyrës për dhënie të

patentës si dhe rregullohet përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së patentave, përmbajtja e publikimit, përmbajtja dhe forma e çertifikatës, e tjera. Përfshihet konfirmimi i patentës së dhënë, madje efektet e patentës dhe aplikimit për patent, përkatësisht të drejtat ekskluzive të fituara me patent, ku saktësohet se patenta përbën të drejtë pronësie, se pronari i patentës e ka të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes së mbrojtur dhe çdo personit tjetër i cili nuk ka pëlqimi në pronarit të patentës i ndalohet të kryejë aktivitete, si bie fjala – të prodhojë, të ofrojë për shitje, të shesë, të përdorë, të eksportojë apo importojë ose të mbajë në depo për qëllime të theksuara produktin e fituar në bazë të shpikjes së mbrojtur. Drafti përfshin të drejtat ekskluzive lidhur me patentat në fushën e bioteknologjisë, të drejtat nga aplikimi i publikuar për patent, masat dhe të drejtat ekskluzive të pronarit të patentës, kontratën e licencës për bartje të të drejtave. Përfshihen kufizimet e efektive të patentës, ku bëjnë pjesë: përjashtimet nga e drejta ekskluzive, e drejta e shfrytëzuesit të mëparshëm, kufizimi i efekteve lidhur me patent në fushën e bioteknologjisë, shuarja e së drejtës ekskluzive të pronarit të patentës, mjetet e trafikut në qarkullimi ndërkombëtar.

Në Projektligjin për patent, përcaktohet afati i patentave dhe pagesa e mirëmbajtjes, përfundimi i patentës para afatit, ndryshimet në patent, ndryshimi në pronësi.

Në një kapitull të veçantë bëhet fjalë për licencat, përkatësisht për licenca të detyrueshme, kushtet për të cilat jipet licenca e detyrueshme. Janë të sanksionuara arsyet për shpalljen e anulimit të licencës si dhe vendimet lidhur me propozimin për shpalljen e anulimit të patentave. Po ashtu janë vënë në spikamë arsyet për shfuqizimin e vendimit për dhënien e patentës.

Në realizimin e të drejtave përcaktohen veprimet për realizimin e të drejtave për patenta, e drejta për të vazhduar procedurën për dhënien e patentës, padia për shkak të cenimit të patentës, kërkesat e padisë dhe caktimi i masave të përkohshme.

Në dispozitat e përbashkëta dhe përfundimtare, participohen rivendosja e të drejtave, përfaqësimi para zyrës kompetente, përfaqësuesit e pronësisë industriale, aplikimet për patent dhe patentat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Të nderuar deputetë,

Duhet t'ju informoj se ky Projektligj nuk bie ndesh me dispozitat ligjore të UNMIK-ut dhe as me të tjerat, prandaj duke marrë për bazë rëndësinë që ka ky ligj, kam nderin që të propozoj ta miratoni në shqyrtimin e parë dhe po ashtu edhe miratimin përfundimtar, me çka i ndihmohet ekonomisë dhe fushave tjera, duke zgjidhur juridikisht një lëmë mjaft specifike dhe shumë të nevojshme për Kosovën. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Doktor Blerim Baruti, besoj në emër të LDK. Urdhëro Blerim.

BLERIM BARUTI:

I nderuar kryetar Daci, të nderuar ministra, të nderuar deputetë,
Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës t'i paraqesim përshtypjet tona me rastin e debatit të Projektligjit për patentime. Vlerat krijuese, idetë, zhvillimi i ideve, shpikjet, risitë, inovacionet janë ende të pambrojtura në kuptim të autorsisë, prandaj me këtë Projektligj krijohet baza legjislative e legalizimit dhe mbrojtjes së kësaj sfere, me ç'rast vendoset një kornizë gjithpërfshirëse ligjore për patentime.

Nëpër vendet më të zhvilluara të botës, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Angli janë të hapura zyret dhe institutet e specializuara të cilat përbëhen nga profesionistë dhe ekspertë të cilët mirren vetëm me zhvillimet e ideve dhe të cilat ide e informata deponohen për përpunim të mëtejshëm.

Projektligji i ofruar për patentim është i punuar dhe i strukturuar duke përfshirë në mes tjerash paraqitjen e shpikësit të drejtën për patentim, aplikimin dhe procedurën e patentimit deri në publikim.

Përshtypja është se Projektligji është bazuar në praktikat evropiane duke u mbështetur në Konventën e Unionit të Parisit dhe në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Në fund, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ta përkrahim në parim Projektligjin për patentim, duke sygjerruar që emri i Projektligjit për patenta të shënohet me: projektligji për patentime, nga se me këtë terminologji komunikohet dhe kuptohet më drejt. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën profesoreshë Nerxhivane Dauti në emër të PDK.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,
Ligji për patenta, në mënyrë gjithpërfshirëse, rregullon shpikje të patentueshme, lëndët që mbrohen me patente, të drejtën e patentës, zbatimin e procedurës për dhënien e patentës, licencat si dhe dispozitat lidhur me shfuqizimin e vendimit për dhënien e patentës.

Ekzistojnë edhe të meta të caktuara në këtë ligj, që manifestohen në nenin 11, paragrafi 4. Ky nen duhet të harmonizohet me Ligjin për trashigiminë.

Në rastin e kërkesës për të drejtën e përparësisë për patent, konkretisht neni 23, paragrafi 4, duhet përcaktuar sakt data e njohjes së të drejtës së përparësisë në patent, ndërsa në paragrafin 5 të po këtij neni - afati kohor në rast të së drejtës së shumëfishtë të përparësisë - duhet precizuar po ashtu sikur në rastin paraprak.

Kontrata e licencës dhe cedimi i të drejtave, të paraparë në nenin 45, paragrafi 1 dhe 2, duhet harmonizuar me Ligjin për detyrimet.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, mbështes në parim shqyrtimin e parë të ligjit për patenta, ndërsa vërejtjet dhe sygjyerimet konkrete do t'i prezentoj në formë të amendamenteve në komisionet përkatëse parlamentare. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe zoti Dugolli, dhe pastaj, pas aprovimit do të bëjmë pauzë.

BUJAR DUGOLLI:

Po ashtu edhe Grupi i Aleancës mbështet parimisht këtë Projektligj. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Ju lutem për vëmendje. Ju ftoj që ta mbështesim ligjin.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All
 Kundër – Protiv – Against.....00
 Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Prej tash, deri në 12, do të bëjmë pauzë për kafe.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

Shpresoj se deri të vijmë te vendosja do të kemi kuorum të nevojshëm për vendimmarrje dhe po vazhdojmë.

Në radhë është Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tubimet publike.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 3 qershor, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj kryeministrin e Kosovës, doktor Bajram Rexhepi, ta arsyetojë Projektligjin.
 Urdhëroni kryeministër.

BAJRAM REXHEPI:

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës prej fillimit të punës së saj e deri më tani ka bërë një investim të madh në sferën e të drejtave të njeriut duke krijuar kushte dhe mekanizma përkatës për garantimin, rrespektimin dhe krijimin e hapësirave për ushtrimin e të drejtave të njeriut nga qytetarët tanë. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës ka paraparë hartimin dhe aprovimin e Projektligjit për tubime publike, me të cilin dëshmon edhe një herë për qasje të drejtë të saj dhe të institucioneve tjera të Kosovës për rrespektimin e të drejtave të njeriut duke paraqitur para jush këtë Projektligj për aprovim.

Nevoja e rregullimit të sferës së tubimeve publike, që është një ndër kategoritë juridike të të drejtave të njeriut për ta ushtruar të drejtën e tubimit, të shprehjes së fjalës së lirë, brengës politike, sociale, kombëtare, kulturore apo për shënimin e datave të rëndësishme në njërën anë, dhe rreugllimi i tyre në mënyrë dhe procedurë të drejtë për të arritur që të mbulohen ligjesisht veprimet në fushën e tubimeve publike në anën tjetër, e bën të rëndësishëm këtë ligj dhe që të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës.

Me Projektligjin për tubimet publike krijohen dhe garantohen të drejtat dhe kushtet që qytetarët përkatësisht organizatorët të ushtrojnë dhe shfrytëzojnë të drejtën e tyre për t'u tubuar lirshëm për të shprehur mendimin e tyre për kategori të veçanta të të drejtave që ata konsiderojnë se iu janë shkelur apo rrezikuar, të shprehin mendimin e tyre për gjendjen ekonomike, sociale, kulturore, sportive, të organizojnë kremtimi dhe shënimin e ngjarjeve të rëndësishme në Kosovë apo për çështje tjera me interes të përgjithshëm.

Projektligji për tubimet publike ka rëndësinë e vet shumëdimensionale. Megjithatë, roli kryesor i tij konsiston në normimin e veprimtarisë, në çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtës për tubimet publike.

Qeveria vlerëson se domosdoshmëria për këtë Projektligj mbështetet në nevojën që çështjet nga sfera e tubimeve publike të futen në korniza adekuate ligjore.

Projektligji arrin që të garantojë: të drejtën në organizimin dhe pjesëmarrjen në tubimet publike pa marrë parasysh përkatësinë racore, kombëtare, bindjeve politike, gjinisë apo të kategorive të ndryshme sociale; cakton kufizimin në raste të veçanta kur këto tubime mund të shfrytëzohen për dëmtimin e vlerave të përgjithshme; cakton obligime ligjore për organizatorin; krijon procedurë përkatëse që garanton jodiskriminim në raste të lajmërimit të tubimeve publike; siguron të drejtat dhe obligimet e autoriteteve përkatëse lidhur me lejimin apo refuzimin e mbajtjes së një tubimi publik duke siguruar edhe të drejtën e ankimit kundër vendimeve të tilla.

Konsiderojmë se aprovimi i këtij Projektligji hapë një perspektivë të re për Kosovën në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit të saj me të drejtën e Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave të njeriut, andaj Kuvendi ka para veti një rast të mirë që me miratimin e këtij Projektligji të krijojë edhe një mekanizëm tjetër që është paraparë në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryeministër, ju falemnderit. Për debat është paraqitur zoti Kolë Berisha, në emër të LDK, le të bëhet gati Hydajet Hyseni, në emër të PDK.

KOLË BERISHA:

I nderuari kryetar, i nderuar kryeministër dhe ministra, kolegë deputetë – të nderuar, Duke patur parasysh faktin se pas miratimit ligji nuk është më i atij që e ka sponsoruar, por autorsinë automatikisht e merr Kuvendi, mendoj se detyrë jona si deputetë është që të identifikojmë dhe t'i vëjmë në pah dhe spikam të metat, lëshimet, gabimet në mënyrë që në fazën e amendamentimit t'i propozojmë riformulimet, ndryshimet dhe plotësimet e tekstit në fjalë.

Në këtë kontekst, Grupi Parlamentar i LDK, ka identifikuar këto lëshime.

Nën një: Në pjesën hyrëse, kështu siç është thënë tash, del se Kuvendi i Kosovës, duke u bazuar në nenin kaq, e kaq... e miraton – jo ligjin, por kreun e parë të ligjit, do të thotë mungon titulli i ligjit aty ku duhet të jetë teknikisht.

Nën dy: Pjesa e përkufizimeve, ose e sqarimit të terminologjisë së përdorur në tekst, është dhënë në nenin 2, e do të duhej të jipej në nenin 1.

Nën tre: Mendojmë se dispozitat e nenit 4 pikë 2 dhe 4 pikë 3, përnga natyra e lëndës që rregullojnë - do të duhej të vinin pas nenit 8.

Nën katër: Neni 6 pikë 1, 6 pikë 2 dhe 6 pikë 3 duhet të riformulohet më mirë në aspektin gjuhësor që të mund të kuptohet qëllimi dhe të bëhet interpretimi i tij i mundshëm logjik dhe gjuhësor.

Nën pesë: Sipas dispozitave të nenit 21, pikë 1, paragrafi 1, 2 dhe 4 – veprimet apo kundërvajtjet që janë – janë të njëjta me ato të njëjtit nen në pikën 2 dhe 3, ndërkaq denimet ndryshojnë.

Megjithatë, duke shpresuar se gjatë procedurës së amendamentimit, këto dhe lëshime tjera do të kihen parasysh, Grupi Parlamentar i LDK mbështet në parim Projektligjin për tubimet publike në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Hydajet Hyseni, le të bëhet gati Bujar Dugolli.

HYDAJET HYSENI:

Falemnderit zoti kryetar. Zonja dhe zotrinj deputetë, i nderuar kryeministër, të nderuar ministra,

Grupi i deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, e mirëpret dhe mbështet nismën për rregullimin me ligj të çështjes së rëndësishme e të ndjeshme të tubimeve publike, siç ka mirëpritur dhe mbështetur edhe çdo inisiativë të ngjashme.

Se Kosovës së re i duhet një ligj i tillë, kjo është diç që dihet dhe nuk domend, por se sa e ngutshme është një nevojë e tillë, kjo u dëshmuar edhe gjatë marsit të këtij viti dhe u ridëshmuar serish edhe me rastin e protestës së nënave dhe familjarëve të të rrëmbyerve dhe të zhdukurve dhe ushtrimit të dhunës së paprovokuar dhe të pajustificueshme kundër tyre.

Ligji që po e shqyrtojmë, besojmë, do t'i pamundësojë standardet e dyfishta dhe praktikatat e deritashme të ndryshme ndaj tubimeve të qytetarëve - ndryshe për pjesëtarët e një komuniteti dhe ndryshe për të tjerët. Ndryshe, ta zëmë në Mitrovicë e Çagllavicë, e krejt ndryshe në viset tjera të Kosovës!?

Projektligji i paraqitur mund të konsiderohet një materie e mirë, e bollshme dhe do të thosha e punuar me përkushtim. Duket qartë se është shfrytëzuar përvoja e vendeve përreth dhe kjo s'ka ndonjë të keqe. Por, krijohet përshtypja se teksti është ngarkuar, ngatrruar e ndërlikuar së tepërmi dhe shpesh pa nevojë. Madje, edhe në vetë përbërjen e grupit hartues, del një përbërje e ngatrruar dhe e pazakonshme. Ka përfaqësues të ministrive që pak ose hiq kanë të bëjnë me tubimet publike, kurse nuk është përfshirë përfaqësuesi i Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Që në krye të ligjit, në nenin e parë – qëllimi dhe përmbajtja e ligjit - jipet në mënyrë jo të saktë dhe jo të plotë. Kjo mangësi plotësohet disi më vonë në nenin 4, por edhe këtu me mangësi dhe mbështjellime.

Janë tri-katër nene që përkufizojnë nocionin – tubime publike, por megjithatë për lexuesin dhe për qytetarin mbetet e paqartë çka nënkuptohet saktësisht me këtë nocion dhe me secilën formë të tubimit veç e veç.

Edhe në përkufizimin e ligjit, por edhe në të gjithë tekstin, vërehet një njëanshmëri indikative dhe problematike. Theksohen në mënyrë të sforcuar obligimet e qytetarëve lidhur me tubimet dhe injohorohen ose minimizohen të drejtat e tyre; potencohen së tepërmi kufizimet për qytetarët, por jo përafërsisht ato për organet e rendit dhe shtrengimit. Kufizimet janë aq të shumta dhe të përgjithësuara sa iu

mundësojnë organeve të rendit praktikisht ndalimin dhe pamundësimin e çfarëdo tubimi, nëse ato duhen.

Mbetet madje e paqartë a është e drejta e tubimit një e drejtë e garantuar e qytetarëve dhe ligji rregullon kushtet dhe mënyrën e realizimit të kësaj të drejte të patjetërsueshme, duke përfshirë edhe kufizimet dhe përjashtimet e domosdoshme në përputhje me aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me praktikën e vendeve demokratike, apo e drejta e tubimit nuk është e lejuar dhe ligji u dashka të rregullojë kushtet dhe rrethanat në të cilat tubimi mund të lejohet.

Është në rregull dispozita që tubimi të lajmërohet, por nuk është e nevojshme që çdo tubim të kushtëzohet me dhënien ose mosdhënien e lejes së veçantë. Pos të tjerash, edhe sepse kjo e drejtë është e lejuar dhe e garantuar me kushtetutë dhe me aktet ndërkombëtare. Në përputhje me praktikën e vendeve demokratike, mendoj se mjafton që tubimi të njoftohet në polici dhe me vetë faktin e mosndalimit të tij në afatin e përcaktuar - të konsiderohet se ai është i lejuar.

Edhe ky ligj, ashtu sikur edhe shumica e teksteve të ligjeve që na janë dërguar më parë, nuk ka harmonizuar sa duhet terminologjinë e përdorur në gjuhë të ndryshme dhe në secilën gjuhë veç e veç.

Si ilustrim, në tekstin shqip, shprehja “tubime të qeta” përdoret gabimisht si ekuivalent i shprehjes angleze “pis furdgedherings” dhe asaj serbe e boshnjake “mirni skupovi”. Por edhe në shqip dhe në gjuhë të tjera mungon konsekuenca terminologjike dhe për pasojë tubimet publike na dalin herë të qeta – në anglisht “kallm”, herë paqësore e herë harrohet krejtësisht atributi paqësor ose publike dhe mbetet vetëm “tubimet”.

Mund të jetë rastësi e mbase edhe lëshim teknik, por bie në sy që teksti në gjuhën shqipe e përdorë më shpesh dhe gati gjithkund shprehjen “tubime të qeta”. Kjo edhe do të mund të mos potencohet - posaçërisht po të mos ishte fakti se përdorimi i njërës ose formulimit tjetër mund të prodhojë efekte të ndjeshme konkrete gjatë spadimit të ligjit në praktikë. Një tubim mund të jetë i ligjshëm dhe paqësor edhe duke qenë i zhurmshëm, domethënë jo i qetë. Dhe anasjelltas, mund të jetë i qetë – i heshtur dhe të jetë i dhunshëm dhe i paligjshëm. Zatën, protestat bashkëkohore gjithnjë e më shumë po përdorin zhurmën si formën e protestës paqësore e të padhunshme. Prandaj, mendoj se duhet të përdoret shprehja “paqësore – të padhunshme”.

Do të mund të krijohet përshtypja se edhe ky Projektligj është përkthyer nga anglishtja po të mos ndodhte, si në nenin 7, që në shqip që të figurojë ndonjë pjesë e nenit që në anglisht e serbisht mungon fare.

Besojmë se këto lëshime dhe lëshimet tjera eventuale, do të përmirësohen në procesin e shqyrtimit të mëtejshëm të Projektligjit dhe si të tillë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Dugolli, le të bëhet gati Remzije Nimani.

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit kryetar,

Po ashtu edhe ne dëshirojmë të shprehim atë kënaqësi në tonë që sot kemi para veti këtë Projektligj, që është shumë me rëndësi dhe i është dashur shumë më herët Kosovës, sepse siç dihet ndoshta në rajon Kosova është vendi më i parë që ka qenë dashur ta ketë ligj dhe e cila ka më së shumti tubime të pakënaqësisë qytetare për çështje të ndryshme.

Këtu, edhe ne kemi disa vërejtje parimore, që besoj se gjatë shqyrtimit të dytë mund të përmirësohen. Për shembull tek neni 2 mungojnë përkufizimet për këto nocione, siç janë: çka është manifestimi, parakalimi, protesta, demonstrata, marshimet, kremtimet publike, përkujtimet e qeta, e tjera – e tjera.

Po ashtu, ne kemi vërejtur që në këtë Projektligj mungon trajtimi i tubimeve spontane pa organizator. Ju e dini që lehtë është të trajtohet tubimi i cili ka një organizator dhe i cili publikisht kërkon leje dhe në rast se s'i jipet dihet përgjegjësia se kush e ka kërkuar atë leje, por vështirë është të kontrollohet apo të trajtohet tubimi spontan që kemi patur rastin edhe kohëve të fundit të kemi tubime të tilla dhe trajtimet kanë qenë të formave të ndryshme. Unë mendoj se edhe kjo çështje don një përgjegje në këtë Projektligj.

Po ashtu, është e paqartë dhe e mjegullt çështja se në cilat raste forcat e rendit dhe pas cilave vërejtje forcat e rendit mund të lejohen të përdorin forcën për ta shpërndarë protestën. Për mua nuk janë bindëse se vetëm në rast kur nuk mirret leja apo në rast kur nuk rrespektohet vendi ku është lejuar të mbahet të përdoret dhuna. Mendoj se edhe me kritere ndërkombëtare janë edhe disa raste kur paralajmërohet që nga forcat e rendit protestuesit apo demonstruesit do të përdoret dhuna në rast se ata nuk e përfillin rregullën.

Po ashtu, tek neni 7, pika 4, që mendoj se edhe pse ky ligj përmban kriteret e avancuara përëndimore ndërkombëtare për lirinë e shprehjes së mendimit, të

protestimit dhe të fjalës, këtu ne duhet të bëjmë një specifikë për vendin ku jemi dhe për hapësirën që kemi në shfrytëzim për të bërë tubime protestuese paqësore. Po të shiqohet ky nen, pika 4 dhe po të shiqohet vetë terreni i Prishtinës, do të del që ne me ligj e lejojmë, ndërsa në praktikë nuk ka mundësi të mbahet askund tubim sepse të gjitha këto pika – për shembull në afërsi të spitaleve dhe vendeve ku pengohen automjetet, domethënë dihet se si është terreni i Prishtinës, në afërsi të çerdheve prap s'mund të mbahet dhe të shkollave fillore, në afërsi të parqeve nacionale s'mund të mbahet, në afërsi të përmendoreve s'mund të mbahet, në udhëkryqe dhe magjistrale nuk mund të mbahet dhe në vende tjera ku pengohet liria e qarkullimit të njerëzve. Prandaj, Prishtina nuk ka asnjë vend ku mund ta mbajë një tubim proteste qytetari. Mendoj se ky nen duhet të përpunohet me specifikat që i ka Kosova dhe qytetet e Kosovës. Ne nuk kemi, fatkeqësisht, sheshe. Ne kemi pasë problem edhe atëherë dhe s'dijshëm ku t'i grumbullojmë njerëzit se nuk na nxinin sheshet. Prandaj, mendoj se, varësisht prej kërkesës së qytetarit apo grupit organizator duhet t'u lejohej edhe në afërsi të këtyre vendeve që të mbahen tubimet paqësore, dhe në rast se qytetari kërkon të mbahet para Kuvendit duhet të lejohej, në rast se kërkon para Teatrit duhet të lejohej. Në rast se punëtorët shëndetësor kërkojnë të mbahet para entit shëndetësor...

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bujar vetëm një sekond. Ju lutem mos e lëshoni Seancën sepse rrezikohet vazhdimi saj dhe faktikisht i gjithë mundi që është bërë deri në këtë moment bie. Ju lus të keni durim... Vazhdo Bujar.

BUJAR DUGOLLI:

... Pra, duhet të mirren parasysh specifikat e Kosovës dhe e infrastrukturës së saj dhe nuk duhet të bëjmë kufizime të tilla, sepse prap do të kemi raste kur nga qytetarët nuk ato nuk do të rrespektohen dhe ato mund të konsiderohen se kemi marrë lirinë e të shprehjes së mendimit përmes tubimeve.

Ne dëshirojmë të shprehim edhe një vërejtje lidhur me tubimet e mbyllura. Janë disa raste kur ne mendojmë se edhe tubimet e mbyllura duhet të lajmërohen tek organet e rendit, dhe duhet ta sanksionojmë me çfarë mase të njerëzve tubimi i mbyllt mund të kalojë edhe pa u lajmëruar. Kemi manifestime të ndryshme sportive, që kalojnë mijëra njerëz dhe ka nevojë që tubimi të jetë i paralajmëruar dhe i siguruar nga forca të rendit, e po ashtu edhe spektakle të ndryshme dhe kemi raste kur bash në ato momente mund të eskalojë dhe të ketë probleme nga ai manifestim. Prandaj, edhe

këto këtu duhet të specifikohen me amendamente dhe ky ligj ta marrë formën e duhur dhe të jetë i pranueshëm për qytetarët.

Ne, si Grup Parlamentar, mbështesim këtë Projektligj në parim dhe do ta japim kontributin tonë në procedura të mëtutjeshme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën Remzije Nimani, le të bëhet gati profesor Bajrami, me lutje që të shkurtohen diskutimet dhe të jenë më koncize.

REMZIJE NIMANI:

Zotri kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuari kryeministër e ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë të pranishëm në sallë,

Nga përvoja e tubimeve dhe protestave të shumta të para dhe pasluftës, ky Projektligj është i domosdoshëm sepse mbështetet në nevojën që çështjet nga lëmia e tubimeve publike të qytetarëve të Kosovës të rregullohet me dispozita adekuate ligjore.

Projektligji për tubime publike ofron zgjidhje konkrete dhe të avancuara për çështje që i referohen kësaj sfere.

Vlerësoj se ky Projektligj rritë dhe konkretizon përgjegjësinë e qytetarëve dhe organizatorëve për tubime publike dhe të zyrtarëve kompetent për dhënien e lejeve.

Harmonizimi i këtij Projektligji me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe përshtatja e domosdoshme me kushtet dhe rrethanat në Kosovë i jep këtij Projektligji dimensionin e pëlqyeshëm për rrjedhat tona të aktiviteteve politike.

Me këtë ligj rregullohet e drejta për tubime publike, të fjalës së lirë në tubime publike, protesta, shfaqjeve publike, koha dhe mënyra e lajmërimit, detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve.

Vlerësoj se në tubimet publike, përveç pakënaqësive - qytetarët mund të paraqesin edhe kërkesa të tyre në mënyrë më demokratike, gjegjësisht me ligj duhet përcaktuar që mirëvajtja e tubimeve publike të jetë përgjegjësi jo vetëm e organizatorit por edhe e kompetentëve për siguri, rend e qetësi.

Natyrisht se tubimet publike duhet ndarë në ato: politike, sociale, kulturore, humanitare, sportive, fetare dhe argtuese. Për këtë arsye, kur bëhet fjalë për

kufizimet dhe ndalimet e tubimeve publike, duhet bazuar në karakterin dhe qëllimin e tyre, sepse tubimet humanitare, siç ishte protesta e nënave në Prishtinë – nuk mund dhe nuk duhet të ndalohen.

Do t'ishte mirë që në këtë Projektligj të parashihet që secila komunë në territorin e vet, të caktojë vendin dhe kohën e tubimit publik, natyrisht duke rrespektuar kërkesat e përcaktuara me ligj.

Është mirë që tubimet e mbyllura - në mjedise ku nuk ka kushte - të lejohen të mbahen edhe në shkolla, por në kohën kur nuk e pengojnë procesin edukativo-arsimor.

Çdoherë duhet patur parasysh që përgjegjësinë kryesore për tubimet publike ta mbajë organizatori, ndërsa rendin dhe qetësinë ta mbajë shërbimi policor ose punëtorët e rendit.

Vlerësoj se ritet fetare, dasmat e varrimet - nuk duhet trajtuar si tubime publike, sepse në realitet nuk janë të tilla dhe garantohen me të drejtë fetare, kombëtare e tjera.

Mendoj se edhe masat ndëshkuese nuk janë proporcionale dhe adekuate me shkeljet e parapara në Projektligj.

Shiquar në tërësi, ky Projektligj vërej se i plotëson kriteret për ta aprovuar në fazën e parë të shqyrtimit, por duke e begatuar me amendamente nga komisionet përkatëse. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe i fundit, profesor Bajrami. Urdhëroni...

ARSIM BAJRAMI:

Falemnderit, zoti kryetar. I nderuari zoti kryeministër, të nderuar ministra, Mendoj se ky ligj vendos një rend në Kosovë në mbajtjen e tubimeve dhe manifestimeve publike që janë një përditshmëri e Kosovës, dhe përcakton modalitetet e realizimit të një të drejte fundamentale të qytetarit por edhe të së drejtës për t'u tubuar dhe për të shprehur publikisht mendimet e veta.

Ligji po krijon një kuadër ligjor që do të vendosë rend dhe rregull dhe në një mënyrë do të institucionalizojë tubimet publike.

Unë do të bëja një vërejtje parimore që është konceptuale dhe që ligji nuk e ka sqaruar sa duhet.

Në demokraci të ndryshme, ekzistojnë kryesisht dy sisteme, apo dy regjime të mbajtjes së tubimeve publike. Është një sistem që e kemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku tubimet publike mjafton të paraqiten, pra i ashtuquajtur i sistem i paraqitjes, që është një koncept liberal që e marrin demokracitë e avancuara dhe sistemi tjetër restriktiv – ku përpos paraqitjes, duhet të furnizohet edhe leja, duhet të sigurohet edhe leja.

Ligji sikur nuk e ka precizuar se cilin koncept e merr. Në të vërtetë, ai ka paraparë obligimin e subjektit që organizon tubimin publik që ta paraqes tubimin dhe atë 72 orë para mbajtjes, por njëkohësisht parasheh obligimin e organit kompetent që brenda 48 orëve ta japë lejen. Dhe, në këtë rast, është bërë një bashkëdyzim i këtyre koncepteve. Nuk rregullohet – çka nëse organi kompetent as nuk e jep lejen as nuk e ndalon tubimin, dhe nuk dihet se a do të mbahet tubimi.

Prandaj, unë propozoj që komisioni përkatës të përfaqësojë kryesisht konceptin liberal të mbajtjes së tubimeve publike, pra do të mjaftojë që subjekti që organizon tubimin publik ta paraqesë, dhe në qoftë se nuk ekziston ndalimi shprehimor – tubimi të jetë i lejueshëm.

Kryeministri e tha në ekspozitën e tij që është paraparë edhe mekanizmi i drejtës së ankesës. Kjo është shumëmirë, sepse mos t'harrojmë e drejta e tubimit publik është e drejtë fundamentale kushtetuese, e garantuar jo vetëm me kushtetuta vendore por edhe me konventa ndërkombëtare. Unë mendoj se gjykata kushtetuese duhet të jetë ai autoritet që do të vendosë se a kanë vepruar mirë organet kompetente në rast se kanë ndaluar tubimin publik. Sepse, dispozitat e shumta restriktive në këtë ligj, sikur krijojnë një situatë të një monitorimi të panevojshëm ndaj tubimeve publike.

Prandaj, mendoj se kjo dilemë do të duhej të sqarohet në komisione funksionale dhe unë propozoj që të përfaqësohet koncepti liberal i mbajtjes dhe organizimit të tubimeve publike.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju ftoj ta përkrahim në parim Projektligjin.

Kush është për? Falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All
 Kundër – Protiv – Against.....00
 Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Kalojmë në pikën vijuese – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 28 korrik, dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim.

Ftohet ministri Brajshori të japë fjalën hyrëse. Urdhëroni ministër.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë, kryeministër, të nderuar kolegë ministra,

Hartimi i Projektligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta, është fryt i punës së GTZ, punës ekipore të ekspertëve vendor, i konsultimit të dokumenteve ndërkombëtare të fushës së të drejtave të autorit dhe të drejtave të afërta, i legjislacionit të një numri të vendeve të Evropës, të ekspertëve të Këshillit të Evropës, si dhe të Ministrisë së Kulturës – në masë më të vogël. Me këtë rast, falënderojmë të gjithë ata që kontribuan në këtë drejtim.

Me këtë Projektligj, krijohen kushtet për një zhvillim më të avancuar dhe më të qëndrueshëm të të drejtave të autorit dhe të drejtave të afërta në Kosovë. Rregullimi ligjor i këtyre të drejtave është pjesë përbërëse e kodifikimit të pronës intelektuale.

Projektligji përfshin të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta, rregullimi i të cilave kërkon të kodifikohet me ligj në përputhje të plotë edhe me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare. Duke mbrojtur interesat e ligjshme të krijuesve, njëkohësisht do të nxitet motivimi për punë krijuese, si dhe progresi i përgjithshëm ekonomik e kulturor. Ky rregullim, aktualisht është njëri prej standardeve dhe parakushteve të domosdoshme për integrimin demokratik, kulturor dhe ekonomik të Kosovës në rrjedhat ndërkombëtare.

Sot në Kosovë, praktikisht pothuaj nuk ka mbrojtje për këto të drejta. Arsyet janë të shumta, ndër më thelbësoret mund të ishin: mungesa e një ligji gjithpërfshirës e i efektshëm dhe mungesa e mekanizmave për organizimin, nxitjen dhe zbatimin e mbrojtjes së të drejtave të këtilla.

Me këtë Projektligj, tani për tani, synohet të sigurohet rregullimi në mënyrë të plotë, bashkëkohor dhe të efektshme e drejta e autorit dhe të drejtat e afërta.

Zgjidhjet dhe përkufizimet që përmban ky Projektligj, janë të harmonizuara me konventat përkatëse ndërkombëtare, me standarde dhe rregulla të Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale, me rregulla të Organizatës Botërore të Tregtisë, si dhe direktiva të Bashkësisë Evropiane nga kjo fushë.

Mundësia dhe domosdoshmëria e zbatimit të mirëfillt të ligjit po ashtu është çështje thelbësore që arsyeton miratimin e tij dhe rezulton me efekte të parashikuara. Në këtë aspekt, nëpërmjet mekanizmave për administrimin e këtyre të drejtave, mbikëqyrjes administrative, masave për zbatimin e mbrojtjes gjyqësore, krijohen premisa për të qenë ligji i zbatueshëm dhe funksional.

Projektligji konsiston në kodifikimin e 7 degëve të veprimit juridik: të drejtën e autorit; të drejtën e interpretatorit; të drejtën e prodhuesit të fonogramit; të drejtën e producentit të filmit; të drejtën e prodhuesit të emisionit radioteleviziv; të drejtën e prodhuesit të bazës së të dhënave dhe të drejtën e botuesit.

Projektligji rregullon ndaras këto shtatë degë juridike, si dhe përcakton rregullat e përbashkëta siç është administrimi i të drejtave dhe mbrojtja e të drejtave.

Në Projektligj janë të konceptuara dispozitat e veçanta për disa lloje të veprave të autorit, që përnga ndërlikueshmëria përmbajtësore, subjekteve krijuese të të drejtës së autorit përkatësisht titullarit të së drejtës si dhe kufizimeve të së drejtës së autorit paraqesin veçanti. Në këtë kontekst, jipen përkufizime për vepra audiovizuale, programe kompjutorike, vepra nga marrëdhënia e punës e të tjera.

Njëkohësisht, të drejtat e afërta të normuara me këtë Projektligj, shquhen të kenë ngjajshmëri me të drejtën e autorit dhe janë të afërta pikërisht për shkak të ndërlidhjeve që ekzistojnë ndërmjet tyre.

Rregullimi ligjor i këtyre të drejtave është në përputhje me praktikën bashkëkohore ndërkombëtare.

Të drejtat e interpretatorëve, të drejtat e prodhuesve të fonogrameve, të drejtat e producentëve të filmit, të drejtat e organizatave radiotelevizive - zënë gjithashtu vend meritore për arsye të rolit dhe pozicionit që kanë këto organizata në shfrytëzimin e veprave të autorit rrespektivisht sajimin e emisioneve të veta, kurse të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhënave e përbëjnë një kapitull të veçantë në këtë propozimligj.

Meqë shkelja, përkatësisht cenimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të afërta në vendin tonë është mjaft e theksuar - përmes veprimeve juridike të mbrojtjes në Projektligj është koncipuar mbrojtja gjyqësore, që parasheh mbrojtjen e titullarit në rast të shkeljes së të drejtës ekskluzive të tij. Me këtë do të ndikohej dukshëm në uljen e shkallës së cënimeve, parandalimin e tyre të mëtejme si dhe në ngritjen e vetëdijes për rrespektim të të drejtës së autorit.

Nga ana tjetër, duke zbatuar metodën e komparacionit kundruall legjislativioneve pozitive ndërkombëtare, në Projektligj janë shtjelluar rregullat e përgjithshme që i përkasin personave të huaj përkatësisht mbrojtjes së të drejtës së autorëve, interpretatorëve dhe bartësve të tjerë të këtyre të drejtave.

Të nderuar deputetë,
Zbatimi efikas i këtij ligji varet nga krijimi i kushteve përkatëse për mbështetjen dhe trajtimin e duhur financiar të nevojshëm për ngritjen e infrastrukturës përkatëse në mbrojtje të këtyre të drejtave.

Të vetëdijshëm se edhe ky Projektligj ka mangësitë e veta, i cili kërkon të plotësohet si çdo projekt tjetër, në përgjithësi i njëjti promovon një koncept bashkëkohor dhe funksional mbi këtë fushë.

Në përfundim, do të doja të theksoj se miratimi i tij siguron kornizën e domosdoshme ligjore për sajimin, zhvillimin dhe mbështetjen e një administrimi të frytshëm të të drejtës së autorit dhe të drejtave të afërta në Kosovë.

Prandaj, me shpresë se jam përpjekur të qartësoj parimet themelore, si dhe qëllimet dhe synimet e këtij propozimligji, ju ftoj që ta mbështetni të njëjtin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Për fjalë është paraqitur vetëm zoti Lirak Çelaj, shpresoj në emër të PDK. Urdhëro Lirak.

LIRAK ÇELAJ:

I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, ministra, të nderuar deputetë,
Së pari do t'ju korigjoj zoti kryetar që thatë se materiali na është shpërndarë më 28 korrik, që në të vërtetë ne materialin e kemi marrë dje dhe atë pasdite – pas Seancës plenare.

S' dyti, desha t'i jap kompliment Ministrisë së Kulturës se më në fund na erdh një ligj për së mbari. Ministri vetë tha se këtu më së paku ka pasë dorë Ministria e Kulturës, por ka patur Agjencioni Evropian, KTZ dhe Zyra ligjore e kryeministrit. Pra - komplimente nga Grupi Parlamentar - për një ligj kaq kompleks, kaq të rëndësishëm dhe të punuar mirë.

Ky ligj, siç tha edhe vetë ministri në ekspozitën e tij, rregullon një çështje shumë të rëndësishme, ku prona intelektuale vërtetë është devaluuar në Kosovë dhe intelektualit ka mbetur krejtësisht i pambrojtur. Shpresojmë se ky ligj do të ndihmojë që të ngritet niveli dhe të jetë mbrojtur prona e intelektualit dhe kjo të ketë njëfarë vlere, dhe jo vetëm tullat e bllokat siç kanë sot vlerë.

Pra, në emër të Grupit Parlamentar përkrahim në parim këtë Projektligj dhe vërejtjet e vogla që i kemi në këtë ligj do t'i japim nëpërmjet amendamenteve në komisione përkatëse.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Për hirë të transkriptit – është e vërtetë vetëm ajo pjesa shtesë, pas 70 përqindëshit - që është shpërnda me vonesë dhe që ne e heqëm prej rendit të ditës dje. E ka fjalën Sabit Rrustemi dhe le të bëhet gati Bujar Dugolli.

SABIT RRUSTEMI:

Falemnderit zoti kryetar, Kryesi e punës, kryeministër, ministra dhe deputetë,
Me kënaqësi jashtëzakonisht të madhe e kam pritur dhe e kemi pritur këtë Projektligj dhe fatmirësisht sot po e shqyrtojmë pak ndoshta në fund të mandatit dhe nuk do të kemi mundësi të elaborojmë aq shumë, siç nuk ka patur mundësi - duket - të elaborohet edhe gjatë hartimit të tij nëpër debate të ndryshme që kanë qenë shumë të nevojshme dhe në një mënyrë heshturazi vjen në Kuvendin e Kosovës ky ligj, por për mendimin tim është ndër ligjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë sot me Kosovën dhe sidomos me mbrojtjen e sferës intelektuale në Kosovë – me pronën intelektuale, pikërisht nga fakti se kjo asnjëherë, po them: asnjëherë nuk ka qenë e

marrë në mbrojtje dhe e mbrojtur si duhet. Edhe në këto vite të pasluftës, do të thotë - ka vazhduar i njëjti avaz i paraluftës.

Është e vërtetë ajo që u potencua nga zoti Lirak Çelaj më herët se një pjesë të ligjit e kemi marrë më herët dhe pjesën tjetër dje pasdite e dikush sot, dhe nuk kemi patur mundësi ta elaborojmë në tërësi si Projektligj.

Mirëpo, gjatë asaj që unë kam vërejtur, do t'i potencoja vetëm disa gjëra.

Projektligji, fundekrye duket se është i përkthyer dhe i përshtatur nga modele të ndryshme ndërkombëtare për nevoja kosovare. Do të thotë autorsia jonë kosovare shumëpak vërehet në këtë ligj.

E dyta. Me vetë faktin se janë 234 nene në këtë ligj, tregon se sa i gjatë është ky ligj, ndoshta lëshohet edhe në imtsira që do t'mund të rregullohen më vonë me akte nënligjore.

Megjithatë, edhe këto detaje nuk janë të tepërta, për shkak se nga kjo sferë e mbrojtjes së autorit shumëpak kemi përvojë në Kosovë.

Disa çështje tjera, për mua janë kontestuese, sikur bie fjala çështja e krijimit të agjencionit kosovar të autorëve për mbrojtjen e të drejtave të autorëve dhe të afërtat. Shumëpak vërehet se është i lidhur me institucionet e Kosovës kjo agjenci, që për mendimin tim, është shumë e rëndësishme. Ne e dijmë se një agjenci e tillë ka vepruar dhe akoma vepron në Kosovë, mirëpo sa ka mund të bëjë dhe sa ka bërë në këtë plan...?

Lidhshmëria e kësaj agjencie me institucionet e Kosovës do të duhej të precizohet dhe të saktësohet më shumë në këtë ligj, për shkak se - nëse jo dikujt tjetër - së paku Kuvendit të Kosovës do t'duhej t'i jipet një raport nga ky agjencion për punën e tij qoftë tremujor, gjashtëmujor apo edhe njëvjeçar. Këtu nuk parashikohet kjo askund, kurse shihet se duhet të mbulohet nga buxheti i Kosovës.

Tjetra, përmendet një organ administrativ për administrimin e pronës intelektuale. Nuk dihet kush do ta formojë këtë organ, bazuar sipas Projektligjit.

Është edhe një çështje tjetër, në nenin 95 - nëse s'gaboj. Përmendet forca, një forcë madhore në shkatrimin e ekzemplarëve ose të librit dhe kompensimi që duhet t'i bëhet autorit... Nuk dihet cila është kjo formë madhore, mbase është vetë zoti apo ato të mirat a të këqiat që na vijnë nga ai. Ndër të tjera, janë gjëra që do të duhej t'i

kemi parasysh gjatë shqyrtimit të tij në komision dhe besoj se këtë do ta bëjmë, përkundër kohës shumë të pakët në këtë aspekt.

Parimisht, mbështes këtë ligj dhe mendoj se edhe deputetët tjerë do ta mbështesin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit zoti kryetar. Ka qenë kërkesë e vazhdueshme e njerëzve të kulturës, të artit, të shkencës që edhe Kuvendi i Kosovës të miratojë ligjin i cili do t'iu rrijë afër dhe do t'i mbrojë të drejtat e autorit.

Unë mendoj se hartuesit e këtij ligji kanë bërë një punë shumë të mirë, nga aq që kemi patur mundësi dhe kohë ta shqyrtojmë në pjesën që u tha edhe më herët dhe kemi vërejtur që është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban në vete standarde më të larta evropiane dhe perëndimore. Ne nuk kemi nevojë po as mundësi që të çpikim standarde më të avancuara sesa i kanë ata, por duhet t'i përshtatim, t'i bëjmë të përshtatshme edhe për mesin ku jemi dhe për specifikat që i ka Kosova.

Ne si Grup Parlamentar mbështesim parimisht këtë Projektligj dhe do ta japim kontributin tonë në procedurat e mëtejme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën zoti Gani Sadik. Urdhëro Gani.

GANI SADIK:

Kërkoj falje, pak si vonë u paraqita, por desha të them se ne e përkrahim këtë Projektligj i cili do ta rregullojë këtë laramani në Kosovë që ndodh, sidomos në estradën kosovare, dhe besoj ky Projektligj është i nevojshëm për Kosovën dhe sigurisht e ka efektin e vet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju ftoj ta mbështesim në parim Projektligjin.

Kush është për? Falemnderit.
 A ka kush kundër? Nuk ka.
 A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All
 Kundër – Protiv – Against.....00
 Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Vazhdojmë me pikën e radhës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarve.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 28 korrik.

Ftoj ministrin për punë dhe mirëqenie sociale – Ahmet Isufi ta paraqes fjalën hyrëse.

AHMET ISUFI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, i nderuari kryeministër, kolegë ministra, Para se të filloj të bëj prezentimin e shkurtër të Projektligjit për nxitjen e punësimit në Kosovë, më lejoni të paraqes para jush disa fakte lidhur me punën dhe punësimin në Kosovë.

Në këtë rast të përpilimit të Projektligjit, kemi vështirësi të caktuara në terminologjinë, siç u tha edhe më herët, për arsye se disa fjalë nuk përputhen adekuat me gjuhët të cilat me të cilat është përpiluar, por që mendojmë se fjalët e përafërta në këtë rast. Për shembull në anglisht kemi “promoshen”, në shqip kemi menduar se fjala më adekuate do të jetë “nxitje e punësimit”, prandaj kërkoj të jetë angazhimi i deputetëve në mënyrë që të jetë gjithmonë një harmonizim i gjuhës, përveç nga sponsorizuesi.

Sipas shënimeve të fundit, me të cilat disponon Minsitria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kemi këto shifra të cilat janë shumë alarmante:

- shkalla e papunësisë në Kosovë është 42.9%;
- papunësia afatgjate është 90% e personave që presin punë më gjatë se 12 muaj;
- të pakualifikuar janë 58%;

- të rinj që presin punë janë 36%;
- një rritje të punëkërkesve ndër të rinj prej 15% krahasuar me vitin paraprak.

Këto shënime i përmenda vetëm për të përkujtuar edhe me këtë rast se situata në sferën e punës dhe punësimit është ende e rëndë dhe në këtë lëmi duhet të ndërmerren masa të shumta për zbutjen e papunësisë në Kosovë, e cila është ndër më të lartat në Evropë e më gjerë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është duke ndërmarrë një varg masash në drejtim të zbutjes së papunësisë dhe rritjes së punësimit në Kosovë.

Masat që i kemi marrë kanë dhënë rezultate. Politikat e punësimit që kemi implementuar janë plotësisht në pajtim me të gjitha standardet ndërkombëtare të Organizatës së Punës dhe UE, si dhe organizmave tjerë ndërkombëtar. Masat që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i ka ndërmarrë kanë bërë të mundur që niveli i papunësisë të zbresë nga 57.1% - që ishte në vitin 2000 dhe 2001, në 42.9% - sa kemi tani.

Për të vazhduar në përpjekjet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbutjen e papunësisë në Kosovë ekspertët vendor dhe ndërkombëtar kanë punuar në përpilimin e draftit të ligjit për nxitjen e punësimit në Kosovë, të cilin sot po e shqyrtojmë.

Është me rëndësi të përmend se me këtë ligj, ne kemi menduar që të mbështetemi në forcat dhe mundësitë tona në nxitjen e punësimit, konkretisht në fondin për nxitjen e punësimit, që do të formohet me aprovimin e këtij ligji dhe i cili do të financohet nga mjetet tona, mjetet e punëdhënësve dhe punëmarrësve – ku të dy palët do të kontribuojnë me nga 1%.

Unë nuk do t'ua shpjegoj tani ligjin, por kisha dashur të shpjegoj në pika të shkurtëra se çfarë kryesisht dëshirojmë të financojmë me këtë fond. Me këtë fond, nëse miratohet nga ju, të nderuar deputetë, do të financohen këto politika të punësimit:

- kompensimi material në bazë të papunësisë, që deri tani është bërë përmes skemës së asistencës sociale, kategoria e dytë në mënyrë dhe numër shumë të kufizuar;
- do t'i japim edhe një shtytje shtesë aftësimeve dhe riaftësimeve profesionale. Ju përkujtoj se niveli i punëkërkesve të pakualifikuar ishte 58%, në mënyrë që të gjithë personat e pakualifikuar të aftësohen për punë;

- do të jemi në gjendje që t'i ndihmojmë punëdhënësit përmes substituimit të punësimit për një kategori të punëkërkesve;
- për një kategori të punëkërkesve do të negocojmë me punëdhënësit dhe do të participojmë në pagesën e të ardhurave për një periudhë. Kjo masë do të ndërmirret për disa kategori të punëkërkesve që me vështirësi mund të konkurojnë në tregun e punës dhe të gjejnë punë; persoant që presin gjatë për punë, qytetarët me aftësi të kufizuara, femrat, e tjerë.

Për stimulimin e kërkimit të një punësimi intensiv, kemi planifikuar që përmes këtij fondi të nxisim krijimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme përmes mikrokredive. Kjo masë, jemi të mendimit, nëse do ta kemi përkrahjen tuaj, do të jepë edhe efekte të duhura sepse do të kemi mundësi të ndikojmë në disa aspekte. Përmes kësaj mase – mikrokredive, do të stimulojmë krijimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme në sektor të rëndësishëm, siç janë: bujqësia, ndërmarrjet prodhuese e tjera, në të cilat ndërmarrje do të krijoheshin vende të reja të punës.

Të gjitha këto dhe masat tjera shtesë, do t'i implementojmë me një bashkëpunim të frytshëm dhe konstruktiv ndërqeveritar, me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë për Tregti e Industri, Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, e tjera; me partnerët tanë social, Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odën Ekonomike, si dhe me të gjithë ata që mund të ndihmojnë profesionalisht – institutet, shoqëritë civile si dhe organizmat tjerë vendor dhe ndërkombëtar.

Të nderuar deputetë, ne do të punojmë që edhe donatorët e jashtëm të kontribuojnë në këtë fond. Jemi duke biseduar edhe me përfaqësues të qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare që përmes këtij fondi ta luftojmë papunësinë në Kosovë dhe mund t'ju them se janë të interesuar, sidomos Banka Botërore për Punësimin e të Rinjve, por shumica e këtyre institucioneve presin miratimin e këtij ligji.

Unë dëshiroj t'ju informoj se shumica e shteteve në rajon e më gjerë e kanë të organizuar këtë fond dhe kryesisht e përdorin për financimin e masave sipas nevojave të tyre dhe se në të gjitha shtetet ka dhënë rezultate të dukshme.

Për implementimin sa më të suksesshëm të këtij fondi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ndërmarrë një varg studimesh të fondeve të shteteve të ndryshme dhe tanimë së bashku me Agjencionin Evropian për Rindërtim është duke u punuar që të bëjmë pilotimin e një fondi për nxitjen e punësimit në Kosovë. Shuma nuk është aq e madhe, por është me rëndësi se Ministria e Punës do të ketë mundësi që në praktikë të vërtetohet për efektin e masave të propozuara, mënyrën e realizimit dhe përvojat tjera të cilat do t'na nevojiten pas themelimit të këtij fondi.

Po ashtu, kemi parasysh e dhe faktin se përveç miratimit të këtij ligji, i cili do të krijojë një bazë ligjore, do të jenë të nevojshme edhe shumë rregullore, udhëzime administrative dhe doracak të ndryshëm për këtë çështje dhe ne jemi duke punuar së bashku me Agjencionin Evropian në përpilimin e të gjitha dokumentave që do të janë të nevojshëm dhe të domosdoshëm për implementimin e këtij ligji.

Të nderuar deputetë,

Shpresoj se ky Projektligj do të begatohet edhe më tepër përmes vërejtjeve dhe sygjërimeve tuaja, të cilat do të janë të mirëseardhura. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Lus për debat të shkurtër në parim. E ka fjalën Ramadan Kelmendi, le të bëhet gati Flora Brovina.

RAMANDAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra të pranishëm, Duke ju falënderuar për fjalën e dhënë, fillimisht paraqes vlerësimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për propozimligjin për nxitjen, gjegjësisht promovimin e punësimit dhe mbrojtjen e të papunëve.

Grupi Parlamentar i LDK vlerëson se ky propozimligj i plotëson kriteret për t'u shqyrtuar dhe propozon të përkrahet në parim për miratim. Këtë fakt e mbështet në këto argumente:

Nën një – Propozimligji është i hartuar mirë;

Dy – Propozimligji është hartuar dhe është në harmoni me legjislacinin e Unionit Evropian;

Tre – Ky propozimligj vjen në shqyrtim në procedurë kuvendore pikërisht në kohën kur në Kosovë është shënuar shkalla më e lartë e problemit të papunësisë dhe i kushtohet kësaj kujdes më i shtuar.

Qëllimi kryesor i këtij propozimligji është zbutja e problemit të papunësisë dhe ndihma e punëkërkuesve, gjegjësisht e të papunësuarve.

Në fazat dhe me metodat e riaftësimit profesional, subuencionet për punëdhënësit dhe mikrokreditë që do të ndahen, do të bëhet nxitja e punësimit, si dhe janë përcaktuar të drejtat materiale për të papunësuarit.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, mbështetur në këto fakte të përcaktuara në propozimligj, ka bërë një punë të madhe dhe të mirë, por për t'i arritur këto qëllime vlerësoj se është e arsyeshme por edhe domosdoshme që sa më parë të miratohet ligji në fjalë për nxitje për punësim dhe mbrojtje të papunëve si dhe të bëhet ndryshimplotësimi i Ligjit themelor të punës, Ligji i shërbimeve civile dhe Ligji i inspeksionit të punës. Konkretisht - në rrethana të reja të ekonomisë së tregut, privatizimit, konkurrencës në punë – Ministria e Punës ka bërë një hap më tej në nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunëve, duke përcaktuar dhe siguruar instrumente adekuate të arritjes së këtij qëllimi.

Megjithkëto anë shumë pozitive, paraqes edhe disa sygjerime për marrje në konsiderim në procedurën e mëtutjeshme nga komisioni funksional.

Vlerësoj se në politikën e punësimit, gjegjësisht zbutjen e problemit të papunësisë, Qeveria e Kosovës duhet të jetë e angazhuar me projekte konkrete dhe jo vetëm të ndalet në vlerësime dhe mbikëqyrje të këtij problemi të hapur.

Po ashtu, edhe komunat duhet të kryejnë dhe të kyçen në zbutjen e papunësisë duke marrë përgjegjësitë në angazhimin e bashkëpunimit trepalësh, së bashku me Bashkimin e Sindikatave, departamentin e punës, qendrat regjionale dhe zyrat komunale të punësimit.

Për t'i arritur këto qëllime është mëse e domosdoshme dhe këtë e theksoj me sa vijon: që në nenin 4 të përcaktohen detyrat e punëdhënësit dhe të shtohen pikat vijuese – d), e) dhe f) dhe të jenë: "Punëdhënësi është i obliguar që vendet e lira të punës t'i publikojë në mjete të informimit në zyrat komunale për punësim, gjegjësisht QRPP;

e) Punëdhënësi është i obliguar që këshilldhënësi për hulumtimin e tregut të punës dhe nevojave për pranim t'i ofrojë të dhënat e nevojshme lidhr me këtë çështje; dhe

f) Punëdhënësi obligohet që të lidhë kontrata për punë me punëtorë dhe të rrespektojë kontratat kolektive.

Po ashtu, edhe në nenin 6 duhet përcaktuar se cilat janë mundësitë e realizimit të punëkërkuesit të drejtat e tyre që nuk kanë asnjë ditë pune, por me vite të tëra

rregullisht paraqiten si punëkërkuar në zyrat për punësim, por nuk patën fatin të punësohen kurrë.

Mendoj se shprehjet sportive "trajnim" dhe "ritrajnim" të zëvendësohen në gjuhën shqipe të bukur "aftësim" dhe "riaftësim".

Grupi Parlamentar i LDK vlerëson se në këtë propozimligj, përveç zyreve komunale dhe qendrave regjionale janë paraqitur edhe agjencitë private të punësimit. Ndonëse kjo është paksa e hershme, nuk janë përcaktuar kushtet e regjistrimit, mënyra e funksionimit, mënyra e bashkëpunimit të agjencisë me departamentin e punës dhe të punësimit, divizionin e punësimit, zyrat komunale dhe format tjera të bashkëpunimit.

Në fund, paraqes vlerësimin përkrahës për miratimin parimor të propozimligjit nga Grupi Parlamentar i LDK. Ju falemnderit për respekt.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë do t'ju lutja: përmbajuni diskutimit në parim, dhe në emër të grupeve parlamentare kur jipet përkrahja nuk po e shoh të jetë e arsyeshme të paraqiten tjerët, sepse është një temë dhe po bëhet dhe do të bëhet vetëm politike e jo kontribut për ligjin. Urdhëroni. Flora Brovina, le të bëhet gati Zylfije Hundozi.

FLORA BROVINA:

Ligji për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunëve është një ligj që mbron të pambrojturit, a ta që me punën e tyre nuk mund të sigurojnë ekzistencën e vet. E drejta për punë është e drejtë themelore e njeriut, e garantuar edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Është koha dhe rendi që ti qasemi këtij problemi aq madhor në Kosovë edhe për shkak të problemit të madh të punësimit, të papunësimit pra për një kohë të gjatë dhe për shkak të politikës së apartheidit në të kaluarën e afërt por edhe për shkak të mungesës së politikës së zhvillimit ekonomik të Kosovës sot.

Në lidhje me ligjin, vërejtjet e detajizuara do t'i them në Komisionin gjegjës.

Në diskutimin e sotëm do të ndalem në kreun 3, ku flitet për stimulimin aktiv dhe pasiv të punësimit përmes mikrokredive dhe investimeve të tjera. Në këtë ligj mungon forma e punësimit të organizuar institucional në botën e jashtme, si punësim i përkohshëm, e pse jo edhe për kualifikime të përkohshme ose rikualifikime për të papunët.

Tani shihet se ka filluar migrimi i ri ekonomik i qytetarëve të Kosovës, migrim klandestiv dhe i rrezikshëm për jetërat e tyre dhe është koha që të brengosemi thell për këtë çështje.

Një perspektivë e mbyllur për momentin për zhvillimn ekonomik të Kosovës, ngecja e procesit të privatizimit dhe mungesa e investimeve në Kosovë, mungesa e kredive të jashtme dhe zhvillimit të politikave zhvillimore në përgjithësi në Kosovë paraqesin si të nevojshme këtë formë të punësimit të lëvërdishëm për të papunët, formë e cila duhet të shënohet edhe në këtë ligj.

Mendoj se Ministria në fjalë duhet të marrë mbi vete gjetjen e tregut, organizimin dhe punësimi ne të papunëve në tregun e punës në botën e jashtme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zylfije Hundozi dhe e fundit të bëhet gati Zehra Elezi.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Zotni kryetar, kolegë të nderuar,
Ky Projektligj nuk është shkop magjik me të cilin do të zgjidhet papunësia. Megjithatë, me hartimin e këtij Projektligji tentohet të zbutet problemi i papunësisë dhe paraqet një veprim të qëlluar të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie sociale gjegjësiht të Qeverisë.

Me këtë Projektligj jo vetëm që janë paraparë mundësi për zbutjen e papunësisë, por edhe përkujdesje institucionale e të papunësuarve, që gjer më tani ka ekzistuar vetëm në vende te zhvilluara, por jo edhe te ne.

Idetë për pagat e subuencionuara, mikrokreditë, diskriminimi pozitiv për persona të grupeve sociale të rrezikuara dhe të paaftë, i japin kuptim ligjit dhe na bëjnë të kuptojmë se ky mund të realizohet në praktikë.

Njëra prej vërejtjeve tona është në nenin 9, ku Qeveria bëhet garante për pagimin e mikrokredive. Kjo gjë nuk është stimuluese që biznesi të ketë sukses kur nën vetëdije e din personi se borxhin mund t'ia kthejë dikush tjetër.

Duke marrë parasysh se me këtë Projektligj do të sigurohet baza e fortë ligjore efektive për politikën e punësimit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e

Kosovës, e përkrah në parim këtë Projektligj dhe mbështet miratimin e tij prej këtij Kuvendi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën Zehra Elezi.

ZEHRA ELEZI:

Poštovani gospodine predsedniče, uvaženo Predsedništvo, cenjeni ministri, drage kolege, dame i gospodo,

Kao član Komisije za rad i socijalno staranje, na početku mog izlaganja podržavan Nacrt ovog zakona koji je, po meni, uređen po svim evropskim stanardima. Ovako kvalitetno uređen Nacrt zakona, dopunjen amandmanima i primedbama Funkcionalne i ostalih parlamentarnih komisija i drugih kolega, će dobiti još veći kvalitet i uskoro biti usvojen u Skpštini.

Medjutim, mislim da ovaj zakon je trebalo ranije doneti, a ne pri kraju našeg mandata, jer je Kosovo mesto sa najvećim stopom nezapošljenosti u Evropi.

Želim da pohvalim Radnu grupu, koja je po mom shvatanju, dobro i savesno obavila svoj zadatak, obuhvativši sve segmente posticanja zapošljavanja pogotovo u oblasti zaštite nezapošljenog stanovništva.

Imam jednu primedbu ili preporuku da uputim gospodinu minsitru – Ministarstvu za rad i socijalnu zaštitu. Često puta sam na komisijama i razgovorima sa predstavnicima ministarstva napominjala da je trebalo mnogo ranije doneti jedan ovakav zakon a posebno zakon koji bi regulisao pitanje postojećih i novih penzionera starosnog doba ispod 65 godina starosti, i da oni ne bi pomislili a smo ih zaboravili, jer su izbori pred nama, plašim se da penzioneri bez penzija ne zaborave nas.

Nadam se da će i ovaj zakon uskoro biti pred nama, jer bi umnogome ublažio teško ekonomsko stanje svih stanovnika Kosova.

Na kraju želim da predložim Parlamentu da u načelo usvoji ovaj zakon sa datim primedbama i preporukama. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Ju falemnderit. Ju ftoj ta mbështesim në parim.

Kush është për? Ju falemnderit.
 A ka votë kundër? Një votë kundër.
 A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

(Reagim – pa kyçje të mikrofonit)

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Veçina - Majority

Kundër – Protiv – Against.....01

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Ju lutem, jemi të kufizuar me praninë e shumëkujt. Grupet parlamentare, vërejtjet kryesore në një mënyrë, në përbërje çfarë jemi ta përfundojmë dhe nuk ka tjetër. Po ishte Flora Brovina...Urdhëroni, tjetër herë e thuani në çfarë cilësie diskutoni. Tani në emër të Grupit Parlamentar, apo...?

ISMAJL KURTESHI:

Unë nuk e di a ka kuptim tash me marrë fjalën kur është diskutuar. Kjo është edhe një shkelje që ju po e bëni vazhdimisht dhe tani po injoroni edhe grupet parlamentare. Unë nuk e marr fjalën pasi keni votuar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Këto vërejtje i kam prej teje që tri vjet dhe i kam parasysh.

Pika e radhës së rendit të ditës – është Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 29 korrik dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim.

Ministri i ambientit nuk është i pranishëm. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale do ta paraqes fjalën hyrëse. Urdhëroni ministër

AHMET ISUFI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, zoti kryeministër, të nderuar kolegë,
Në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës ligjore në fushat e përgjegjësisë së saj,
Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapsinor ka finalizuar Projektligjin për
mbrojtjen e natyrës, i cili tashmë është para nesh.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës, si ligj sistemor, është mëse i domosdoshëm për
rrethanat e krijuara në Kosovë dhe për të vënë nën kontroll institucional çështjet e
mbrojtjes së natyrës. Për dallim nga sipërfaqja e vogël që ka Kosova, në krahasim
me vendet tjera evropiane, natyra e saj ka vlera të mëdha natyrore që janë me interes
edhe për vetë Evropën, sidomos në pikëpamje të biodiversitetit.

Me këtë rast do të përmendi vetëm disa të dhëna dëshmuese për vlerat e
pamohueshme natyrore në Kosovë:

- Bifurkacioni i lumit Nerodime, që është rasti i dytë në botë;
- Shpella e Gadimës, me sipërfaqen më të madhe të mermerit në botë;
- Kanjoni atraktiv i Mirushës, që është i dyti në rajon;
- Parku Kombëtar Malet e Sharrit, që është shembull i rrallë i biodiversitetit.

Duhet përkujtuar gjithashtu se nën mbrojtje ligjore në Kosovë janë 52 zona natyrore,
me një sipërfaqe të përgjithshme prej 46 mijë hektarësh, prej të cilave 39 mijë hektar
i takojnë Parkut kombëtar Malet e Sharrit. Natyrisht, këtu nuk është përfshirë pjesa e
propozuar për park kombëtar Bjeshkët e Nemuna, që është edhe më tutje në
procedurë parlamentare.

Të nderuar deputetë,

Ligji i ashtuquajtur i aplikueshëm deri tash, që ka mbuluar sferën e mbrojtjes së
natyrës, ka qenë larg kërkesave të zhvillimeve moderne në sferën e mbrojtjes së
natyrës dhe larg nga kërkesat e legjislacionit ndërkombëtar.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës, që sot gjendet para jush për miratim, ka 12
kapituj të zbërthyer në 45 nene.

Kapitulli i parë, përmban dispozitat e përgjithshme të mbrojtjes së natyrës, ku
përfshihen qëllimet e ligjit, raportet e këtij Projektligji me ligjet e posaçme dhe fusha
e zbatimit të ligjit.

Kapitulli i dytë, përfshin definicionet kryesore të cituara në ligj, me kontekst të veçantë në definicionet e marra nga direktivat evropiane, mbi të cilat është bazuar ligji dhe definicionet mbi kategoritë e mbrojtjes, të bazuara në kategoritë e Unionit Botëror të Ruajtjes së Natyrës.

Në kapitullin e tretë, përfshihen parimet themelore të mbrojtjes së natyrës, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të Samitit të Rios – 1992 dhe atij të Johaneshburgut 2002.

Kapitulli i katërtë, parasheh dokumentet kryesore për mbrojtjen e mjedisit si strategjinë dhe planin e veprimtimit për mbrojtje të natyrës, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës, si dhe programet e mbrojtjes së natyrës, të cilat duhet të nxirren nga komunat për territorin e tyre.

Kapitulli i pestë, përcakton organet përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, duke bërë një ndarje të kompetencave në mes nivelit qendror dhe atij komunal.

Kapitulli i gjashtë, përmban masat e përgjithshme për mbrojtjen e peisazheve natyrore, masat për mbrojtjen e specieve të florës dhe faunës si dhe të habitateve, duke u fokusuar në nevojën e nxjerrjes së librit të kuq për specie të rralla, të rralluara dhe të rrezikuara.

Kapitulli i shtatë, përmban masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës, ku definohen zonat e mbrojtura të natyrës, dhe menaxhimi me to. Janë përcaktuar pesë kategori të mbrojtjes: rezervati strikt i natyrës; parku kombëtar; monumentet e natyrës; zona e menaxhimit të habitateve dhe llojeve, si dhe peisazhet e mbrojtura.

Kapitulli i tetë, përfshin dispozitat për mbrojtjen e specieve të rralla të florës dhe faunës, futjen e llojeve të reja ose të zhdukura në Kosovë dhe një dispozitë mbi organizmat gjenetiksht të modifikuar.

Në kapitullin e nëntë, përfshihen dispozitat e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji dhe mbikëqyrjes inspektive të cilën do ta bëjë inspektori për mbrojtjen e natyrës.

Kapitulli i dhjetë, rregullon financimin e punëve për mbrojtjen e natyrës, kryesisht përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe eko-fondit. Gjithashtu, ky kapitull përmban edhe dispozitat për pronësinë dhe kompensimet, duke iu dhënë të drejtën qytetarëve për kompensim në rast se preken nga vënia e zonave të caktuara nën mbrojtje, por formën e kompensimit duhet ta rregullojë Qeveria me akt të veçantë nënligjor.

Kapitulli i njëmbëdhjetë, përmban dispozitat ndëshkimore në rast të shkeljes së këtij ligji.

Ndërkaq, në kapitullin e fundit, përfshihen dispozitat kalimtare.

Të nderuar deputetë,

Me këtë Projektligj do të krijohet komiza e nevojshme ligjore që të mundësojë një ruajtje efektive të biodiversitetit dhe peisazheve duke marrë parasysh kërkesat ekonomike, sociale, kulturore të vendit; të krijojë kompetencat dhe detyrimet e autoriteteve publike që janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të rregullave dhe standardeve lidhur me ruajtjen e natyrës; të caktojë të drejtat dhe detyrat e personave dhe ndërmarrjeve që preken nga aktivitetet e ruajtjes së natyrës apo të personave dhe ndërmarrjeve që disponojnë interesa në promovimin e ruajtjes së natyrës në Kosovë.

Duke patur parasysh rëndësinë e normimit të çështjeve të mbrojtjes së natyrës në Kosovë dhe nevojën për ndërtimin e një kornize përkatëse ligjore lidhur me të, propozoj që ky Projektligj, pas shqyrtimit në Kuvend dhe në komisione respektive, të miratohet, sepse si i tillë do të orientojë në mënyrë të drejtë dhe institucionale çështjen e ndërtimeve dhe do të përshpejtojë vënien e rendit dhe të rregullit në lëmin e mbrojtjes së natyrës në Kosovë. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Në emër të LDK Esad Dauti – në emër të PDK Berat Luzha – në emër të Aleancës Sebahate Krasniqi. Urdhëroni profesor Dauti.

ESAD DAUTI:

I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, kryetar i Qeverisë, të nderuar ministra dhe deputetë të pranishëm,

Sikur ceku kryetari, unë flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në rend dite, ose të punës në Seancën e sotme kemi shqyrtimin e parë të Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Mendojmë se ky Projektligj është dashur t'u paraprijë projektligjeve dhe ligjeve që i kemi votuar deri më tani në Parlamentin e Kosovës.

Ky Projektligj është gjithpërfshirës dhe normalisht se i ka edhe të metat e veta, dhe mangësitë të cilat, gjatë amendamentimit në komision, do t'i përmirësojmë dhe evitojmë.

Në përgjithësi, Grupi Parlamentar pranon këtë dhe lut të pranishmit ta votojnë.

Në mes tjerash, duhet të them se ky Projektligj është i përfshirë në 12 kapituj me 45 nene, ku radhitja e këtyre neneve nuk është në proporcion dhe nuk i përgjigjet asaj që duhet dhe ne gjatë amendamentimit do të mundohemi që kjo radhitje të jetë më adekuate.

U përmend ligji për parkun nacional të Bjeshkëve të Nemuna i cili duhet të dalë në këtë Kuvend dhe është në procedurë. Unë mendoj dhe mendojmë në tërësi në Grupin Parlamentar se ligji duhet të jetë i përbashkët dhe atë: ligji i parqeve nacionale. Këtë e them për arsye se prej vitit 1992 e deri më sot, parku nacional i Sharrit menaxhohet nga Serbia dhe ne nuk kemi qasje në këtë park. Andaj, është e arsyeshme të bëhet: ligji i parqeve nacionale. Jemi të vonuar, por megjithatë këtë sygjërim duhet ta pranojmë.

Në mes tjerash duhet të cek edhe këtë. Në këtë Projektligj ka punuar edhe një numër i konsiderueshëm i ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar. Në mesin e tyre figuron edhe emri im. Unë nuk kam marrë pjesë në këtë hartim, për shumë arsye, por arsyeja kryesore është se unë jam deputet dhe mendoj se në hartimin e projektligjeve dhe ligjeve nuk kanë vend të marrin pjesë deputetët meqë ata janë të angazhuar në komisione dhe për koment tjetër nuk do të kishte nevojë, sepse edhe koha është e kufizuar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor ju falemnderit. Zoti Berat Luzha, le të bëhet gati Sebahatja.

BERAT LUZHA:

Projektligjin për mbrojtjen e natyrës e vlerësojmë si të përgatitur mirë me kujdes të veçantë. Në të përfshihen edhe normat të cilat i rregullojnë çështjet e parqeve nacionale, të rezervateve natyrore, të zonave të mbrojtura e tjera, që plotëson një fushë të rëndësishme për të cilën ka nevojë të madhe.

Në këtë fazë nuk kemi vërejtje esenciale, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet për miratimin në shqyrtimin e parë të tij. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit për konstruktivitet. Dhe Sebahatja, e fundit. Urdhroni Sebahate.

Ne kemi nxjerrë ligje që gati tri vite dhe kanë qenë paksa larg nga syri dhe dora e qytetarit. Lidhur me këtë, mendoj se qytetarët ndoshta paksa janë dëmtuar apo kanë ndodhur disa raste mosnjohjeje të ligjit për shkaqe objektive. Për atë që e lejon ky shqyrtim apo këto vërejtje parimore, unë do t'i theksoja këto:

E para: Duke çmuar propozimin nga ana e Qeverisë, mendoj se është dashur të jetë Kuvendi i Kosovës dhe jo qeveria e Kosovës.

Vërejtja tjetër është sa i përket rolit të madh të zyrës për menaxhim dhe administrim të gazetës zyrtare. Mbi bazën e saj, mendoj se kjo zyre duhet të jetë në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe jo në kuadër të Qeverisë së Kosovës, duke ditur se Kuvendi i Kosovës është organi kryesor ligjvënës në Kosovë.

Po ashtu, është krijuar një paqartësi në mes të gazetës zyrtare dhe faqës zyrtare të Kuvendit të Kosovës dhe duhet ta dijim, sidomos sa i përket kohës së hyrjes në fuqi të ligjeve. Tanimë, me kornizë kushtetuese është e qartë koha kur hyn në fuqi, por koha kur dalin në faqën zyrtare dhe koha kur publikohen dallojnë, mbi bazën e asaj se gazeta zyrtare publikohet një herë në muaj, ndërsa ligji mund të hyjë në fuqi më herët. Pra, qytetarët mund të njihen më vonë për këtë.

Ne kemi vërejtur një dallim me kornizën kushtetuese sa i përket gjuhës që mbizotëron. Kjo është e qartë në kornizën kushtetuese dhe ligji nuk guxon të jetë në kundërshtim me kornizën kushtetuese.

Pastaj, sa i përket çështjes së ankesave dhe plotësimit të gazetës zyrtare, nuk mendoj në asnjë rast se duhet të mbetet në kompetencë të zyrës, por duhet të jetë organ i veçantë i Kuvendit.

Po ashtu, botues duhet të jetë gjithësesi Kuvendi i Kosovës dhe jo ndonjë furnizues apo ndonjë kompani private.

Në këtë ligj duhet të parashihet gjithësesi obligimi që gazeta zyrtare të merr për obligim gjitha ligjet e nxjerra deri më tani dhe të botohen edhe në gazetën zyrtare që do të nxirret tash e tutje. Pra, edhe ato paraprake, të jenë pjesë përbërëse e tyre.

Ne si Grup Parlamentar dhe unë personalisht do të japim kontributin tonë në përmirësimin e këtij ligji dhe mendojmë se ky ligj është i domosdoshëm për kohën dhe e përkrahim të miratohet në parim në leximin e parë. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën zoti Dugolli, pastaj shefi i Grupit Parlamentar.... cilin e autorizoni?

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit. Ne dëgjuam ekspozenë edhe të kryeministrit, edhe disa vërejtje për mangësitë që i përmendën kolegët. Nuk dëshirojmë t'i përsërisim ato.

Po ashtu vërejtjet tona janë prap te dispozitat e përgjithshme – neni 1, që nuk dëshiroj t'i përsëris, por mendoj se ky term "IPVQ" nuk duhet të ekzistojë më në këto ligje dhe në këto dispozita.

Ne mendojmë se gazetën zyrtare të Kosovës, përveç ligjeve, rezolutave, akteve nënligjore, duhet të futen edhe deklaratat që i miraton Kuvendi i Kosovës sepse dihet rëndësia e deklaratave edhe në bazë të akteve kushtetuese, dhe mendojmë se edhe kjo çështje duhet të ekzistojë në gazetën zyrtare.

Përndryshe, në përgjithësi është një ligj i mirë dhe ne si Grup Parlamentar i japim mbështetje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën zoti Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar dhe le të bëhet gati Mahiri.

GANI SADIK:

Falemnderit zoti kryetar. Në parim përkrahim Projektligjin, por me një vërejtje, ju lutem. Pse nuk botohet gazeta zyrtare edhe në gjuhën turke, kur me kornizë kushtetuese e kemi këtë të drejtë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe deputeti Jaghillar.

MAHIR YAĞCILAR:

Faliminderit zotri Kryetar. Do të jam shumë i shkurtër.

Sayın Başkan, Sayın Başbakan, Sayın Bakanlar ve saygıdeğer milletvekilleri.

Her Parlametonun olduğu gibi, Kosova Parlametosunun da resmi gazetesi olması gerekir. Dolayısıyla bu Kanun, Kosova için büyük bir anlamı taşımaktadır. Kanunu doğal olarak destekliyoruz.

Uyarı olarak Kanunda, Geçici Anayasaya uyum sağlanmasını bekliyoruz. Bu Kanunda, Geçici Anayasanın 9.1.51. maddesine bağlı olarak, bütün kabul edilen kanunların diğerleri arasında Türk ve Boşnak dilinde basılma gereği belirtilmelidir. Üç yıldır resmi gazete olmadığından dolayı, biz bu hakkımızı kullanamadık. Bundan dolayı bu ifadenin Kanunda yer alması gerekir. Bununla beraber Geçici Anayasa hükümleri de yerine getirilmiş olacaktır diye inanıyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju ftoj që ta mbështesim në parim Projektligjin.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk abstenon askush. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Kalojmë në pikën e radhës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për librin amzë.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 28 korrik, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftohet ministri Jakup Krasniqi, që ta paraqesë fjalën hyrëse.

JAKUP KRASNIQI:

Zoti kryetar, zoti kryeministër, të nderuar zonja dhe zotrinj deputetë, Qeveria e Kosovës tani ka hyrë në fazën e fundit të përmbushjes së programit, veçmas planit legjislativ. Duke patur parasysh këtë plan, sot për aprovim ju paraqesim Projektligjin për librat amzë.

Pas 12 qershorit të vitit 1999, administrata e okupatores serbe, me largimin e saj nga Kosova, bëri edhe një veprim të shëmtuar duke marrë me veti dokumentacionin mbi gjendjen civile të popullatës së Kosovës, e që për qytetarët tanë pas luftës solli probleme shumë të mëdha drejt identifikimit të identitetit të tyre, sidomos kjo ishte e vështirësuar edhe nga një faktor tjetër.

Gjatë luftës, ishin zhdukur, djegur apo marrë nga ushtria dhe policia serbe edhe dokumentat personal të qytetarëve tanë, që e bën identifikimin dhe pajisjen e qytetarëve me dokumentacion përkatës shumë të vështirë.

Nevoja për rregullimin e lëmisë së shërbimeve të regjistrimit civil, krijimin e kushteve, hapësirave dhe infrastrukturës adekuate ligjore për krijimin e një sigurie dhe procedure për shfrytëzimin e tyre në të mirë të përgjithshëm, aprovimi i këtij Projektligji është përgjegjja më e mirë ndaj kërkesave tona, duke përfituar qytetarët në njërën anë dhe duke siguruar një bazë të mirë të të dhënave që shërbejnë në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, politike dhe sociale.

Me Projektligjin për librat amzë krijohen dhe garantohen kushtet dhe procedurat më të avancuara për regjistrimin e të dhënave të lindjes, të vdekjes, të martesës dhe fakteve relevante lidhur me to, si dhe ushtrimin efikas, me përgjegjshmëri dhe ndershmëri nga zyrtarët që kryejnë regjistrimin e fakteve të gjendjes civile me interes të përgjithshëm për qytetarët e Kosovës, të caktuara me këtë ligj.

Projektligji për librat amzë ka rëndësinë e vet shumëdimensionale. Megjithatë, roli kryesor i tij konsiston në krijimin e kushteve për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile të qytetarëve tanë dhe normimin e veprimtarisë së institucioneve kompetente në çështjet e regjistrimit të fakteve të gjendjes civile.

Objekt dhe qëllim i rregullimit, sipas dispozitave të këtij ligji, është:

- a) përcaktimi i librave të amzës, si libra amzë të të lindurve, librat amzë të të martuarve dhe librat amzë të të vdekurve;
- b) përcaktimi i një procedure koherente jodiskriminuese dhe të afatizuar për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile, dhe
- c) krijimin e kushteve dhe kriterëve për ripërtëritjen e librave amzë që janë zhdukur.

Qeveria vlerëson se domosdoshmëria për këtë Projektligj mbështetet në nevojën që çështjet nga lëmia e gjendjes civile përkatësisht regjistrimi i fakteve të gjendjes civile të rregullohen me ligj.

Projektligji do të zgjidhë probleme në këto fusha:

- për librat e amzës ofron zgjidhje konkrete dhe të avancuara për çështjet që i referohen kësaj sfare;
- Rritë efikasitetin dhe shpejton shërbimet për qytetarët;
- Nxitë qytetarët për ofrimin e të dhënave të sakta dhe me kohë mbi faktet e gjendjes civile;
- Ndhmon në ngritjen e infrastrukturës së bazës së të dhënave për qytetarët e Kosovës; dhe
- Shpejton procedurën për pajisjen e qytetarëve me dokumenta përkatës.

Konsiderojmë se aprovimi i këtij Projektligji hapë një perspektivë të re për qytetarët e Kosovës për eliminimin e problemeve të shumta reth regjistrimit të fakteve të gjendjes civile dhe pajisjen e qytetarëve tanë me dokumenta përkatës.

Prandaj, Kuvendi i Kosovës, ka para veti një rast të madh, një rast të mirë që me aprovimin e këtij Projektligji të krijojë mundësi të re për ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët në ngritjen e pranueshmërisë dhe besimit të institucioneve tek qytetarët. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Në emër të LDK Nimon Alimusa, pastaj në emër të PDK Nerxhivane Dauti dhe në emër të AAK Naim Maloku le të bëhen gati.

NIMON ALIMUSA:

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuari zoti kryeministër, ju ministra dhe kolegë deputetë,

Unë nuk do të flas as për nevojën, as për rëndësinë e bërjes së Kosovës me një ligj të tillë, as për punën shumë të mirë të hartuesit të këtij Projektligji, për këto arsye:

E para, për faktin se nuk duhet të marr rolin e sponsorizuesit, siç po bëhet nganjëherë zakon, dhe t'u marr kohë, duke përsëritur ato që bukur i tha zoti ministër në ekspozenë e tij.

E dyta, për faktin se jo vetëm për këtë ligj, por siç e dijmë - Kosova ka nevojë për qindra e qindra ligje të tjera, të cilat do t'i japin rrugë zgjidhjes së shumë problemeve të fushave dhe lëmive të ndryshme të jetës dhe punës në Kosovës, prandaj secili ligj në sferën e vet është, siç po thuhet, i një rëndësie të veçantë.

Dhe, e treta, për faktin se - për fat të mirë - tekstet ligjore, të cilat po na ofrohen kohëve të fundit edhe më tepër po dëshmojnë për pjekurinë tonë edhe në fushën e hartimit të ligjeve.

Por, le t'më lejohet t'i përmend vetëm disa nga vërejtjet, të cilat Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka veçuar gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji.

1. Formulimi i nenit 2, paragrafi 1, është pothuaj identik me atë të nenit 3 pikë 1 dhe 3.2, pra është një dyfishim krejtësisht i panevojshëm.
2. Hartuesi nuk arrin të qartësojë se çfarë nënkuptohet me territor amë dhe çfarë me komunë ose territor i komunës.
3. Duket jopraktik, jofunksional prandaj edhe jo i arsyeshëm formulimi që është dhënë në nenin 4 pikë 4 i cili përjashton mbajtjen edhe të librit të përbashkët amzë për të martuarët.

4. Në nenin 11 dhe ato që pasojnë, na del e panevojshme fjala “burimor” meqë vetë fjala amë nënkupton vendin, objektin, në rasti ntonë – librin prej nga dalin, burojnë dhe rrjedhin të dhënat, shënimet, faktet e tjera.
5. Po në të njëjtin nen, paragrafi 4, thuhet: “për dallim nga librat burimor, kopjet e tyre i mban dhe ruan organi kompetent”. A do të thotë kjo se librat burimor po i mbajka dhe ruajka organi jokompetent dhe cili qenka ky organ kompetent.
6. Nga formulimi i nenit 19, nuk mund të dihet saktësisht se për çka është fjala, për të provuar atësinë apo amësinë, pra për të ofruar prova që dëshmojnë atësinë ose amësinë, apo për ta marrë – pranuar dokumentin zyrtar mbi atësinë, përkatësisht amësinë.

Mendojmë se këtij neni duhet t’i jipet një formulim më i qartë.

Projektligjit i mungojnë format, modelet, mostrat e formularëve të librave dhe dokumenteve tjera, të cilat janë objekt i këtij ligji.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë Projektligj.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoja Dauti, pastaj Naimi të bëhet gati.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Menjëherë do të lidhem me diskutimin e parafolësit tim, i cili bëri vërejtjet lidhur me kundërshtimin e atësisë, për të cilat mendoj se ka të drejtë.

Megjithatë, çështja e kundërshtimit të atësisë në tërësi është rregulluar me Ligjin e familjes. Prandaj, një ndër vërejtjet e mia janë edhe në nenet 17, 20, 22, 24, 26, 31 dhe 32. Të gjitha këto nene duhet të harmonizohen me Ligjin për familjen të Kosovës. Prandaj, të gjitha këto do të paraqiten në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në formë të amendamenteve dhe ligji duhet të pasurohet në këtë drejtim dhe duhet të jetë i harmonizuar me Ligjin e familjes.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i japim mbështetje dhe propozoj që të vazhdohet me procedim të mëtutjeshëm.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe zoti Maloku.

NAIM MALOKU:

Falemnderit zoti kryetar,

Unë përkrah në parim miratimin e këtij Projektligji me një sygjërim që të rregullohet apo rirregullohet neni 11 që ka të bëjë me kopjet e librave amzë, posaçërisht paragrafi 5 ku thuhet se nëse humb ose asgjësohet libri burimor i amzës, organi kompetent që ruan kopjen e parë apo të dytë lëshon certifikatën në bazë të këtyre kopjeve deri në kohën e përsirimit të librit burimor. Pra, nëse humbet ose asgjësohet libri burimor, si mund të përshkruhet pastaj? Dhe, këtu nuk shoh të arsyeshme këtë dhe se duhet ta ketë obligimin që ai të shpallet në gazetën zyrtare si i humbur, dhe zyrtarisht të shpallet si i humbur. E them këtë, për faktin se, siç tha në ekspozitën e vet edhe zoti ministër, shumë libra amzë janë tjetërsuar nga komunat dhe vendet tjera ku mbaheshin ato – në Kosovë - janë tërhequr në Serbi dhe po u shkaktojnë probleme të mëdha qytetarëve të Kosovës, sepse shumësish janë të detyruar që për dokumente nga kjo fushë e rregullimit të shërbimit civil të shkojnë në ato komuna dhe të nxjerrin dokumente të nevojshme.

Mendoj se me miratimin e këtij ligji dhe hyrjen e tij në fuqi duhet të shikohet mundësia e shpalljes si të pavlefshme apo të humbura, apo të asgjësuar ato libra amzë dhe të rregullohet kjo çështje në territorin e Kosovës.

Edhe një herë – në emër të Grupit Parlamentar të AAK - përkrah në parim këtë Projektligj. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Sa për t'u konstatuar. Të pranishëm janë 68 deputetë, prandaj ju ftoj ta mbështesim në parim Projektligjin.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk abstenon askush. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Shihemi në seancën e ardhshme.

Seanca përfundoi punën në orën 14,05.

E transkriptoi: RT, zyra E-04,tel.dir.038-211-86, lok.10-508 rtullari@hotmail.com